FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 209

Tiranë – E mërkurë, 12 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 57/2025, datë 16.10.2025	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve.....	24843
Dekret i Presidentit nr. 388, datë 7.11.2025	Për shpallje ligji.....	24887
Vendim i Kuvendit nr. 77/2025, datë 30.10.2025	Për mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së *Charles Mcgonigal*".....	24887
Vendim i Kuvendit nr. 78/2025, datë 30.10.2025	Për mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 Majit 2025"	24888
Vendim i Kuvendit nr. 79/2025, datë 30.10.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 64/2025, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit"	24888
Vendim i Kuvendit nr. 80/2025, datë 30.10.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit"	24888
Vendim i Kuvendit nr. 81/2025, datë 30.10.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 74/2025, të Kuvendit "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore"	24889
Vendim i Kuvendit nr. 82/2025, datë 30.10.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 75/2025, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë"	24889

Vendim i Kuvendit nr. 86/2025, datë 6.11.2025	Për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	24890
Vendim i Kuvendit nr. 87/2025, datë 6.11.2025	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	24890
Vendim i Kuvendit nr. 88/2025, datë 6.11.2025	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	24890
Vendim i Kuvendit nr. 89/2025, datë 6.11.2025	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	24891
Vendim i Kuvendit nr. 90/2025, datë 6.11.2025	Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	24891
Vendim i Kuvendit nr. 97/2025, datë 6.11.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 74/2025, të Kuvendit, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore"	24891
Vendim i Kuvendit nr. 98/2025, datë 6.11.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 75/2025 ,"Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë"	24892
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024.....	24892
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2024.....	24894
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2024.....	24896
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024.....	24898
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024.....	24899
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2024.....	24901
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2024	24902
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2024	24903
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2024.....	24906

Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2024.....	24907
Rezolutë e Kuvendit datë 30.10.2025	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024.....	24908
Dekret i Presidentit nr. 389, datë 10.11.2025	Për emërim ambasadori në detyrë.....	24909
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1120, datë 3.11.2025	Për miratimin e rregullores "Për menaxhimin e peshkimit në Zonën e Kufizuar të Peshkimit në Kanalin e Otrantos (GSA 18)".....	24910
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1124, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	24912
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1125, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	24913
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1126, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	24915
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1127, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	24918
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1128, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	24919
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1129, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	24919
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1130, datë 4.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	24921
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 48, datë 22.9.2025	Me objekt rihapjen e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese. Shfuqizimin e vendimeve nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	24922

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.61, datë 21.10.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	24942
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 5.11.2025	Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me subjektin financiar jobankë NOA sh.a.....	24945
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 936/8, datë 6.11.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-së nr. 20, datë 17.1.2024, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar', Vlorë.....	24946

LIGJ
Nr. 57/2025

PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim krijimin e një sistemi të menaxhimit të integruar të mbetjeve për të garantuar mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njeriut, si dhe sigurimin e përdorimit të burimeve me efikasitet, duke krijuar kushtet e domosdoshme për kalimin në modelin e ekonomisë qarkulluese.

Neni 2
Objekti dhe fusha e veprimit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe zbatimi i hierarkisë së mbetjeve dhe masave për arritjen e objektivave të mëposhtëm:

a) parandalimin ose pakësimin e mbetjeve;

b) parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i mbetjeve;

c) zvogëlimin e ndikimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimin e eficiencës së përdorimit të tyre.

2. Dispozitat e këtij ligji mbulojnë të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatohen nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, që kanë të drejta dhe detyrime në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 3
Përjashtime nga fusha e veprimit

1. Përjashtohen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme, të cilat rregullohen me legjislacion të posaçëm:

a) shkarkimet e gazta në atmosferë;

b) tokat *in situ* (në pozicionin origjinal dhe të paprekura), që përfshijnë dherat e ndotura të pagërmuara dhe ndërtesat që janë të lidhura në mënyrë të përhershme me tokën;

c) dherat që nuk janë të ndotura dhe materialet e tjera natyrore, të gërmuara si pasojë e veprimtarive të ndërtimit, në rastet kur është e sigurt që materiali do të përdoret për qëllime ndërtimi në gjendjen e tij natyrore në territorin nga ku është gërmuar;

ç) mbetjet radioaktive;

d) lëndët plasëse të çaktivizuara;

dh) lëndët fekale, në rast se nuk përfshihen në shkronjën "b" të këtij neni, kashta dhe materiale të tjera natyrore, bujqësore ose pyjore jo të rrezikshme, që përdoren në bujqësi, pylltari ose për prodhimin e energjisë nga biomasa të tilla, përmes procesesh ose metodash që nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk vënë në rrezik shëndetin e njeriut;

e) anijet e dala jashtë përdorimit;

ë) mbetjet që dalin nga kërkim-zbulimi, shfrytëzimi, përpunimi dhe depozitimi i burimeve minerare dhe nga punimet në gurore.

2. Përjashtohen nga objekti i këtij ligji fushat e mëposhtme për pjesët që rregullohen me legjislacion të posaçëm:

a) ujërat e përdorura;

b) nënproduktet shtazore, përfshirë produktet e përpunuara, përveç atyre që destinohen për incinerim, për në landfill ose për përdorim në një impiant kompostimi ose biogazi;

c) skeletet e kafshëve të ngordhura, përfshirë rastet kur janë therur në thertore apo janë vrarë për të eliminuar sëmundjet epizotike;

ç) substancat të cilat janë të paracaktuara të përdoren si materiale ushqyese për kafshët dhe që

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

nuk përmbajnë ose nuk rrjedhin nga nënproduktet shtazore.

3. Pa cenuar detyrimet, që rrjedhin nga legjislacioni i posaçëm, sedimentet që rikthehen në ujërat sipërfaqësore për qëllime të menaxhimit të ujërave dhe rrugëkalimeve ujore, ose për parandalimin dhe zbutjen e efekteve të përmbytjeve e të thatësirave ose për bonifikimin e tokave përjashtohen nga objekti i këtij ligji kur provohet se këto sedimente janë jo të rrezikshme.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "ADR" është Marrëveshja Evropiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme, në rrugë automobilistike, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

2. "Agjent" është çdo person që realizon rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve në emër dhe për llogari të të tretëve. Ky term përfshin edhe agjentët të cilët nuk posedojnë mbetje.

3. "AKEM" është Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve.

4. "Ambalazh" është çdo produkt që përbëhet nga çdo lloj materiali i çdo natyre, që përdoret për mbajtjen, mbrojtjen, përdorimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave, duke filluar që nga lëndët e para e deri te produktet e përpunuara, nga prodhuesi te përdoruesi apo te konsumatori. "Elementet e pakthyeshme", që përdoren për të njëjtat qëllime, konsiderohen si ambalazhe.

5. "Asgjësim" është çdo operacion që nuk është rikuperim edhe kur operacioni ka si pasojë të tërthortë përftimin e substancave ose të energjisë. Shtojca 1 e këtij ligji përmban listën joshteruese të operacioneve që konsiderohen operacione asgjësimi.

6. "Automjet në fund të jetës" është automjeti, i cili është mbetje në kuptim të pikës 20 të nenit 4 të këtij ligji, që ka dalë jashtë përdorimit pasi ka përfunduar procesi i lëshimit të certifikatës së shkatërrimit dhe është bërë çregjistrimi i tij nga regjistri i autoriteteve të qarkullimit rrugor.

7. "Bashkincenerim i mbetjeve" është çdo operacion i rikuperimit ose asgjësimit të mbetjeve, qëllimi kryesor i të cilit është prodhimi i energjisë ose i produkteve materiale dhe në të cilin mbetjet përdoren si lëndë djegëse e rregullt ose plotësuese, ose në të cilin mbetjet i nënshtrohen trajtimit termik me qëllim asgjësimin e tyre. Kjo përfshin djegien nga oksidimi i mbetjeve, si dhe procese të tjera termike, të tilla si: piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, për sa kohë që produktet që rezultojnë nga këto trajtime digjen më pas.

8. "Dokument dorëzimi" është dokumenti që shoqëron çdo transfertë të mbetjeve të rrezikshme, sipas nenit 45 të këtij ligji.

9. "Dokument transferimi" është dokumenti që shoqëron çdo transfertë të mbetjeve jo të rrezikshme, sipas nenit 39 të këtij ligji.

10. "Ekonomia qarkulluese" është sistemi në të cilin mbetjet konsiderohen si burim dhe përgatiten për ripërdorim, riciklohen ose rikuperohen dhe produktet ripërdoren, riparohen ose ripërpunohen me qëllim ruajtjen e vlerës së tyre, të materialeve e të burimeve në ekonomi për një kohë sa më të gjatë të mundshme dhe zvogëlimin e krijimit të mbetjeve.

11. "Grumbullim" është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe ruajtjen paraprake të mbetjeve, me qëllim transportimin e tyre në impiantet e trajtimit të mbetjeve.

12. "Grumbullim i diferencuar" është grumbullimi sipas të cilit një rrymë mbetjesh mblidhet dhe mbahet e ndarë, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.

13. "Impiant bashkincinerimi" është çdo impiant i lëvizshëm ose i palëvizshëm, qëllimi kryesor i të cilit është krijimi i energjisë ose prodhimi i produkteve materiale dhe që i përdor mbetjet si lëndë djegëse, bazë ose shtesë ose në të cilin mbetjet i nënshtrohen trajtimit termik, me qëllim asgjësimin e tyre nëpërmjet oksidimit të mbetjeve, si dhe proceseve të tjera të trajtimit termik, si: piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, nëse substancat, që përftohen nga trajtimi, më pas i nënshtrohen incinerimit.

14. "Impiant incinerimi" është çdo pajisje dhe njësi teknike, e lëvizshme ose e palëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia nëpërmjet oksidimit të mbetjeve, si dhe proceseve të tjera të trajtimit termik, si: piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, nëse substancat që përftohen nga trajtimi më pas i nënshtrohen incinerimit.

15. "Incenerim i mbetjeve" është çdo proces rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, në të cilin mbetjet digjen me ose pa rikuperim të nxehtësisë së

gjeneruar nga djegia, i cili përfshin djegien nga oksidimi i mbetjeve dhe procese të tjera termike, si: piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, për aq kohë sa produktet që rezultojnë nga këto trajtime më pas digjen.

16 "Krijues i mbetjeve" është kushdo, veprimtaria e të cilit krijon mbetje (krijuesi origjinal i mbetjeve) ose kushdo që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera, që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

17. "*Landfill*" është fusha e asgjësimit të mbetjeve mbi ose nën tokë, përfshirë:

a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i *landfill*-it ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;

b) një vend të përhershëm që përdoret për magazinimin e përkohshëm, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:

i. impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;

ii. vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;

iii. vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

18. "Lëng kullues" është çdo lëng që rrjedh prej mbetjeve të depozituara dhe që shkarkohet ose mbetet në *landfill*.

19. "Magazinim i përkohshëm" është mbajtja e mbetjeve në një vend, me qëllim magazinimin e përkohshëm të tyre pas grumbullimit të mbetjeve, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve.

20. "Mbetje" është çdo substancë ose objekt, të cilin mbajtësi e hedh, ka ndër mend ta hedhë ose i kërkohet që ta hedhë.

21. "Mbetje bashkiake" janë:

a) mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit, që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobiliet, dyshekët dhe të ngjashme;

b) mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake.

Mbetjet bashkiake nuk përfshijnë mbetjet nga prodhimi, bujqësia, pyjet, peshkimi, gropat septike, rrjetin e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sistemin e kullimit, si dhe llumrat e ujërave të ndotura, automjetet në fund të jetës, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja. Ky përkufizim nuk cenon ndarjen e përgjegjësive për menaxhimin e mbetjeve midis aktorëve publikë dhe privatë.

22. "Mbetje bio" janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore e të gatimit nga shtëpitë, zyrat, restorantet, kateringu, kantinat dhe ambientet e shitjes me pakicë e shumicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

23. "Mbetje inerte" janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte janë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.

24. "Mbetje spitalore" janë mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme sipas përcaktimeve të këtij ligji, të krijuara nga institucione publike dhe private, që kryejnë aktivitete mjekësore dhe veterinare parandaluese, diagnostikuese, trajtuese, rehabilituese dhe kërkimore-shkencore.

25. "Mbetje shtëpiake" janë mbetjet bashkiake të parashikuara në shkronjën "a" të pikës 21 të këtij neni, që krijohen nga sektori familjar dhe përbëhen nga mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike e elektronike, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve,

mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobiliet, dyshekët dhe të ngjashme.

26. "Mbetje ushqimore" është çdo ushqim që është kthyer në mbetje.

27. "Mbetjet e baterive" janë të gjitha bateritë dhe/ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në këtë nen.

28. "Mbetje e lëngshme" është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.

29. "Mbetje e pajisjeve elektrike dhe elektronike" ose "Mbetje PEE" është një pajisje elektrike dhe elektronike që konsiderohet mbetje, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse, nëngrupet dhe materialet e konsumit, që janë pjesë e produktit në kohën kur pajisja hidhet.

30. "Mbetjet nga anijet" janë të gjitha mbetjet që krijohen gjatë shërbimeve të anijeve dhe operacioneve të pastrimit, mbetjet e mbledhura rastësisht gjatë lundrimit, si dhe mbetjet nga tepricat e ngarkesave.

31. "Mbetjet nga gomat e automjeteve" janë mbetjet që krijohen nga gomat e vjetruar dhe/ose të dëmtuara të automjeteve.

32. "Mbetje nga ndërtimi dhe shembja" janë mbetjet e krijuara nga veprimtaria e ndërtimit dhe e shembjes.

33. "Mbetjet nga ngarkesat" janë mbetjet e çdo materiali të ngarkuar në bordin e anijes, që mbeten në kuvertën, në hambarin apo në cisternat e anijes, pas operacioneve të ngarkimit dhe shkarkimit, duke përfshirë tepricat e ngarkimeve e të shkarkimeve dhe derdhjet, qofshin ato të lagështa, të thata ose të bartura nga uji i shpëlarjes, me përjashtim të pluhurit të ngarkesës që mbetet në kuvertë pas fshirjes ose pluhurit në sipërfaqet e jashtme të anijes.

34. "Mbetje të ambalazheve" janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në këtë ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre.

35. "Mbetje të rrezikshme" janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në shtojcën 3 bashkëlidhur këtij ligji.

36. "Mbetje të rrezikshme shtëpiake" janë mbetjet shtëpiake, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e "mbetjeve të rrezikshme".

37. "Mbetje jo të rrezikshme" janë mbetjet të cilat nuk shfaqin vetitë e mbetjeve të parashikuara në pikën 35 të këtij neni.

38. "Menaxhim i integruar i mbetjeve" është grumbullimi, transporti, rikuperimi, përfshirë ndarjen, dhe asgjësimi i mbetjeve e mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

39. "Ministër" është ministri përgjegjës për mjedisin.

40. "Ministria" është ministria përgjegjëse për mjedisin.

41. "Operator" është personi që:

a) është përgjegjës për vendin e asgjësimit ose të rikuperimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Personi përgjegjës në fazën e përgatitjes mund të jetë i ndryshëm nga personi përgjegjës në fazën e kujdesit të mëtejshëm pas mbylljes së *landfill*-it;

b) kontrollon impiantin e incinerimit të mbetjeve.

42. "Parandalim" janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:

a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;

b) ndikimi negativ i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;

c) përmbajtja e substancave të rrezikshme në materiale dhe produkte.

43. "PCB/PCT" është bifenilet e poliklorinuara, trifenilet e poliklorinuara, monometil-tetraklorodifenil metani, mono-metil-dikloro-difenil metani, monometil-dibromo-difenil metani dhe çdo përzierje që përmban cilëndo nga substancat e përmendura më lart në masë mbi 0,005 për qind të peshës së saj.

44. "Person" është personi fizik dhe personi juridik në kuptimin e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

45. "Përgatitje për ripërdorim" janë operacionet e rikuperimit dhe përkatësisht kontrolli, pastrimi ose riparimi, me anë të të cilave produktet ose përbërësit e produkteve, që janë kthyer në mbetje, përgatiten për t'u ripërdorur pa iu nënshtruar ndonjë procesi tjetër përpunimi paraprak.

46. "Plastikë" është një polimer të cilit mund t'i jenë shtuar aditivë apo substanca nga lëndë të tjera dhe është i aftë të kryejë funksionin kryesor lidhës të komponentit strukturor të një qeseje mbajtëse.

47. "Produkt plastik njëpërdorimësh" është një produkt që përbëhet plotësisht apo pjesërisht nga

plastika dhe që nuk është konceptuar, projektuar ose hedhur në treg me qëllim që të kryejë një përdorim të shumëfishtë dhe të shumëllojshëm gjatë jetës së tij, duke ia kthyer prodhuesit për rimbushje ose duke e përdorur për të njëjtin qëllim për të cilin u projektua.

48. "Qese mbajtëse plastike" është qesja mbajtëse, transportuese me ose pa vesh, e prodhuar nga plastika, që i vihet në dispozicion konsumatorit në pikën e shitjes.

49. "Qese mbajtëse plastike e lehtë" është qesja mbajtëse, transportuese me ose pa vesh, e prodhuar nga plastika, me trashësi për çdo anë më të vogël se 70 mikronë.

50. "Qese mbajtëse plastike e oxo-degradueshme" është qesja plastike mbajtëse e prodhuar nga materiale që përfshijnë aditivë, të cilët katalizojnë copëzimin e materialit plastik në mikrofragmente.

51. "Qese plastike higjieno-sanitare" është qesja plastike mbajtëse apo transportuese pa vesh, e cila shërben për grumbullimin, paketimin dhe/ose transportimin e mbetjeve.

52. "Riciklim" është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t'i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë rimbushëse.

53. "Rigjenerim i vajrave të përdorura" është çdo operacion riciklimi, me anë të të cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë, duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.

54. "Rikuperim" është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar;

b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë në veprimtarinë ekonomike. Operacionet e rikuperimit përfshihen, por pa u kufizuar, në shtojcën 2 që i bashkëlidhet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij.

55. "Rikuperim i materialeve" është çdo operacion rikuperimi, me përjashtim të operacioneve për rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin e mbetjeve, duke i kthyer në materiale që do të përdoren si lëndë djegëse apo mjete të tjera për prodhimin e energjisë. Këtu përfshihen, ndër të tjera, përgatitja për ripërdorim, riciklim dhe rimbushje.

56. "Rimbushje" është çdo operacion rikuperimi ku mbetje të përshtatshme jo të rrezikshme përdoren për qëllime bonifikimi në zonat e gërmuara ose për qëllime të ndërhyrjeve inxhinierike në peizazh. Mbetjet e përdorura për rimbushje zëvendësojnë materialet që nuk janë mbetje dhe të jenë të përshtatshme për qëllimet e sipërpërmendura, si dhe të kufizohen me sasinë e nevojshme për të arritur qëllimet e sipërpërmendura.

57. "Ripërdorim" është çdo operacion me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin ishin krijuar.

58. "Ruajtja paraprake" është mbajtja në vendin ku krijohen mbetjet, me qëllim ruajtjen e mbetjeve para grumbullimit dhe kryerja e operacioneve të ndarjes paraprake të mbetjeve përpara dërgimit për trajtim të mëtejshëm.

59. "Skema e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit" është tërësia e masave, të cilat sigurojnë që subjektet prodhuese mbartin përgjegjësinë financiare ose përgjegjësinë financiare dhe organizative për menaxhimin e asaj faze të ciklit të jetës së produktit që quhet mbetje.

60. "Subjekt prodhues" është një term i përdorur në kuadër të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe përfshin të gjithë personat fizikë apo juridikë që në bazë profesionale zhvillojnë, prodhojnë, përpunojnë, trajtojnë, shesin apo importojnë produkte.

61. "Stacion transferimi" është një vend i caktuar ose një mjet i lëvizshëm, ku mbetjet, pas grumbullimit, dërgohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme, me qëllim ndryshimin e mjetit të transportit të mbetjeve, ku mund të kryhen edhe operacione ndihmëse, të tilla si: ndarja dhe/ose ngjeshja e mbetjeve, ndryshimi i mjetit të transportit të mbetjeve dhe operacione të ngjashme ndihmëse, përpara dërgimit drejt impiantit të trajtimit.

62. "Teknika më të mira të disponueshme" nënkupton të njëjtin kuptim siç parashikohet në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

63. "Trajtim" janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

64. "Transportim" është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.

65. "Tregtar" është çdo person që vepron si palë kryesore në blerjen dhe më pas në shitjen e mbetjeve, përfshirë çdo person që nuk i merr fizikisht mbetjet në posedim.

66. "Vajra të përdorura" janë të gjitha vajrat lubrifikuese ose industriale, minerale apo sintetike, që nuk janë më të përshtatshme për përdorimin për të cilin ishin paracaktuar, të tilla si vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.

67. "Vendndodhja e mbetjeve" është çdo vend ku, sipas këtij ligji, kryhen operacionet e trajtimit të mbetjeve, përfshirë depozitimin e përhershëm të mbetjeve.

68. "Zona e menaxhimit të mbetjeve" është territori nën juridiksionin e bashkive që formojnë zonën e menaxhimit të mbetjeve, sipas miratimit të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, brenda të cilit kryhen operacione të menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel ndërvendor.

69. "Zotërues i mbetjeve" është krijuesi i mbetjeve ose çdo person fizik ose juridik që ka posedimin e mbetjeve.

Neni 5
Parime të përgjithshme

1. Menaxhimi i integruar i mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë është çështje e interesit publik.

2. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet duke respektuar:

a) parimet e mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e mjedisit;

b) parimet e ekonomisë qarkulluese, që i konsideron mbetjet si burim;

c) parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, përfshirë barazinë gjinore, si dhe ndikimin e përgjithshëm ekonomik e social;

ç) parimin "ndotësi paguan" sipas parashikimit në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit;

d) hierarkinë e mbetjeve.

3. Menaxhimi i integruar i mbetjeve kryhet sipas kritereve të efikasitetit, eficiencës, leverdisë ekonomike, transparencës dhe fizibilitetit teknik e ekonomik, për të garantuar një sistem të qëndrueshëm dhe proporcional. Sistemi i menaxhimit të integruar të mbetjeve mbështetet edhe në bashkëpunimin e subjekteve të përfshira në prodhimin, shpërndarjen, përdorimin, konsumin e produkteve, prej të cilave krijohen mbetje.

4. Institucionet dhe subjektet përgjegjëse marrin masat e nevojshme që mbetjet të menaxhohen pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, duke garantuar që të mos vihen në rrezik ujërat, ajri, toka, përfshirë tokat bujqësore, bimët ose kafshët dhe të mos shkaktohen shqetësime përmes zhurmës ose erës së pakëndshme, të mos ndikohen negativisht zonat rurale ose zonat që gëzojnë mbrojtje të veçantë.

Neni 6
Hierarkia e mbetjeve

1. Legjislacioni, politikat, strategjitë, planet, programet dhe masat e ndërmarra për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, si edhe lejet e licencat përkatëse dhe aktivitetet e përditshme të menaxhimit të mbetjeve zbatojnë hierarkinë e mbetjeve sipas renditjes së mëposhtme:

a) parandalimin e mbetjeve;

b) përgatitjen e mbetjeve për ripërdorim;

c) riciklimin e mbetjeve;

ç) rikuperime të tjera të mbetjeve;

d) asgjësimin e mbetjeve.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregullat për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve që japin rezultatet më të mira për mjedisin. Në këto rregulla parashikohen edhe përjashtimet që lejojnë që për rryma të veçanta mbetjesh të mos zbatohet hierarkia e mbetjeve. Përjashtimi lejohet vetëm në rast se justifikohet nga analiza e ciklit të plotë të jetës së mbetjeve dhe e impaktit të përgjithshëm që kanë mbetjet që nga krijimi dhe deri në menaxhimin e tyre.

3. Për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë e juridikë, që angazhohen në menaxhimin e integruar të mbetjeve, përdorin instrumentet ekonomike dhe masat e tjera nxitëse të shtojcës 6 të këtij ligji.

Neni 7
Nënproduktet

1. Për qëllime të këtij ligji, një substancë ose një objekt, që përftohet gjatë një procesi prodhimi, qëllimi kryesor i të cilit nuk është prodhimi i kësaj substance apo i këtij objekti, konsiderohet se nuk është mbetje, por nënprodukt vetëm në qoftë se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) është e sigurt që substanca ose objekti do të ketë përdorim të mëtejshëm;

b) substanca ose objekti mund të përdoret drejtpërdrejt pa iu nënshtruar ndonjë përpunimi të mëtejshëm, përveç atyre të parashikuara nga praktika normale industriale;

c) substanca ose objekti prodhohet si pjesë përbërëse e procesit të prodhimit;

ç) përdorimi i mëtejshëm i kësaj substance ose i këtij objekti është i ligjshëm, në kuptimin që substanca ose objekti i përmbush të gjitha standardet e produktit dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit nga përdorimi dhe nuk ka një ndikim të përgjithshëm negativ në mjedis apo në shëndetin e njeriut.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kriteret dhe procedurat për klasifikimin si nënprodukte dhe jo si mbetje, në përputhje me kushtet e pikës 1 të këtij neni.

Neni 8
Fundi i statusit mbetje

1. Për qëllim të këtij ligji, mbetja, që ka pësuar një operacion riciklimi ose operacione të tjera rikuperimi, pushon së qeni mbetje vetëm në qoftë se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) substanca ose objekti do të përdoret për qëllime të caktuara;

b) ekziston tregu apo kërkesa për atë substancë ose objekt;

c) substanca ose objekti plotëson kërkesat teknike për përdorimin e caktuar dhe është në përputhje me legjislacionin ekzistues dhe standardet që zbatohen për këto produkte;

ç) përdorimi i substancës ose objektit plotëson të gjitha kërkesat për mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit dhe nuk sjell ndikime të përgjithshme negative në mjedis ose në shëndetin e njeriut.

2. Çdo person fizik ose juridik, që përdor për herë të parë një material që ka pushuar së qeni mbetje dhe nuk është hedhur në treg, ose hedh për herë të parë në treg një material që ka pushuar së qeni mbetje, sigurohet që materiali përmbush:

a) kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni;

b) kriteret e legjislacionit të posaçëm për kimikatet;

c) kriteret e legjislacionit të posaçëm për produktin përkatës.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kriteret dhe procedurat e posaçme për njohjen e fundit të statusit "mbetje" për çdo lloj mbetjeje. Këto kritere sigurojnë mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njeriut, lehtësojnë përdorimin e kujdesshëm dhe të arsyeshëm të burimeve natyrore dhe përfshijnë të paktën:

a) kërkesën që në operacionet e rikuperimit të përdoren materiale të lejuara mbetjesh;

b) kërkesën që të përdoren procese dhe teknika të lejuara trajtimi;

c) kritere cilësie sipas standardeve për produktet përkatëse, që plotësohen nga materialet që kanë pushuar së qeni mbetje pas operacioneve të rikuperimit dhe, kur është e nevojshme, vlera kufi të ndotësve;

ç) kërkesën që sistemet e menaxhimi të kenë aftësinë të tregojnë se zbatohen kriteret e fundit të statusit "mbetje" dhe që të përfshijnë kontrollin e cilësisë, vetëmonitorimin dhe, kur është e nevojshme, akreditimin;

d) kërkesën për deklaratën e konformitetit.

Neni 9
Klasifikimi dhe katalogu i mbetjeve

1. Në kuadër të këtij ligji, mbetjet klasifikohen, mbi bazën e origjinës së krijimit, në mbetje shtëpiake dhe mbetje nga veprimtari të tjera dhe, mbi bazën e karakteristikave të rrezikshmërisë, në mbetje të rrezikshme dhe mbetje jo të rrezikshme.

2. Klasifikimi sipas pikës 1 të këtij neni bëhet nga katalogu i mbetjeve, që përmban listën e mbetjeve sipas origjinës dhe përbërjes së tyre dhe, kur është e nevojshme, edhe sipas vlerave kufi të përqendrimit të substancave të rrezikshme. Katalogu i mbetjeve

miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

3. Katalogu i mbetjeve përfshin mbetjet e rrezikshme që klasifikohen si të tilla në përputhje me vetitë e mbetjeve të përcaktuara në shtojcën 3 të këtij ligji. Klasifikimi i një mbetjeje në katalogun e mbetjeve si mbetje e rrezikshme është detyrues.

4. Ndalohet hollimi apo përzierja e mbetjeve të rrezikshme me mbetje të tjera, me qëllim uljen e përqendrimeve fillestare të substancave të rrezikshme në një nivel më të ulët se vlera kufi, që i përkufizon mbetjet si të rrezikshme, me qëllim riklasifikimin e tyre si mbetje jo të rrezikshme.

5. Pavarësisht se një substancë ose objekt gjendet në katalogun e mbetjeve, ajo konsiderohet si e tillë vetëm në rastet kur përmbush parashikimet e pikës 20 të nenit 4 të këtij ligji.

6. Ministria, të paktën çdo 2 vjet, analizon nëse është i nevojshëm rishikimi i katalogut të mbetjeve, veçanërisht në rastet kur evidenton një mbetje të re të rrezikshme ose kur konstaton se një mbetje e klasifikuar si e rrezikshme nuk shfaq vetitë e listuara në shtojcën 3. Në këto raste dhe në raste të tjera, kur është e nevojshme, ministri i propozon Këshillit të Ministrave rishikimin e katalogut të mbetjeve, me qëllim përditësimin dhe përshtatjen e tij.

7. Katalogu i mbetjeve dhe çdo rishikim i tij publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

KREU II
KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 10
Parandalimi i mbetjeve

1. Parandalimi i mbetjeve kryhet nëpërmjet masave të parashikuara në Programin Kombëtar të Parandalimit të Mbetjeve, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, në përputhje me parashikimet e nenit 66 të këtij ligji.

2. Masat për parandalimin e mbetjeve në nivel sektorial, zonal apo vendor parashikohen, sipas rastit, edhe në planet sektoriale, zonale apo vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të parashikuara në nenet 63-65 të këtij ligji. Në çdo rast, këto masa janë në përputhje me masat e parashikuara në Programin Kombëtar të Parandalimit të Mbetjeve dhe me parashikimet e këtij ligji.

Neni 11
Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve

1. Masat për nxitjen e përgatitjes për ripërdorim të mbetjeve përcaktohen në Strategjinë Kombëtare, planin sektorial, zonal ose vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve, sipas parashikimeve të kreut V të këtij ligji dhe përfshijnë:

a) masa për ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit;

b) masa që u lehtësojnë rrjeteve të ripërdorimit dhe të riparimit akses te mbetjet që përgatiten për ripërdorim, të grumbulluara nga persona fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e grumbullimit të mbetjeve;

c) masa që promovojnë përdorimin e instrumenteve ekonomike;

ç) kritere specifike në procedurat e prokurimit publik;

d) përmbushjen e objektivave sasiorë;

dh) masa që inkurajojnë zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit;

e) masa të tjera të përshtatshme për realizimin e këtij qëllimi.

2. Për të nxitur riciklimin me cilësi të lartë, mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, miraton kriteret, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve.

Neni 12
Rikuperimi i mbetjeve

1. Për kryerjen e operacioneve të përgatitjes për ripërdorim, të riciklimit dhe të rikuperimeve të tjera të mbetjeve në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe me parimet e këtij ligji:

a) mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar sipas nenit 11 të këtij ligji dhe nuk përzihen me mbetje apo materiale të tjera që janë të ndryshme në përbërje, përveçse në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni;

b) mbetjet e rrezikshme, substancat, përzierjet apo përbërësit e rrezikshëm eliminohen përpara apo gjatë rikuperimit, me qëllim trajtimin e tyre në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Lejohen përjashtime nga detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni në rastet kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur grumbullimi i disa lloje mbetjesh së bashku nuk pengon që këto mbetje t'i nënshtrohen përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe cilësia e materialit është e ngjashme me cilësinë e materialit që përftohet nga operacionet e përgatitjes për ripërdorim, riciklim dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar;

b) kur grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk jep rezultatin më të mirë për mjedisin, duke konsideruar ndikimet e përgjithshme në mjedis nga menaxhimi i rrymave përkatëse të mbetjeve;

c) kur grumbullimi i diferencuar i mbetjeve nuk është teknikisht i realizueshëm duke konsideruar praktikat më të mira të grumbullimit të mbetjeve;

ç) kur grumbullimi i diferencuar shkakton kosto ekonomike joproporcionale, që llogariten duke konsideruar këto elemente:

i. kostot e ndikimit negativ në mjedis dhe në shëndet që shkaktohen nga grumbullimi dhe trajtimi i padiferencuar i mbetjeve;

ii. potencialin e rritjes së eficiencës së grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;

iii. të ardhurat nga shitja e lëndëve të para dytësore;

iv. zbatimin e parimit "ndotësi paguan" dhe të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kriteret dhe procedurat e posaçme të operacioneve të rikuperimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për përjashtimin nga detyrimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Ministri shqyrton rregullisht kriteret dhe procedurat për përjashtimin nga detyrimi i grumbullimit të diferencuar, sipas pikës 2 të këtij neni, duke konsideruar praktikat më të mira të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe zhvillimet në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimet e nevojshme.

Neni 13

Objektivat dhe metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklim dhe rikuperime të tjera të mbetjeve

1. Objektivat e përgatitjes së mbetjeve për ripërdorim, riciklim dhe rikuperime të tjera të rrymave të mbetjeve përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e saj të veprimit, që miratohet sipas parashikimeve të nenit 62 të këtij ligji.

2. Metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave, viti në të cilin fillon detyrimi për përmbushjen e objektivave, si dhe afatet e ndërmjetme përcaktohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në:

a) situatën faktike të NJQV-ve;

b) analizën e sasive totale të mbetjeve bashkiake;

c) aftësinë teknologjike për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim;

ç) metodologjinë e përmbushjes së objektivave;

d) peshën e mbetjeve bashkiake të krijuara dhe të përgatitura për ripërdorim ose të ricikluara në një vit të caktuar kalendarik që llogaritet si më poshtë:

i. pesha e mbetjeve bashkiake të përgatitura për ripërdorim llogaritet si pesha e produkteve ose përbërësve të produkteve që janë kthyer në mbetje bashkiake dhe u janë nënshtruar të gjitha operacioneve të nevojshme të kontrollit, pastrimit ose riparimit për të mundësuar ripërdorimin pa iu nënshtruar ndarjes apo përpunimit paraprak të mëtejshëm;

ii. pesha e mbetjeve bashkiake të ricikluara llogaritet si pesha e mbetjeve, të cilat, pasi u janë nënshtruar të gjitha kontrolleve, ndarjes dhe operacioneve të tjera paraprake të nevojshme për të hequr materialet e mbetjeve që nuk trajtohen në proceset e mëvonshme të ripërpunimit dhe që garantojnë riciklimin me cilësi të lartë, u nënshtrohen operacioneve të riciklimit ku mbetjet ripërpunohen për të përftuar produkte, materiale apo substanca.

Neni 14

Asgjësimi i mbetjeve

1. Mbetjet, që nuk i nënshtrohen rikuperimit sipas nenit 12 të këtij ligji, u nënshtrohen

operacioneve të sigurta të asgjësimit, në përputhje me parimet e nenit 5 të këtij ligji, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.

2. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe plani i veprimit përmban objektivat për reduktimin e operacioneve të asgjësimit të mbetjeve.

KREU III
MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE

SEKSIONI I
PËRGJEGJËSIA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE

Neni 15
Përgjegjësitë e menaxhimit të integruar të mbetjeve

Subjektet përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve janë:

a) krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve, i cili ka përgjegjësi për realizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të krijuara apo të zotëruara prej tij;

b) subjekti prodhues, që i nënshtrohet skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, i cili ka përgjegjësinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve që krijohen nga produkti i prodhuar, i përpunuar, i trajtuar, i shitur apo i importuar prej tij;

c) bashkitë, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera, të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, që ndodhen në territorin nën juridiksionin e tyre;

ç) AKEM-i, i cili ka përgjegjësi për infrastrukturën fundore të trajtimit të mbetjeve, që ai ka në administrim.

Neni 16
Përgjegjësia e krijuesit ose zotëruesit të mbetjeve

1. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve është përgjegjës për realizimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të krijuara dhe/ose të zotëruara prej tij, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejet e mjedisit, si dhe me legjislacionin e posaçëm që rregullon rrymat e caktuara të mbetjeve. Në zbatim të këtij detyrimi, krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve sigurohet që mbetjet e krijuara apo të zotëruara prej tij t'u nënshtrohen operacioneve të menaxhimit të integruar të mbetjeve në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) duke kryer menaxhimin e integruar të mbetjeve;

b) duke realizuar menaxhimin e integruar të mbetjeve nëpërmjet një agjenti apo tregtari të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi;

c) duke transferuar apo dorëzuar mbetjet te personat që kryejnë trajtimin e mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) duke i transferuar apo dorëzuar mbetjet te sistemi i grumbullimit të mbetjeve, i ngritur nga bashkia përkatëse;

d) duke i transferuar apo dorëzuar mbetjet te një sistem grumbullimi, i ngritur dhe administruar nga operatorë privatë, brenda territorit ku ndodhen mbetjet dhe vepron në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

2. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve, që dorëzon apo transferon mbetjet te një agjent ose tregtar, nuk çlirohet nga përgjegjësia për kryerjen e plotë të operacioneve të rikuperimit ose asgjësimit të mbetjeve. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve, që dorëzon apo transferon mbetjet te sistemi i grumbullimit të mbetjeve, i ngritur sipas parashikimeve të këtij ligji, ose te një person fizik ose juridik që kryen trajtimin e mbetjeve, çlirohet nga përgjegjësia për kryerjen e plotë të operacioneve të rikuperimit ose asgjësimit të mbetjeve, kur pajiset me dokumentacionin e përshtatshëm ligjor, sipas rastit.

Neni 17
Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese

1. Subjekti prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, përfshihet në skemën e përgjegjësisë së zgjeruar të subjekteve prodhuese.

2. Përgjegjësia e zgjeruar e subjekteve prodhuese rregullohet me ligj të posaçëm.

Neni 18
Përgjegjësia e bashkive

Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe të mbetjeve të

tjera të parashikuara në këtë ligj, që ndodhen në territorin nën juridiksionin e tyre, sipas kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 19
Përgjegjësia e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve

Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje, kanë përgjegjësinë të dorëzojnë mbetjet e grumbulluara ose të transportuara në impiante trajtimi të përshtatshme, që i përmbushin kërkesat e këtij ligji dhe që shoqërohen me dokumentacionin e dorëzimit apo të transferimit, sipas kërkesave të këtij ligji ose legjislacionit të posaçëm.

SEKSIONI II
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 20
Institucionet përgjegjëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve

Autoritetet përgjegjëse që ushtrojnë funksione në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve janë të organizuara si më poshtë:

1. Në nivel qendror, autoritetet përgjegjëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të cilat ushtrojnë kryesisht funksione politikëbërëse, rregullatore, administruese, monitoruese dhe zbatuese janë:

a) ministria përgjegjëse për mjedisin;

b) Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, si strukturë menaxhuese e infrastrukturës fundore të trajtimit të mbetjeve, që janë në administrim të saj;

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

ç) struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit.

2. Bashkitë janë autoritetet përgjegjëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të cilat ushtrojnë kryesisht funksione organizimi, administrimi dhe zbatimi të menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel bashkiak.

Neni 21
Ministria përgjegjëse për mjedisin

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni i nivelit qendror, që drejton politikën shtetërore në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

2. Për zbatimin e funksionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ministria:

a) harton dhe zhvillon politikat, legjislacionin dhe standardet në fushën e menaxhimit të mbetjeve;

b) harton Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve e planin e veprimit dhe monitoron zbatimin e saj;

c) zhvillon dhe mbështet fushatat informuese dhe ndërgjegjësuese për menaxhimin e mbetjeve me fonde publike dhe burime të tjera të ligjshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 22
Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

1. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve është person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si aksionar të shoqërisë është ministria përgjegjëse për mjedisin.

2. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve vepron nën emrin tregtar "Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve" sh.a., dhe me emrin e shkurtuar AKEM.

3. Selia e regjistruar e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve ndodhet në Tiranë.

4. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve mund të krijojë shoqëri dhe degë.

5. Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të këtij ligji, AKEM-i ushtron këto kompetenca kryesore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve:

a) bashkërendon me institucionet e administratës publike, në nivel qendror e vendor, me partnerët ndërkombëtarë, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, për planifikimin territorial të infrastrukturës së mbetjeve dhe funksionimin e tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) zhvillon, koordinon dhe administron infrastrukturën e rrjetit kombëtar të impianteve të trajtimit (rikuperimit dhe asgjësimit) të mbetjeve

gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe mbylljes të tyre;

c) realizon projektet për ngritjen e infrastrukturës fundore të menaxhimit të mbetjeve;

ç) monitoron zbatimin e planeve e të programeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel qendror dhe vendor;

d) organizon punën për edukimin mjedisor, promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve, për realizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe rikuperimin e tyre në shkallë të gjerë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) monitoron zbatimin e detyrimeve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga bashkitë dhe të objektivave të tjerë të menaxhimit të integruar të mbetjeve;

e) koordinon me bashkitë iniciativat dhe veprimet, përfshirë ato ekonomike, për të favorizuar riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve, si dhe për të promovuar tregun e produkteve të rikuperuara dhe përdorimin e tyre nga administrata publike, subjektet tregtare dhe konsumatorët.

6. Organizimi i brendshëm, organet drejtuese dhe mënyra e funksionimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 23
Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin. Për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të këtij ligji, AKM-ja ushtron këto kompetenca kryesore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve:

a) mbledh, përpunon, ruan dhe analizon të dhënat për krijimin dhe trajtimin e mbetjeve, që lidhen me zbatimin e lejeve të mjedisit, në përputhje me standardet e pranuara dhe informon ministrinë dhe palët e tjera të interesuara;

b) organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave për çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me nenin 71 të këtij ligji;

c) kryen vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe licencimin e veprimtarive në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Neni 24
Bashkitë

1. Bashkitë janë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e ndarjes së mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre si pjesë e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në territorin nën juridiksionin e tyre.

2. Për zbatimin e funksionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bashkitë kanë këto kompetenca:

a) grumbullimin e mbetjeve bashkiake dhe rrymave të tjera të mbetjeve të përcaktuara në këtë ligj;

b) grumbullimin e diferencuar të mbetjeve sipas rrymave të caktuara të mbetjeve, në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore zbatuese;

c) kryerjen e të gjitha shërbimeve mbështetëse për realizimin e operacioneve funksionale të grumbullimit të diferencuar dhe të menaxhimit të mbetjeve të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, të tilla si vendosja e kontejnerëve të përshtatshëm të grumbullimit, përcaktimi i metodës së grumbullimit, në përputhje me dokumentet planifikuese në fuqi;

ç) ngritjen e sistemit bashkiak të grumbullimit të mbetjeve dhe përcaktimin e rregullave të grumbullimit, përcaktimin e pikave të grumbullimit, pikave të magazinimit të përkohshëm dhe të stacioneve të transferimit të mbetjeve dhe në përgjithësi të vendndodhjes së infrastrukturës së nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve brenda territorit të bashkisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për planifikimin e zhvillimin e territorit;

d) monitorimin dhe kontrollin e territorit të bashkisë me qëllim parandalimin dhe mbikëqyrjen e hedhjes së paligjshme të mbetjeve në vende të paautorizuara dhe/ose krijimin e venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve dhe, në bashkërendim me organet kompetente, marrjen e masave për ndëshkimin e paligjshmërisë, mbledhjen e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme dhe trajtimin e tyre;

dh) monitorimin dhe kontrollin e territorit të bashkisë për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe bashkëpunimin e koordinimin me institucionet kompetente për marrjen e masave për ndëshkimin e shkeljeve të këtij ligji;

e) organizimin dhe mbështetjen e skemave e të fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese për

menaxhimin e mbetjeve me fonde publike e burime të tjera të ligjshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe masave konkrete për parandalimin e mbetjeve brenda territorit të bashkisë;

ë) mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në territorin e bashkisë, përfshirë të dhënat për vendndodhjen e infrastrukturave të menaxhimit të mbetjeve, të dhëna për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, të dhëna për sasinë e rrymave të caktuara të mbetjeve të grumbulluara dhe të trajtuara në territorin e bashkisë, si dhe çdo të dhënë tjetër të parashikuar në këtë ligj dhe të domosdoshme për realizimin e funksioneve të menaxhimit të mbetjeve nga bashkia. Bashkia, në bazë të detyrimit ligjor, informon për këto të dhëna pranë AKEM-it;

f) raportimin pranë AKEM-it të statistikave vjetore të mbetjeve të krijuara në territorin e tyre;

g) përcaktimin e zërave të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve bashkiake në bazë të nevojave dhe infrastrukturës për rritjen e performancës së këtij shërbimi dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

3. Bashkitë ushtrojnë funksionet e grumbullimit të mbetjeve nëpërmjet:

a) strukturave të tyre ekzistuese administrative apo ngritjes së strukturave administrative të posaçme për këtë qëllim;

b) njësive ekonomike apo institucioneve ekzistuese në varësi të tyre apo ngritjes së tyre për këtë qëllim;

c) personave juridikë publikë ekzistues apo themelimit të personave juridikë publikë për ushtrimin e këtyre funksioneve;

ç) lidhjes së kontratave me subjekte private që ushtrojnë veprimtaritë e sipërpërmendura, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit të posaçëm në fuqi.

4. Për ushtrimin e funksioneve të tyre në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, bashkitë veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacionit të posaçëm për vetëqeverisjen vendore dhe zbatojnë parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.

5. Kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore janë përgjegjës për grumbullimin dhe administrimin e mbetjeve, që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

SEKSIONI III
ZONAT E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Neni 25
Zonat e menaxhimit të mbetjeve

1. Territori i Republikës së Shqipërisë organizohet në zona për menaxhimin e mbetjeve. Për kualifikimin e një territori si zonë e menaxhimit të mbetjeve konsiderohen të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) në zonën e menaxhimit të mbetjeve krijohen impiantet kryesore për trajtimin e mbetjeve ose planifikohet ngritja e tyre;

b) në zonën e menaxhimit të mbetjeve ekziston infrastruktura mbështetëse e trajtimit të mbetjeve ose planifikohet ngritja e saj;

c) vendndodhja dhe shtrirja e zonës së menaxhimit të mbetjeve të jetë e tillë në mënyrë që të mbulojë një territor në mënyrë sa më eficiente;

ç) aksesueshmëria e territorit të mbuluar nga zona e menaxhimit të mbetjeve të jetë në përputhje me kushtet teknike të infrastrukturës rrugore;

d) numri i popullsisë;

dh) sasitë e mbetjeve të krijuara në territorin e mbuluar nga zona e menaxhimit të mbetjeve;

2. Zonat e menaxhimit të mbetjeve miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe janë pjesë e Planit Kombëtar Sektorial të Menaxhimit të Mbetjeve.

3. Transporti ndërzonal i mbetjeve nuk është ekskluzivitet i *landfill*-it të zonës, në përputhje me statusin dhe plotësimin e kritereve nga *landfill*-i, sipas standardeve të BE-së dhe menaxhimit të integruar të tij.

Neni 26
Bashkëpunimi ndërvendor

1. Bashkitë, që përfshihen në një zonë të menaxhimit të mbetjeve, dhe AKEM-i nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor ku përcaktohen:

a) qëllimi i marrëveshjes;

b) procedura dhe kuorumi i vendimmarrjes së bashkive për çdo vendim të nevojshëm në lidhje me funksionimin e veprimtarive të zhvilluara në nivelin e zonës së menaxhimit të mbetjeve;

c) të drejtat dhe detyrimet e bashkive pjesëmarrëse;

ç) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki;

d) struktura organizative e zonës së menaxhimit të mbetjeve;

dh) të drejtat e pronësisë mbi infrastrukturat ekzistuese;

e) detyrimet për ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve kur ajo mungon ose është e pamjaftueshme dhe për mënyrën e bashkëpunimit mes bashkive përkatëse;

ë) mënyra dhe masa e kontributit financiar të secilës bashki;

f) mbledhja e të ardhurave, si dhe përdorimi i të ardhurave dhe përfitimeve të tjera;

g) çdo element tjetër që konsiderohet me rëndësi për përmbushjen e qëllimit të menaxhimit të mbetjeve në zonën përkatëse të menaxhimit të mbetjeve.

2. Marrëveshja e bashkëpunimit për secilën zonë të menaxhimit të mbetjeve miratohet nga këshilli bashkiak i secilës bashki pjesëmarrëse.

3. Marrëveshja e parashikuar në pikën 2 të këtij neni zbaton të gjitha parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

SEKSIONI IV
KOSTOT, INSTRUMENTET EKONOMIKE DHE MASAT E TJERA NXITËSE

Neni 27
Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke përfshirë kostot e infrastrukturës dhe operimit të saj, mbulohen nga krijuesi ose nga zotëruesi i mbetjeve, në përputhje me parimin "Ndotësi paguan".

2. Kostot për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që krijohen nga produktet që i nënshtrohen skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, mbulohen në përputhje me parashikimet e ligjit të posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të subjekteve prodhuese.

3. Kostot për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që janë përgjegjësi e bashkive, mbulohen nga bashkitë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për vetëqeverisjen vendore dhe dispozitat e posaçme të këtij ligji.

4. Kur krijuesi i mbetjeve nuk identifikohet, kostot e pastrimit, grumbullimit, trajtimit dhe rehabilitimit mjedisor të mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme mbulohen nga zotëruesi aktual i mbetjeve. Pas identifikimit të krijuesit të mbetjeve, kostot e pastrimit, grumbullimit, trajtimit të mbetjeve dhe të rehabilitimit mjedisor, si dhe të identifikimit të krijuesit rimbursohen nga krijuesi.

5. Çdo zonë e menaxhimit të mbetjeve mbulon kostot e investimit për ndërtimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake brenda zonës. Të gjitha bashkitë, që janë pjesë e zonës së menaxhimit të mbetjeve, dhe AKEM-i financojnë kostot e investimit të zonës së menaxhimit të mbetjeve në përputhje me parashikimet e marrëveshjeve ndërvendore, sipas nenit 26 të këtij ligji, dhe kompetencave dhe përgjegjësive të tyre. Në rast se kostot e investimit të infrastrukturës nuk përballohen nga buxhetet e bashkive dhe nga zona e menaxhimit të mbetjeve përkatëse, kostot mbulohen nga buxheti i shtetit i Republikës së Shqipërisë, si edhe nga burime të tjera të ligjshme, si: donacione, grante, financime vendase dhe të huaja.

6. AKEM-i planifikon, projekton, koordinon dhe administron rrjetin kombëtar të impianteve të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që përfshijnë ndërtimin, operimin, administrimin dhe mbylljen e tyre.

7. Kostot për pastrimin dhe rehabilitimin e vendeve ekzistuese jashtë standardeve mbulohen nga AKEM-i dhe rimbursohen nga ndotësi.

8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për vetëqeverisjen vendore, miraton metodologjinë e llogaritjes së kostove operative dhe të shërbimit të grumbullimit, pastrimit dhe transportit deri në stacionet e transferimit të mbetjeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 28
Instrumentet ekonomike dhe masa të tjera nxitëse të hierarkisë së mbetjeve

Politikat dhe kuadri ligjor për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve në nivel qendror dhe vendor përfshin instrumentet ekonomike dhe masat nxitëse të parashikuara në shtojcën 6 të këtij ligji, si dhe instrumente dhe masa të tjera të konsideruara të nevojshme sipas rastit.

Neni 29
Burimet e financimit

1. AKEM-i mund të financohet nga:
a) buxheti i shtetit;
b) tarifa hyrëse e pranimit *"gate fee"* në *landfill* dhe/ose incenerator, që përfshin koston e *landfill*-imit (depozitimit) dhe/ose incenerimit në pikën fundore të trajtimit të mbetjeve;
c) të ardhurat nga shitja e materialeve të ricikluesshme;
ç) fondet e donatorëve vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
d) të ardhurat e përftuara nga aktivitetet e saj dhe shërbimet e ofruara;
dh) çdo burim tjetër i ligjshëm.
2. AKEM-i respekton standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë të gjithë veprimtarisë së tij.
3. AKEM-i raporton periodikisht për përdorimin e të ardhurave pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Ministria përgatit raportin vjetor për përdorimin dhe efektivitetin e buxhetit, të cilin ia paraqet ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për ekonominë.
4. Transferta e pakushtëzuar që njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë çdo vit nga buxheti i shtetit nuk ndryshon.

SEKSIONI V
OPERACIONET E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

Neni 30
Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve

1. Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve përfshin impiantet për rikuperimin dhe impiantet për asgjësimin e mbetjeve dhe ngrihet në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve, në nivel ndërvendor, brenda territorit të zonave të menaxhimit të mbetjeve, duke mbajtur në konsideratë:
a) rrethanat gjeografike dhe nevojat për instalimin e impianteve të specializuara për disa lloje mbetjesh;
b) teknikat më të mira të disponueshme;
c) parashikimet e nenit 25 të këtij ligji.
2. Rrjeti i integruar i impianteve udhëhiqet nga parimi i afërsisë dhe vendndodhja e impianteve të jetë e përshtatshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga bashkitë që ndodhen brenda zonës së menaxhimit të mbetjeve, si dhe nga parimi i vetëqëndrueshmërisë që garanton aftësinë e Republikës së Shqipërisë të kryejë vetë operacionet e rikuperimit dhe asgjësimit të mbetjeve të territorit të saj.

Neni 31
Grumbullimi i mbetjeve

1. Bashkitë ngrenë sistemin bashkiak të grumbullimit të mbetjeve dhe përcaktojnë rregullat dhe procedurat e grumbullimit të mbetjeve brenda territorit nën juridiksionin e tyre, si pikat e grumbullimit të mbetjeve, metodat, oraret e grumbullimit dhe të transportit të mbetjeve, si dhe shërbimet e tjera mbështetëse.
2. Sistemi bashkiak i grumbullimit të mbetjeve organizohet në mënyrë që:
a) të garantojë mbulimin e të gjithë territorit nën juridiksionin e bashkisë;
b) të jetë i aksesueshëm nga banorët e territorit nën juridiksionin e bashkisë;
c) të garantojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore;
ç) të jetë i përshtatshëm duke marrë parasysh numrin e popullsisë, sasinë e mbetjeve të krijuara, veprimtaritë ekonomike dhe zhvillimin e territorit nën juridiksionin e bashkisë.
3. Sistemi bashkiak i grumbullimit të mbetjeve i jep përparësi grumbullimit të mbetjeve shtëpiake.
4. Krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve me natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake grumbullon mbetjet në kontejnerë individualë dhe i dorëzon ose i transferon ato në përputhje me rregullat e përcaktuara nga bashkia. Bashkitë lejojnë përdorimin e kontejnerëve publikë nga krijuesi ose zotëruesi i mbetjeve me natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake kur lloji, sasia dhe volumi i mbetjeve të krijuara prej tij nuk pengon grumbullimin e mbetjeve shtëpiake.
5. Bashkitë marrin masa të posaçme për ngritjen e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për mbetjet e ricikluesshme dhe mbetjet bio.
6. Subjekti prodhues i nënshtrohet skemës për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, ngre sistemin

e grumbullimit të mbetjeve të krijuara nga produkti, në përputhje me rregullat dhe përcaktimet e ligjit të posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit. Subjektet prodhuese që zbatojnë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit kanë të drejtë të investojnë dhe të ndërtojnë sistemet e tyre për grumbullimin, transportin dhe trajtimin final të rrymave të mbetjeve që sipas ligjit të posaçëm i nënshtrohen përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

7. Operatorët privatë ngrenë sistemin privat të grumbullimit të mbetjeve në përputhje me kriteret, standardet dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit.

8. Subjektet e përcaktuara në këtë nen kanë detyrimin e njoftimit dhe informacionit periodik 6-mujor pranë AKEM-it të masave të marra për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Neni 32
Ruajtja paraprake

1. Ruajtja paraprake para grumbullimit të mbetjeve për qëllime të grumbullimit ose transportit të tyre drejt impianteve përkatëse të trajtimit kryhet në vendet e mëposhtme:

a) në vendin ku krijohen mbetjet, që përfshin të gjithë territorin e zonës ku zhvillohet aktiviteti që ka krijuar mbetjet;

b) ekskluzivisht për mbetjet që janë subjekt i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, ruajtja paraprake para grumbullimit kryhet nga distributorët në hapësirat e pikës së tyre të shitjes ose të grumbullimit.

2. Ruajtja paraprake para grumbullimit kryhet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) mbetjet, që përmbajnë ndotës organikë të qëndrueshëm, ruhen në përputhje me normat teknike që rregullojnë magazinimin dhe paketimin e mbetjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme;

b) mbetjet grumbullohen dhe dërgohen për operacionet e çmontimit ose të shpërbërjes sipas njërës prej modaliteteve alternative të mëposhtme në zgjedhjen e krijuesit të mbetjeve:

i. kur sasia e mbetjeve në depo arrin gjithsej 30 metra kub, nga të cilët maksimumi 10 metra kub mbetje të rrezikshme;

ii. kur sasia e mbetjeve nuk tejkalon kufirin e përmendur në vit, ruajtja paraprake nuk mund të zgjasë më shumë se një vit.

c) mbetjet janë grupuar sipas kategorive homogjene në përputhje me normat përkatëse teknike, si dhe për mbetjet e rrezikshme, në përputhje me normat që rregullojnë depozitimin e substancave të rrezikshme që përmbajnë;

ç) duke respektuar normat që rregullojnë paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme.

3. Ruajtja paraprake para grumbullimit, që kryhet në kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, nuk kërkon autorizim nga autoritetet kompetente.

4. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për mbetjet bio.

Neni 33
Stacionet e transferimit

1. Stacionet e transferimit janë struktura të palëvizshme ose të lëvizshme, të cilat ngrihen me qëllimin e reduktimit të kostove të transportit të mbetjeve nga pikat e grumbullimit të mbetjeve drejt impiantit të rikuperimit apo asgjësimit përfundimtar.

2. Stacionet e transferimit ngrihen në bazë të analizës së elementeve të mëposhtme:

a) distancës midis vendit të krijimit dhe/ose të grumbullimit të mbetjeve dhe impiantit të rikuperimit apo asgjësimit të mbetjeve;

b) sasisë së mbetjeve që transportohen në vit brenda zonës së menaxhimit të mbetjeve;

c) sigurimit të një vendndodhjeje të përshtatshme që garanton aksesueshmërinë e stacioneve të transferimit;

ç) financimit të nevojshëm për ndërtimin e stacionit të transferimit;

d) sigurimit të stafit e të fondeve për operimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të transferimit e të pajisjeve të nevojshme.

3. Në stacionet e transferimit kryhen edhe operacionet e mëposhtme mbështetëse:

a) ndarja e mbetjeve të ricikluesshme;

b) ndarja e mbetjeve në rryma të ndryshme;

c) ngjeshja e mbetjeve për t'i zvogëluar në përmasa;

ç) operacione të tjera të ngjashme.

4. Stacionet e transferimit kategorizohen në stacione transferimi për mbetje të rrezikshme dhe në stacione transferimi për mbetje jo të rrezikshme dhe pajisen me lejet e mjedisit të përcaktuara sipas ligjit për lejet e mjedisit. Në stacionet e transferimit

pranohen mbetjet bashkiake dhe mbetjet nga ndërtimi.

5. Stacionet e transferimit dhe kostot e tyre të ndërtimit, të mirëmbajtjes dhe të operimit janë pjesë përbërëse e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe parashikohen në planet zonale e vendore.

Neni 34
***Landfill*-i**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit miraton, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, kërkesat teknike dhe operative për mbetjet dhe për *landfill*-et për të përcaktuar masat, procedurat, standardet dhe udhëzimet për krijimin, operimin dhe mbylljen e *landfill*-eve.

2. *Landfill*-et klasifikohen në tri kategori:

a) *landfill*-e për mbetjet e rrezikshme;

b) *landfill*-e për mbetjet jo të rrezikshme;

c) *landfill*-e për mbetjet inerte.

3. Në l*andfill* pranohen mbetjet që i janë nënshtruar trajtimit, me përjashtim të mbetjeve inerte, për të cilat trajtimi është teknikisht i pamundur, dhe të mbetjeve të tjera kur trajtimi i tyre nuk zvogëlon sasinë e mbetjeve ose rrezikun ndaj mjedisit ose shëndetit të njeriut.

4. Në *landfill*-et e mbetjeve të rrezikshme pranohen vetëm mbetje që klasifikohen si të rrezikshme, në përputhje me përkufizimin e këtij ligji dhe që përmbushin kriteret dhe procedurat e pranimit, të përcaktuara sipas këtij neni.

5. Në *landfill*-et e mbetjeve jo të rrezikshme pranohen vetëm:

a) mbetjet bashkiake;

b) mbetjet jo të rrezikshme të çdo origjine tjetër, që përmbushin kriteret dhe procedurat e pranimit të mbetjeve jo të rrezikshme, të përcaktuara sipas këtij neni;

c) mbetjet e rrezikshme joreaktive, të qëndrueshme, (p.sh. të ngurtësuara, të qelqëzuara), me veti rrjedhëse të ngjashme me ato të mbetjeve jo të rrezikshme, të referuara në shkronjën "b" të kësaj pike, dhe që përmbushin kriteret dhe procedurat përkatëse të pranimit, të përcaktuara sipas këtij neni. Këto mbetje të rrezikshme nuk depozitohen në parcelat e destinuara për mbetjet jo të rrezikshme të biodegradueshme.

6. *Landfill*-et për mbetjet inerte përdoren vetëm për mbetjet inerte.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulla për *landfill*-et e mbetjeve, të cilat përmbajnë:

a) kërkesat e përgjithshme të zbatueshme për *landfill*-et dhe masat që do të merren për *landfill*-et ekzistuese;

b) procedurat e pranimit për llojet e mbetjeve që pranohen në kategoritë e ndryshme të *landfill*-eve të mbetjeve;

c) procedurat e kontrollit dhe të monitorimit gjatë fazës operative;

ç) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit pas mbylljes së *landfill*-eve;

d) kërkesat në lidhje me raportimin dhe mbledhjen e të dhënave për trajtimin e mbetjeve në *landfill*-e.

8. Ndërtimi i *landfill*-eve bëhet në nivel ndërvendor, brenda territorit të zonave të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimet e parashikuara në këtë ligj.

9. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kriteret, procedurat dhe standardet e studimit dhe projektzbatimit për ndërtimin dhe mbylljen e kategorive të ndryshme të *landfill*-eve.

10. Përjashtimisht, deri në ndërtimin e *landfill*-eve të mbetjeve inerte në nivel rajonal, sipas zonave të menaxhimit të mbetjeve, ndërtohen vend-depozitime të përkohshme. Rregullat, kërkesat dhe procedurat për venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 35
Mbetjet dhe trajtimet e përjashtuara nga *landfill*-et

1. Ndalohet pranimi në *landfill* i:

a) mbetjeve të lëngshme;

b) mbetjeve që në kushtet e *landfill*-it janë shpërthyese, gërryese, oksiduese, të djegshme ose shumë të djegshme, siç përcaktohen në shtojcën 3 të këtij ligji;

c) mbetjeve spitalore, që krijohen nga qendrat mjekësore ose veterinare, që janë infektuese, siç përcaktohen në shtojcën 3 bashkëlidhur këtij ligji (përbërësi H9);

ç) mbetjeve e substancave kimike që krijohen nga veprimtaritë e kërkim-zhvillimit apo mësimdhënies,

që nuk janë të identifikuara dhe/ose janë të reja dhe efektet e tyre mbi njeriun dhe/ose mjedisin janë të panjohura, si mbetjet nga laboratorët dhe pa u kufizuar vetëm në to;

d) gomave të përdorura në formë të plotë, me përjashtim të gomave të përdorura si material inxhinierik, të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm;

dh) gomave të përdorura të grira, me përjashtim të gomave të biçikletave dhe të gomave me diametër të jashtëm mbi 1 400 mm;

e) baterive industriale dhe të automjeteve elektrike;

ë) mbetjeve të cilat janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për përgatitje për ripërdorim dhe riciklim, me përjashtim të mbetjeve që janë krijuar nga operacionet e mëtejshme të trajtimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, për të cilat trajtimi në *landfill* jep rezultatin më të mirë mjedisor.

f) çdo lloji tjetër të mbetjeve, që nuk plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara në përputhje me pikën 7 të nenit 34 të këtij ligji.

2. Ndalohet hollimi ose përzierja e mbetjeve me qëllim plotësimin e kritereve të pranimit të tyre në *landfill*.

3. Në përputhje me politikat shtetërore të depozitimit të mbetjeve në *landfill*, të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji, dhe për të garantuar menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të përshtatshme për mjedisin, Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe plani i veprimit përmban objektivat për reduktimin e depozitimit në *landfill* të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme dhe mbetjeve të tjera, veçanërisht të mbetjeve bashkiake, të përshtatshme për riciklim apo për ndonjë lloj tjetër rikuperimi.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe pas konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, që mbulojnë fushën e menaxhimit të mbetjeve, përcakton:

a) rregullat për llogaritjen e përmbushjes së objektivave të parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e veprimit;

b) përjashtimin nga pranimi në *landfill* të kategorive të tjera të mbetjeve;

c) ndalimin e pranimit në *landfill*-e të mbetjeve që janë të përshtatshme për riciklim apo për ndonjë lloj tjetër rikuperimi, me përjashtim të mbetjeve për të cilat trajtimi në *landfill*-e jep rezultatin më të mirë mjedisor dhe afatin nga i cili do të nisë ky ndalim.

Neni 36
Garancitë financiare për *landfill*-in

1. Çdo person, që operon ose ka për qëllim të operojë një *landfill*, në përputhje me lejen e mjedisit, duhet të disponojë dhe të sigurojë të gjitha mjetet financiare të nevojshme për të mbuluar kostot e ndërtimit dhe të operimit.

2. Çdo person, që operon ose ka për qëllim të operojë një *landfill*, në përputhje me lejen e mjedisit, duhet të sigurojë garancinë për kostot e mbylljes së *landfill*-it, ndërhyrjet e nevojshme pas mbylljes së *landfill*-it dhe rehabilitimin e mjedisit.

3. Periudha e nevojshme për kujdesin e mëtejshëm për *landfill*-in është të paktën 30 vjet nga mbyllja e *landfill*-it.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe procedurat për garancitë financiare të *landfill*-it, ku përfshihen:

a) objekti dhe kohëzgjatja e garancive;

b) vlera, lloji dhe mënyra e llogaritjes së garancive;

c) formati dhe procedura e miratimit të garancive;

ç) procedura për zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me garancitë;

d) autoriteti kompetent për vlerësimin dhe zbatimin e garancive.

5. AKEM-i përjashtohet nga të gjitha detyrimet për garancitë financiare të *landfill*-it.

Neni 37
Incinerimi i mbetjeve

1. Incinerimi ose bashkincinerimi i mbetjeve kryhet në impiante, të palëvizshme ose të lëvizshme, që përdoren për trajtimin termik të mbetjeve ose për proceset e plazmës.

2. Impianti i incinerimit ose i bashkincinerimit përfshin vendndodhjen e impiantit, të gjitha linjat e incinerimit ose bashkincinerimit, vendin e pranimit dhe të magazinimit të mbetjeve, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, sipas rastit, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura,

pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, pas marrjes së mendimit nga ministri përgjegjës për energjinë, miraton rregullat për incinerimin e mbetjeve, që përfshijnë:

a) specifikimin e kërkesave për incineratorët dhe bashkincineratorët e mbetjeve;

b) procedurat e dorëzimit dhe pranimit të mbetjeve në incineratorë dhe bashkincineratorë;

c) kushtet operacionale të tyre dhe kriteret e autorizimit për ndryshimin e kushteve operacionale;

ç) procedurat e kontrollit dhe të monitorimit të tyre;

d) respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve në ajër, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi dhe procedurat e kontrollit e të monitorimit të shkarkimeve në ajër;

dh) procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm;

e) detyrimet e raportimit, ruajtjes së të dhënave dhe informimit publik;

ë) kushtet dhe kërkesat e tjera të lejes së mjedisit.

4. Nuk pranohen për incinerim mbetjet që janë grumbulluar në mënyrë të diferencuar për qëllime të përgatitjes për ripërdorim dhe riciklim, me përjashtim të mbetjeve që krijohen nga operacionet e mëtejshme të trajtimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar për të cilat operacioni i incenerimit përbën rezultatin më të mirë mjedisor.

Neni 38
Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme

1. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar sipas legjislacionit në fuqi dhe vetëm me mjete që:

a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve që transportohen;

b) janë në përputhje me standardet rrugore;

c) plotësojnë të gjitha kërkesat teknike përkatëse për llojin e mbetjeve që transportohen;

ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

2. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme bëhet në përputhje të plotë me çdo akt tjetër në fuqi për transportin e produkteve jo të rrezikshme dhe në përputhje me parashikimet e neneve 19 e 67 të këtij ligji për licencimin e transportuesve të mbetjeve.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masa për zbatimin e këtij neni, përfshirë sigurimin e gjurmueshmërisë nga krijimi i mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar të tyre.

Neni 39
Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme

1. Personat fizikë ose juridikë, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje jo të rrezikshme, transferojnë mbetjet në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

2. Të gjitha llojet e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen sipas kritereve tekniko-ligjore nga një person te një tjetër, shoqërohen me një dokument transferimi. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

3. Dokumenti i transferimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të transferimit;

b) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të transferuesit;

c) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të personit tek i cili transferohet mbetja (pritësi);

ç) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme që transferohen dhe tipin e konteinerëve në të cilët ndodhen;

d) vendin, kohën dhe datën e transferimit;

dh) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme bashkë me listën e kodeve përkatëse;

e) informacione për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet jo të rrezikshme kanë pësuar deri në këtë çast;

ë) çdo informacion tjetër të nevojshëm në lidhje me origjinën e mbetjeve jo të rrezikshme, dorëzimin, destinacionin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe operacionet e trajtimit.

4. I njëjti dokument transferimi lejohet të mbulojë më shumë se një transfertë mbetjesh jo të rrezikshme nga transferuesi te i njëjti pritës vetëm nëse mbetjet që transferohen janë të ngjashme. Dokumenti i transferimit është i vlefshëm për një periudhë kohe jo më të gjatë se 1 vit.

5. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i ruajnë dokumentet e transferimit për të paktën 2 vjet, të cilat ua vënë në dispozicion strukturës përgjegjëse

inspektuese në fushën e mjedisit. Dokumentet përmbajnë minimalisht përshkrimin e mbetjeve dhe kopjet e dokumenteve të transferimit.

6. Si transferuesi edhe pritësi i mbetjeve i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit një herë në 6 muaj informacion për mbetjet jo të rrezikshme.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe kërkesa të tjera për informacionin që përfshihet në dokumentin e transferimit.

SEKSIONI VI
MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË RREZIKSHME

Neni 40
Menaxhimi i integruar i mbetjeve të rrezikshme

1. Krijimi, grumbullimi, transporti, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe vetëm në kushte që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat që sigurojnë gjurmueshmërinë e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar të tyre, si dhe kontrollin e të dhënave të mbetjeve të rrezikshme, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Personat, që ushtrojnë veprimtari në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve të rrezikshme, pajisen me një leje mjedisi, që përcakton kushtet që duhen përmbushur për të siguruar zbatimin e pikës 1 të këtij neni. Leja për ndikimin në mjedis përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe lëshohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit.

Neni 41
Ndalimi i përzierjes së mbetjeve të rrezikshme

1. Ndalohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme me lloje të tjera mbetjesh të rrezikshme ose me mbetje, substanca apo materiale të tjera, përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Koncepti i përzierjes përfshin edhe hollimin e substancave të rrezikshme.

2. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, lejohet përzierja e mbetjeve të rrezikshme vetëm kur kryhet nga një person fizik ose juridik që zotëron lejen përkatëse për përzierjen e mbetjeve të rrezikshme, që lëshohet kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) përzierja kryhet në përputhje me parimet e nenit 5 të këtij ligji dhe nuk rrit ndikimin negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut;

b) operacioni i përzierjes kryhet në përputhje me teknikat më të mira të disponueshme.

3. Lejet për veprimtaritë e përcaktuara në këtë dispozitë miratohen sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë dhe përfshihen në kategorinë III.1 të shtojcës bashkëlidhur ligjit në fuqi për lejet e mjedisit.

4. Kur mbetjet e rrezikshme janë përzier në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, zbatohen masat e parashikuara në nenet 77 dhe 78 të këtij ligji. Përveç zbatimit të masave të neneve 77 dhe 78, subjektet shkelëse kanë detyrimin të kryejnë me shpenzimet e tyre ndarjen e mbetjeve të rrezikshme të përziera, nëse një gjë e tillë është teknikisht e mundur dhe e nevojshme për të plotësuar kërkesat e nenit 5 të këtij ligji.

5. Kur ndarja e mbetjeve të rrezikshme të përziera nuk është teknikisht e mundur dhe e nevojshme për plotësimin e kërkesave të nenit 5 të këtij ligji, atëherë përzierja duhet të trajtohet në një impiant, i cili është pajisur me lejen përkatëse.

Neni 42
Etiketimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në mënyrë të përkohshme vetëm kur ato janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me rregullat dhe standardet për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat dhe standardet për ambalazhimin dhe etiketimin e mbetjeve të rrezikshme gjatë procesit të grumbullimit, transportit dhe magazinimit të përkohshëm.

Neni 43
Mbetjet e rrezikshme shtëpiake

1. Mbetjet e rrezikshme shtëpiake grumbullohen në mënyrë të diferencuar në mënyrë që të mos ndotin rrymat e tjera të mbetjeve bashkiake dhe të trajtohen në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore.

2. Nenet 40, 41, 42 dhe 70 të këtij ligji nuk zbatohen për mbetjet e përziera të krijuara nga sektori familjar.

3. Nenet 42 dhe 70 të këtij ligji nuk zbatohen ndaj pjesëve të ndara të mbetjeve të rrezikshme shtëpiake derisa nuk janë pranuar për grumbullim, asgjësim ose rikuperim nga një person fizik ose juridik, që zotëron lejen përkatëse ose që është regjistruar në përputhje me nenin 67 të këtij ligji.

Neni 44
Transporti i mbetjeve të rrezikshme

1. Transporti i mbetjeve të rrezikshme kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi dhe vetëm me mjete që:

a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve të rrezikshme që transportohen;

b) janë në përputhje me standardet rrugore;

c) plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse të ADR-së;

ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masa për zbatimin e këtij neni, përfshirë sigurimin e gjurmueshmërisë nga krijimi i mbetjeve deri në destinacionin përfundimtar të tyre.

Neni 45
Dorëzimi i mbetjeve të rrezikshme

1. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik ose juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.

2. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e dokumentit të dorëzimit;

b) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të personit të kontaktit të dorëzuesit;

c) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të personit të kontaktit të transportuesit;

ç) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme dhe të marrësit në dorëzim;

d) emrin, adresën, *e-mail*-in, numrin e telefonit dhe informacione të tjera të nevojshme kontakti të krijuesit të mbetjeve;

dh) përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve, sasitë përkatëse, datën e dorëzimit, llojin e paketimit etj.;

e) informacione për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimet e tyre;

ë) çdo informacion tjetër të nevojshëm në lidhje me origjinën e mbetjeve të rrezikshme, dorëzimin, destinacionin e mbetjeve të rrezikshme dhe operacionet e trajtimit.

3. Marrësi në dorëzim brenda 30 ditëve i dërgon dorëzuesit një konfirmim me shkrim për marrjen e mbetjeve të rrezikshme.

4. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një dorëzim mbetjesh të rrezikshme, i përcjell dorëzuesit arsyet e refuzimit.

5. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, ruan dokumentacionin e dorëzimit për të paktën 3 vjet nga data kur fillon dorëzimi dhe ia vë ato në dispozicion strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit. Dokumentacioni përmban të paktën kopje të dokumentit të dorëzimit, kopje të dokumentit të konfirmimit dhe informacion për dorëzimet e refuzuara.

6. Çdo dorëzues, transportues dhe marrës në dorëzim i dërgon çdo 3 muaj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit informacion për dorëzimin e mbetjeve.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni përfshirë formularin e dokumentacionit të dorëzimit.

SEKSIONI VII
NORMAT TEKNIKE MINIMALE

Neni 46
Normat teknike minimale

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloret që përcaktojnë normat teknike minimale për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të parashikuara në këtë ligj, dukë përfshirë këtu edhe transportin, grumbullimin, operacionet e trajtimit, tregtimin dhe ndërmjetësimin.

2. Normat teknike minimale, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni:

a) rregullojnë ndikimet kryesore në mjedis, të shkaktuara nga impiantet e trajtimit të mbetjeve;

b) sigurojnë që mbetjet të trajtohen në përputhje me këtë ligj dhe në veçanti me nenin 5 të tij;

c) marrin në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme për kryerjen e veprimtarive;

ç) në rast së është e përshtatshme, përfshijnë elemente që lidhen me cilësinë e trajtimit dhe kërkesat e procesit.

KREU IV
RRYMAT SPECIFIKE TË MBETJEVE

Neni 47
Vajrat e përdorura

1. Vajrat e përdorura grumbullohen në mënyrë të diferencuar, përveçse kur një gjë e tillë nuk është teknikisht e mundur, duke pasur parasysh praktikat më të mira.

2. Vajrat e përdorura trajtohen duke i dhënë prioritet rigjenerimit ose operacioneve të tjera të riciklimit, të cilat kanë rezultat të barabartë ose më të mirë për mjedisin sesa rigjenerimi.

3. Vajrat e përdorura, që kanë karakteristika të ndryshme, nuk përzihen me njëra- tjetrën dhe as me lloje të tjera mbetjesh apo substancash, nëse kjo përzierje pengon rigjenerimin apo operacione të tjera të riciklimit, të cilat kanë rezultat të barabartë ose më të mirë për mjedisin sesa rigjenerimi.

4. Leja e mjedisit për personat fizikë ose juridikë, që trajton vajra të përdorura, përfshin kushte që sigurojnë trajtimin e tyre, në përputhje me këtë nen.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura. Në këto rregulla përfshihen masa të tilla, si: kërkesat teknike, instrumentet ekonomike dhe marrëveshjet vullnetare.

6. Kjo dispozitë nuk cenon detyrimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 48
Mbetjet bio

1. Bashkitë marrin masat që në territorin nën juridiksionin e tyre mbetjet bio ndahen dhe riciklohen në burim ose grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe nuk përzihen me lloje të tjera mbetjesh.

2. Bashkitë investojnë në krijimin e infrastrukturës për ndarjen në burim dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio, si edhe ngritjen e impianteve të kompostimit në çdo zonë mbetjesh apo një për disa zona, referuar numrit të popullsisë.

3. Mbetjet bio mund të grumbullohen së bashku me mbetje, të cilat kanë përbërje të ngjashme të biodegradimit dhe kompostimit, që plotësojnë standardet për ambalazhet e biodegradueshme nëpërmjet kompostimit dhe biodegradimit.

4. Ministria, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe, sipas rastit, institucione të tjera, përdorin të gjitha instrumentet ekonomike dhe masat e tjera brenda kompetencave të tyre, në mënyrë që:

a) të nxisin riciklimin, përfshirë kompostimin dhe tretjen e mbetjeve bio në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit, si edhe në produkte të cilat plotësojnë standardet e cilësisë së lartë, të përshtatshme sipas përdorimit;

b) të inkurajojnë kompostimin në shtëpi, veçanërisht në zonat rurale;

c) të promovojnë përdorimin e materialeve të prodhuara nga mbetjet bio, që janë të sigurta për mjedisin.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton masat e nevojshme për zbatimin e këtij neni për realizimin e ndarjes në burim apo të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bio nga bashkitë.

Neni 49
Ambalazhet dhe mbetjet e tyre

1. Ndalohet përdorimi, hedhja në treg, prodhimi, importimi ose futja në territorin e Republikës së Shqipërisë e qeseve plastike mbajtëse të lehta, si dhe e qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton masat dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e kësaj pike.

2. Ambalazhet hidhen në treg vetëm nëse plotësojnë kërkesat e përcaktuara në ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas këtij neni. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

a) kërkesat minimale për ambalazhet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi mbi përbërjen e tyre, gjurmueshmërinë, cilësinë e ambalazheve, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit publik dhe të higjienës së produktit;

b) masat e nevojshme për parandalimin e krijimit të mbetjeve të ambalazheve;

c) masat e nevojshme për ngritjen e sistemeve për ripërdorimin apo rikuperimin, përfshirë riciklimin e ambalazheve dhe/ose mbetjeve të tyre;

ç) masat që synojnë zvogëlimin e sasisë së mbetjeve nga ambalazhet, nëpërmjet rikuperimit apo riciklimit, objektivat e riciklimit dhe rikuperimit;

d) rregullat për krijimin, administrimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave për ambalazhet e mbetjet e tyre dhe institucionin përgjegjës, me qëllim monitorimin e përmbushjes së objektivave.

Neni 50
Produktet plastike njëpërdorimëshe

1. Ndalohet përdorimi, hedhja në treg, prodhimi ose importimi në territorin e Republikës së Shqipërisë i produkteve plastike njëpërdorimëshe, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton masat, listën e produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kriteret dhe masat e nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis të disa llojeve të produkteve plastike njëpërdorimëshe.

Neni 51
Ndotësit organikë të qëndrueshëm

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat që ndalojnë prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ), si dhe administrimin e mbetjeve të këtyre ndotësve.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve/PCT-ve, pastrimin nga ndotja apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve/PCT-ve të përdorura.

Neni 52
Bateritë dhe mbetjet e baterive

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton:

a) kërkesat për standardet teknike për hedhjen në treg të të gjitha llojeve të baterive, si dhe ndalimin e hedhjes në treg të baterive që përmbajnë substanca të rrezikshme;

b) kërkesat për grumbullimin, trajtimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve të baterive dhe promovimin e një niveli të lartë të grumbullimit e të riciklimit të tyre;

c) kuotat dhe afatet përkatëse të grumbullimit të mbetjeve të baterive;

ç) rregullat për financimin e grumbullimit, trajtimit, riciklimin e baterive, si dhe për fushatat ndërgjegjësuese për operacionet e sipërpërmendura dhe rregullime financiare të tjera;

d) kërkesat për procedurën e regjistrimit të prodhuesve të baterive.

Neni 53
Automjetet në fund të jetës

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton masat, kriteret dhe standardet për parandalimin e mbetjeve të automjeteve dhe për grumbullimin, ripërdorimin, trajtimin, riciklimin dhe forma të tjera rikuperimi të automjeteve në fund të jetës dhe të pjesëve përbërëse të tyre, me qëllim pakësimin e mbetjeve të destinuara për t'u asgjësuar, përfshirë objektivat e ripërdorimit dhe rikuperimit nga

subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë sektor dhe afatet përkatëse.

Neni 54
Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përcakton masat, procedurat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike, përfshirë:

a) nxitjen e projektimit e të prodhimit të pajisjeve elektrike e elektronike për të lehtësuar ripërdorimin, çmontimin dhe riciklimin e PEE-ve, pjesëve dhe materialeve të tyre përbërëse;

b) grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike;

c) asgjësimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike e elektronike dhe transportimin e tyre;

ç) trajtimin e përshtatshëm të mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike;

d) objektivat e grumbullimit dhe rikuperimit të mbetjeve të pajisjeve elektrike e elektronike dhe afatet përkatëse.

Neni 55
Mbetjet spitalore

1. Menaxhimi i mbetjeve spitalore kryhet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit të posaçëm në fuqi për mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet jo të rrezikshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, miraton kërkesat, procedurat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve spitalore.

Neni 56
Mbetjet e nënprodukteve shtazore

Menaxhimi i mbetjeve të nënprodukteve shtazore kryhet në përputhje me parimet e këtij ligji dhe me kushtet, kriteret, procedurat dhe standardet e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm.

Neni 57
Mbetjet nga ndërtimi dhe shembja

1. Menaxhimi i mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja kryhet nga bashkitë dhe AKEM-i, si administrator i infrastrukturës fundore të mbetjeve, në përputhje me parimet e këtij ligji dhe me parashikimet e legjislacionit të posaçëm që rregullon ndërtimin dhe shembjen dhe, kur është rasti, me parashikimet për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për infrastrukturën, miraton kërkesat, procedurat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja.

Neni 58
Mbetjet e industrisë së dyoksidit të titanit

1. Menaxhimi i mbetjeve nga industria e dyoksidit të titanit kryhet në përputhje me parimet e këtij ligji dhe me parashikimet e legjislacionit të posaçëm, përfshirë, kur është rasti, me parashikimet e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për veprimtarinë minerare, miraton kërkesat, procedurat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve të industrisë së dyoksidit të titanit dhe të mbetjeve të tjera industriale, që nuk trajtohen me legjislacion të posaçëm.

Neni 59
Mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat

1. Menaxhimi i mbetjeve nga anijet dhe nga ngarkesat e anijeve bëhet me qëllim mbrojtjen e mjedisit ujor nga ndikimet negative të shkarkimit të mbetjeve nga anijet e ankoruara në portet e territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe të ministrit përgjegjës për transportin, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin e posaçëm, miraton kërkesat, procedurat dhe standardet për parandalimin e shkarkimit në det të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe nga tepricat e ngarkesave. Këto kërkesa përfshijnë edhe parashikime për përmirësimin e infrastrukturës portuale për grumbullimin e këtyre mbetjeve.

Neni 60
Mbetjet nga gomat e përdorura

1. Gomat e përdorura që nuk ritregtohen, riciklohen nëpërmjet grirjes së tyre dhe përdorimit të granulave si lëndë e parë për industrinë e prodhimit të gomave ose përdoren si lëndë djegëse shtesë për veprimtari të caktuara industriale.

2. Ndalohet në çdo rast djegia e mbetjeve të gomave në mjedise të hapura.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përcakton, rregullat, kriteret, procedurat dhe standardet për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura.

Neni 61
Rryma të tjera mbetjesh

1. Rrymat e mbetjeve të parashikuara në këtë ligj nuk janë shteruese. Në çdo rast, rrymat e mbetjeve menaxhohen në përputhje me parimet e parashikuara në këtë ligj dhe me parashikimet e legjislacionit të posaçëm.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe, sipas rastit, të ministrit përgjegjës të sektorit përkatës, miraton kërkesa, procedurat dhe standardet për menaxhimin e rrymave të tjera të mbetjeve, që nuk janë të përmendura në këtë ligj.

KREU V
STRATEGJI, PLANE DHE PROGRAME

Neni 62
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe plani i veprimit

1. Ministria harton Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe planin e veprimit, në vijim Strategjia Kombëtare, e cila parashikon të paktën:

a) analizën e situatës aktuale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) organizimin dhe funksionimin e zonave ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve, çdo planifikim në lidhje me ndryshimet e tyre, si dhe përshkrimin e rrjetit të integruar të menaxhimit të mbetjeve në territorin e çdo zone të menaxhimit të mbetjeve;

c) masat që duhen marrë për të përmirësuar përgatitjen për ripërdorim, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve pa ndikuar mbi mjedisin;

ç) objektivat specifikë në të gjitha fushat e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe masat specifike, aktivitetet, planin e veprimit dhe afatet për përmbushjen e objektivave, në zbatim të kërkesave të këtij ligji, të legjislacionit të posaçëm dhe akteve nënligjore përkatëse.

2. Shtojca 4 e këtij ligji përmban elementet specifike detyruese që përfshihen në Strategjinë Kombëtare dhe elementet jodetyruese që përfshihen sipas rastit.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton Strategjinë Kombëtare.

4. Strategjia Kombëtare rishikohet dhe, në rast se është e nevojshme, përditësohet çdo pesë vjet.

Neni 63
Plani Kombëtar Sektorial i Menaxhimit të Mbetjeve

1. Plani Kombëtar Sektorial i Menaxhimit të Mbetjeve përcakton:

a) territorin e zonave të menaxhimit të mbetjeve, sipas nenit 25 të këtij ligji;

b) analizën sektoriale dhe territoriale, vizionin dhe objektivat strategjikë të zhvillimit;

c) planin e zhvillimit të sektorit, i cili përmban propozimet me përcaktime territoriale dhe planin e veprimeve;

ç) materialin hartografik shoqërues të zonave të menaxhimit të mbetjeve.

2. Në përfundim të procesit të hartimit të Planit Kombëtar Sektorial, ministria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve depoziton Planin Kombëtar Sektorial për miratim pranë Këshillit Kombëtar të Territorit.

3. Dy vjet përpara përfundimit të Planit Kombëtar Sektorial në fuqi, ministria i propozon Këshillit të Ministrave ngritjen e grupit ndërinstitucional të përkohshëm për hartimin dhe koordinimin e punës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial.

4. Grupi ndërinstitucional i punës përfshin përfaqësues të institucioneve qendrore, vendore, akademikë dhe ekspertë të fushës.

5. Grupi ndërinstitucional i punës drejtohet nga ministri.

Neni 64
Planet zonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Çdo strukturë administruese e zonave të menaxhimit të mbetjeve dhe AKEM-i hartojnë dhe miratojnë planin zonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin e zonës së mbetjeve, në përputhje me Planin Kombëtar Sektorial, me kërkesat e këtij ligji dhe elementet e përcaktuara në shtojcën 7 të këtij ligji.

2. Planet zonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve rishikohen dhe përditësohen të paktën çdo pesë vjet.

3. Struktura administruese e zonës së menaxhimit të mbetjeve raporton çdo vit pranë AKEM-it për zbatimin e masave të planit zonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Neni 65
Planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Çdo bashki harton planin e menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe planin zonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e këtij ligji.

2. Çdo bashki harton planin për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, që krijohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metalin e plastikën, dhe mbetjet bio ose masën e gjelbër nga parqet ose kopshtet e shtëpive. Në këtë plan parashikohen, sipas rastit, masa më shtrënguese sesa masat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare.

3. Planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve miratohen nga këshilli bashkiak, pas miratimit teknik nga AKEM-i dhe përditësohen të paktën çdo pesë vjet.

Neni 66
Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve

1. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përcakton politikat kombëtare për parandalimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim garantimin që rritja ekonomike të mos shoqërohet me ndikime negative në mjedis nga mbetjet e krijuara.

2. Programi Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve përmban objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat për realizimin e tyre, sipas shtojcës 5 të këtij ligji.

3. Ministria harton Programin Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe bashkitë, në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit.

4. Programi Kombëtar i Parandalimit të Mbetjeve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

KREU VI
LEJET E MJEDISIT DHE LICENCIMI

Neni 67
Lejet e mjedisit për operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve

1. Personat fizikë ose juridikë, që synojnë të kryejnë operacione për menaxhimin e integruar të mbetjeve, pajisen me leje mjedisi në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

2. Kërkesa për lejen e mjedisit përmban të paktën informacionet e mëposhtme:

a) adresën e biznesit, adresën e zyrave qendrore dhe numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);

b) vendndodhjen e impiantit të trajtimit të mbetjeve;

c) llojin, kodin, sasinë dhe origjinën e mbetjeve që do të trajtohen;

ç) operacionet e trajtimit të mbetjeve për të cilat kërkohet leja e mjedisit dhe kodet përkatëse;

d) metodat dhe teknologjinë që përdoren;

dh) impiantet dhe instalimet që përdoren, si dhe kapacitetet e tyre;

e) masat e sigurisë dhe masat parandaluese.

3. Lejet e mjedisit, që lëshohen për kryerjen e operacioneve të parashikuara në këtë ligj, përveç kërkesave të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe akteve nënligjore, të miratuara në bazë të këtij ligji, përfshijnë edhe elementet e mëposhtme:

a) vendndodhjen e impiantit të trajtimit të mbetjeve;

b) llojin, kodin, sasinë dhe origjinën e mbetjeve që do të trajtohen;

c) operacionet e trajtimit të mbetjeve;

ç) për çdo lloj operacioni që përfshihet në leje, kërkesat teknike dhe kërkesat që lidhen me vendndodhjen në fjalë;

d) metodat dhe teknologjinë që përdoren;

dh) masat e sigurisë dhe masat parandaluese;

e) metodologjinë e veprimtarisë që përdoret për çdo operacion;

ë) operacionet e nevojshme të monitorimit dhe të kontrollit;

f) dispozitat për mbylljen dhe kujdesin e mëtejshëm, sipas rastit.

4. Leja e mjedisit për incinerimin ose bashkincinerimin e mbetjeve, që shoqërohet me rikuperim energjie, përmban kushtin që rikuperimi i energjisë të kryhet me eficiencë të lartë të energjisë.

5. Kushtet e lejes së mjedisit garantojnë që metodologjia e trajtimit të mbetjeve është në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe me parimet e nenit 5 të këtij ligji.

Neni 68
Licencimi i veprimtarive për menaxhimin e integruar të mbetjeve

1. Licencat për ushtrimin e veprimtarive në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të parashikuara në këtë ligj, jepen në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga "Qendra Kombëtare e Biznesit", pas miratimit të saj nga ministri.

KREU VII
INSPEKTIMI, KËRKESA PËR MBAJTJEN E TË DHËNAVE DHE RAPORTIMET

Neni 69
Inspektimi

1. Subjektet, të cilat kryejnë operacione të trajtimit të mbetjeve, përfshirë subjektet që grumbullojnë apo transportojnë mbetjet si veprimtari profesionale, agjentët apo tregtarët e mbetjeve, si dhe subjektet që krijojnë mbetje janë subjekt i inspektimeve periodike nga autoritetet kompetente.

2. Inspektimi i subjekteve të pikës 1 përfshin inspektimin e origjinës, llojit, sasisë së mbetjeve dhe të operacioneve që janë kryer për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga këto subjekte.

3. Inspektimi kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit të posaçëm që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

4. Inspektimi për rrymat e ndryshme të mbetjeve kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, si dhe nga çdo strukturë përgjegjëse për inspektimin, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ligjeve të posaçme dhe ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

5. Përveç kompetencave të parashikuara në ligjin e posaçëm, që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit kryen edhe këto funksione:

a) verifikon zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit;

b) verifikon nëse operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve kryhen në përputhje me licencat, lejet dhe autorizimet e lëshuara për çdo operacion të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me normat teknike minimale, të parashikuara në nenin 46 të këtij ligji.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 70
Kërkesa për mbajtjen e të dhënave

1. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale, përfshirë krijuesit e mbetjeve të rrezikshme, subjektet që grumbullojnë

ose transportojnë mbetje të rrezikshme ose veprojnë si tregtarë dhe agjentë të mbetjeve të rrezikshme ruajnë në mënyrë kronologjike:

a) të dhëna mbi sasinë, llojin dhe origjinën e mbetjeve, si dhe sasinë e produkteve dhe materialeve që rezultojnë nga përgatitja për ripërdorim, riciklimi ose operacione të tjera të rikuperimit;

b) sipas rastit, destinacionin, shpeshtësinë e grumbullimit, mënyrën e transportit dhe metodën e trajtimit të parashikuar sipas llojit të mbetjeve.

2. Çdo person, i cili pajiset me leje mjedisi, licencë ose autorizim sipas legjislacionit në fuqi, ka detyrimin për mbajtjen, përditësimin dhe raportimin e të dhënave për mbetjet, të parashikuara në kushtet e lejes së mjedisit dhe/ose të autorizimit përkatës.

3. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, i ruajnë të dhënat për mbetjet e rrezikshme për të paktën 3 vjet dhe të dhënat për mbetjet jo të rrezikshme për të paktën 2 vjet.

4. AKM-ja krijon regjistrin elektronik për të mbajtur të dhënat e mbetjeve sipas pikës 1 të këtij neni, për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Personat e parashikuar në pikën 2 më sipër raportojnë çdo 6 muaj të dhënat e mbetjeve në regjistrin elektronik. Të dhënat e mbetjeve janë pjesë e Sistemit të Integruar Mjedisor.

5. Personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit ose zotëruesit të mëparshëm të mbetjes çdo 6 muaj, dokumentacionin që vërteton se operacionet e menaxhimit të mbetjeve janë kryer.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kriteret minimale për operimin e regjistrit elektronik, referuar në pikën 4 të këtij neni.

Neni 71
Të dhënat dhe raportimet

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson të dhënat e raportuara për krijimin, trajtimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve nga personat fizikë dhe juridikë që pajisen me leje apo licencë për ushtrimin e veprimtarisë.

2. AKEM-i mban dhe përditëson të dhënat për sasinë e mbetjeve bashkiake të krijuara brenda territorit të bashkive dhe ja përcjell ato AKM-së çdo vit.

3. Të gjitha bizneset, që operojnë në territorin e bashkisë dhe krijojnë, përpunojnë, grumbullojnë apo trajtojnë mbetje, raportojnë çdo vit në bashki, sipas rrymave specifike të mbetjeve dhe në bazë të legjislacionit përkatës për këto rryma mbetjesh.

4. AKM-ja harton brenda muajit mars të çdo viti raportin vjetor për vitin paraardhës me të dhënat për mbetjet në të gjithë territorin e vendit dhe e publikon në faqen zyrtare të Agjencisë, i cili i vihet në dispozicion publikut.

5. AKM-ja dhe AKEM-i përpunojnë të dhënat në përputhje me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VIII
LËVIZJA NDËRKUFITARE E MBETJEVE

Neni 72
Importi i mbetjeve

1. Ndalohet në të gjitha rastet importi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndalohet në të gjitha rastet kalimi tranzit ndërkufitar i mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 73
Kalimi tranzit i mbetjeve jo të rrezikshme

1. Vetëm mbetjet jo të rrezikshme apo mbetjet inerte kalojnë tranzit përmes territorit të Republikës se Shqipërisë.

2. Kalimi tranzit i mbetjeve jo të rrezikshme lejohet vetëm me autorizim të ministrit.

3. Autorizimi për kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme lëshohet vetëm në përputhje të plotë me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi. Autorizimi i kalimit tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në një vit dhe u nënshtrohet rregullave të përgjithshme, të miratuara në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

4. Në autorizimin për kalimin tranzit të mbetjeve përcaktohen:

a) numri i dokumentit të dorëzimit;

b) lloji dhe sasia e mbetjes për të cilën lëshohet;

c) standardet që lidhen me ambalazhimin e etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;

ç) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.

Neni 74
Eksporti i mbetjeve

1. Eksporti i mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte nga Republika e Shqipërisë kryhet vetëm në bazë të autorizimit të lëshuar nga ministri.

2. Autorizimi për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte lëshohet vetëm në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera në fuqi, që rregullojnë fushën e veprimtarisë.

3. Autorizimi i eksportit të mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte është i vlefshëm për një periudhë kohe deri në një vit dhe u nënshtrohet rregullave të përgjithshme, të miratuara në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

4. Në autorizimin e eksportit të mbetjeve përcaktohen:

a) numri i dokumentit të dorëzimit;

b) lloji dhe sasia e mbetjes për të cilën lëshohet;

c) standardet që lidhen me ambalazhimin e etiketimin e mbetjeve dhe dokumentet shoqëruese gjatë transportit të tyre;

ç) kërkesat për monitorimin dhe raportimin e transfertave të mbetjeve.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat për eksportin e mbetjeve të rrezikshme, jo të rrezikshme e inerte, si dhe formularin e autorizimit.

Neni 75
Lëvizja ndërkufitare e mbetjeve jo të rrezikshme

1. Ministria mban të dhënat e raportuara për çdo transport të mbetjeve jo të rrezikshme brenda, nga dhe përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat, përcakton pikat doganore përmes të cilave lejohet eksporti dhe tranziti i mbetjeve, sipas parashikimeve të nenit 74 dhe këtij neni.

KREU IX
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 76
Ndalime

Ndalohen:

a) hedhja, braktisja, depozitimi apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike dhe jopublike, ku nuk lejohet të hidhen, të depozitohen apo të groposen mbetjet nga individët;

b) hedhja, braktisja, depozitimi apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike dhe jopublike ku nuk lejohet të hidhen apo të groposen mbetjet nga persona që kryejnë veprimtari tregtare dhe që nuk janë të pajisur me leje, licencë apo autorizim për kryerjen e kësaj veprimtarie;

c) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me këtë ligj dhe pa u pajisur me licencat, lejet apo autorizimet e nevojshme;

ç) dërgimi dhe pranimi i mbetjeve në *landfill* ose në impiantin e incinerimit dhe të bashkincinerimit të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, të destinuara për përgatitje për ripërdorim dhe/ose riciklim, me përjashtim të mbetjeve të prodhuara nga trajtimi i mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, nëse incinerimi është zgjidhja më e përshtatshme (e vetme), në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

Neni 77
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e mëposhtme, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë:

1. Çdo person, që përzien mbetje në kundërshtim me nenet 9, pika 4, dhe 41 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

2. Çdo individ, që hedh, braktis, depoziton apo gropos çfarëdolloj mbetjeje në vende publike dhe jopublike, ku nuk lejohet të hidhen apo të groposen mbetjet, në kundërshtim me ndalimin e parashikuar në nenin 76, shkronja "a", të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

3. Çdo person, që asgjëson mbetje në shkelje të nenit 14 të këtij ligji dhe në kundërshtim me normat teknike minimale, sipas nenit 46 të këtij ligji, dënohet

me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

4. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që sipas nenit 16, pika 1, shkronja "a", të këtij ligji i trajton vetë mbetjet, në kundërshtim me normat teknike minimale sipas nenit 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë.

5. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që dorëzon apo transferon mbetjet te një person tjetër që nuk është i autorizuar të marrë dhe të trajtojë ato mbetje, në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë.

6. Çdo person i licencuar, që grumbullon apo transporton mbetje dhe nuk e dërgon atë në një impiant trajtimi të përshtatshëm, në kundërshtim me nenin 19 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

7. Çdo krijues apo zotërues mbetjesh, që grumbullon mbetjet në kundërshtim me parashikimet e pikës 4 të nenit 31 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

8. Ruajtja paraprake e mbetjeve para grumbullimit, e kryer në kundërshtim me parashikimet e nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

9. Çdo person, që ushtron veprimtarinë e stacionit të transferimit në kundërshtim me pikën 4 të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

10. Çdo person i licencuar, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme pa pasur një dokument të vlefshëm transferimi mbetjesh, që plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

11. Çdo person i licencuar, që transferon mbetje jo të rrezikshme apo që merr mbetje jo të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e transferimit të mbetjes, në kundërshtim me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

12. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentet në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

13. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentet në dispozicion autoriteteve përkatëse në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

14. Çdo person, që angazhohet në transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me nenin 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

15. Moszbatimi i detyrimeve të bashkive të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e këtyre njësive, të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

16. Moszbatimi pa arsye të ligjshme i detyrimit të bashkive për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor, të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji, ngarkon me përgjegjësi drejtuesit e bashkive, të cilët dënohen me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

17. Çdo person, që krijon, grumbullon, transporton, magazinon apo trajton mbetje të rrezikshme në kundërshtim me nenet 40 dhe 46 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

18. Çdo person i licencuar, që transporton mbetje të rrezikshme me automjete, që nuk janë në përputhje me nenin 44 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

19. Çdo person, që grumbullon, transporton apo magazinon mbetje të rrezikshme, që nuk janë ambalazhuar apo etiketuar në përputhje me nenin 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

20. Çdo person, që dorëzon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme pa një dokument të vlefshëm dorëzimi, në kundërshtim me nenin 45 të këtij ligji, dënohet

me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

21. Çdo person, që dorëzon mbetje të rrezikshme apo që merr në dorëzim mbetje të rrezikshme, që nuk është në përputhje me dokumentin e dorëzimit, në kundërshtim me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

22. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ruan dokumentacionin në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

23. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk ua vë dokumentacionin në dispozicion autoriteteve përkatëse në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

24. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe që nuk dërgon informacion në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

25. Çdo person, që trajton vajra të përdorura pa leje mjedisi në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

26. Çdo person, që trajton vajra të përdorura në kundërshtim me parashikimet e lejes së mjedisit, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

27. Çdo person, që hedh në treg ambalazhe, të cilat janë në kundërshtim me parashikimet e nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

28. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve, të cilat ndalohet të hidhen në treg sipas nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

29. Çdo person, që hedh në treg, prodhon ose importon në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse të lehta, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 49 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 3 000 000 (tre milionë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara. Për çdo herë që përsëritet shkelja, masa e gjobës rritet me 1 000 000 (një milion) lekë. Pas shkeljes së dytë, përveç gjobës, shkelësi dënohet edhe me revokimin e lejes/licencës së ushtrimit të veprimtarisë profesionale.

30. Çdo person, që asgjëson ose menaxhon ndotës organikë të qëndrueshëm në kundërshtim me nenin 51 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

31. Çdo person, që hedh në treg bateri, në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

32. Çdo person, që grumbullon, trajton, riciklon apo asgjëson mbetje baterish në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

33. Çdo person, që grumbullon, trajton, riciklon dhe rikuperon automjete në fund të jetës dhe pjesët përbërëse të tyre në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

34. Çdo person, që hedh në treg pajisje elektrike dhe elektronike në kundërshtim me nenin 54 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

35. Çdo person, që grumbullon, asgjëson, transporton dhe trajton mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike në kundërshtim me nenin 54 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

36. Çdo person, që trajton mbetjet spitalore në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 6 000 000 (gjashtë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

37. Çdo person, që eliminon ose/përdor nënproduktet me origjinë shtazore në kundërshtim me nenin 56 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

38. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve nga ndërtimi në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

39. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve nga industria e dyoksidit të titanit në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

40. Çdo person, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve nga anijet dhe nga ngarkesat e anijeve, në kundërshtim me nenin 59 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

41. Çdo person, që riciklon gomat e përdorura në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

42. Çdo person, që djeg mbetjet e gomave në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

43. Çdo person, që operon një *landfill* dhe që asgjëson në *landfill* mbetje që nuk lejohet të trajtohen në atë kategori *landfill*-i, të përcaktuar sipas nenit 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

44. Çdo person, që operon një *landfill* dhe që asgjëson në *landfill* mbetje që nuk është trajtuar, në kundërshtim me nenin 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

45. Çdo person, që operon një *landfill* dhe që pranon mbetje në një *landfill*, që nuk plotëson kriteret e pranimit në *landfill*, në kundërshtim me nenin 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

46. Çdo person, që operon një *landfill* dhe që pranon mbetje të përjashtuara apo që asgjëson në *landfill* mbetje të përjashtuara në kundërshtim me nenin 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë.

47. Çdo person, që operon një *landfill* në mospërputhje me lejen e mjedisit apo në mospërputhje me nenin 34 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

48. Çdo person, që operon një *landfill* pa një garanci financiare në kundërshtim me nenin 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

49. Çdo person, që hollon ose përzien mbetje me qëllim plotësimin e kritereve të pranimit të tyre në *landfill* në kundërshtim me pikën 4 të nenit 35, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

50. Çdo person, që operon një incinerator dhe që incineron mbetje në kundërshtim me lejen e mjedisit apo në kundërshtim me nenin 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

51. Çdo person, që operon një incinerator dhe pranon për incinerim mbetjet e grumbulluara në mënyrë të diferencuar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

52. Çdo person, që importon mbetje në Republikën e Shqipërisë në shkelje të nenit 72 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

53. Çdo person, që tranziton mbetje të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në shkelje të nenit 73 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

54. Çdo person, që tranziton mbetje jo të rrezikshme përmes territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, në shkelje të nenit 73 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

55. Çdo person, që eksporton mbetje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa autorizim apo në kundërshtim me autorizimin, në shkelje të nenit 74 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

56. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale pa u pajisur me leje mjedisi, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

57. Çdo person, që kryen veprimtari për trajtimin e mbetjeve në kundërshtim me lejen e mjedisit, dënohet me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

58. Çdo person, që kryen trajtimin e mbetjeve si veprimtari profesionale dhe që nuk ruan dokumentet apo nuk ia vë ato në dispozicion autoriteteve përkatëse, në shkelje të nenit 70 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

59. Çdo person, që transporton mbetje pa licencë apo në kundërshtim me licencën, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

60. Çdo person, që ushtron veprimtarinë e grumbullimit, transportimit, ruajtjes, riciklimit, përpunimit, asgjësimit, tregtimit apo ndërmjetësimit të mbetjeve pa licencë apo në kundërshtim me licencën, në shkelje të nenit 68 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

61. Çdo operator i një venddepozitimi/*landfill*-i ekzistues, që nuk plotëson kërkesat e nenit 80 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 1 950 000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

62. Çdo individ, që hedh, braktis, depoziton apo gropos çfarëdolloj mbetjeje në vende publike dhe jopublike, ku nuk lejohet të hidhen apo të groposen mbetjet, në kundërshtim me ndalimin e parashikuar në nenin 76, shkronja "a", të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

63. Çdo person juridik, që hedh, braktis, depoziton apo gropos çfarëdolloj mbetjeje në vende publike dhe jopublike, ku nuk lejohet të hidhen apo të groposen mbetjet, në kundërshtim me ndalimin e parashikuar në nenin 76, shkronja "b", të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

64. Djegia e mbetjeve në kundërshtim me nenin 76, shkronja "c", të këtij ligji dënohet me gjobë:

a) për shkeljet e kryera nga personi juridik, vlera e gjobës është nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë;

b) për shkeljet e kryera nga personi fizik, vlera e gjobës është nga 3 000 000 (tre milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

Neni 78
Masa administrative

1. Autoritetet kompetente, në rastet e shkeljes së lejes së mjedisit, marrin masat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.

2. Kur shkelja e këtij ligji ka të bëjë me përdorimin e një automjeti, ky i fundit konfiskohet nga autoritetet përkatëse në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Licenca e transportit të mbetjeve, e tregtarit dhe agjentit të mbetjeve shfuqizohet nga ministri, me propozimin e inspektorit, kur shkelen kushtet dhe rregullat e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për ushtrimin e veprimtarisë dhe për këtë ministri njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Inspektori, sipas nevojave të rastit, merr masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 79
Ankimi dhe ekzekutimi

1. Ndaj vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim sipas ligjit për inspektimin.

2. Ndaj vendimeve të organeve të tjera, të marra në zbatim të këtij ligji, bëhet ankim sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.

3. Gjoba e vendosur në zbatim të nenit 77 të këtij ligji përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoba paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e saj ngarkohet zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.

4. Të ardhurat e grumbulluara nga gjobat dhe interesat derdhen në buxhetin e shtetit.

KREU X
DISPOZITA RREGULLUESE

Neni 80
Venddepozitimet/*landfill*-et ekzistuese

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat që parashikojnë dispozitat kalimtare për venddepozitimet/*landfill*-et ekzistuese, që janë në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi.

KREU XI
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 81
Dispozitat kalimtare

1. Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji transformohet në shoqëri aksionare (sh.a.).

2. Infrastruktura fundore e trajtimit të mbetjeve në pronësi shtetërore brenda 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, transferohet në administrim të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

3. Mënyra elektronike e trajtimit të kërkesave dhe procedurat administrative që preken nga ky ligj zbatohen pas përmirësimit të Sistemit të Integruar Mjedisor.

4. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e AKEM-it i kalojnë AKEM sh.a.

Neni 82
Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktin nënligjor në zbatim të nenit 22, pika 6, dhe brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktet nënligjore në zbatim të: nenit 6, pika 2; nenit 7, pika 2; nenit 8, pika 3; nenit 9, pika 2; nenit 10, pika 1; nenit 11, pika 2; nenit 12, pika 3; nenit 13, pika 2; nenit 27, pika 8; nenit 34, pikat 1, 7, 9 e 10; nenit 35, pika 4; nenit 36, pika 4; nenit 37, pika 3; nenit 38, pika 3; nenit 39, pika 7; nenit 40, pika 2; nenit 42, pika 2; nenit 44, pika 2; nenit 45, pika 7; nenit 46, pika 1; nenit 47, pika 5; nenit 48, pika 5; nenit 49, pikat 1 e 2: nenit 50, pikat 1 e 2; nenit 51, pikat 1 e 2; neneve 52, 53, 54, nenit 55, pika 2; nenit 57, pika 2; nenit 58, pika 2; nenit 59, pika 2; nenit 60, pika 3; nenit 61, pika 2; nenit 62, pika 3; nenit 69, pika 6; nenit 70, pika 6; nenit 73, pika 5; nenit 74, pika 5; nenit 75, pika 2, dhe nenit 80 të këtij ligji.

Neni 83
Vazhdimi i efekteve të disa akteve nënligjore

Aktet nënligjore të mëposhtme, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për aq sa nuk bien ndesh me të, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji:

a) vendimi nr. 402, datë 30.6.2021, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve";

b) vendimi nr. 418, datë 27.5.2020, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035";

c) vendimi nr. 641, datë 1.10.2024, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte", i ndryshuar;

ç) vendimi nr. 229, datë 23.4.2014, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që të përfshihet në dokumentin e transferimit", i ndryshuar;

d) vendimi nr. 371, datë 11.6.2014, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", i ndryshuar;

dh) vendimi nr. 798, datë 29.9.2010, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"";

e) vendimi nr. 575, datë 24.6.2015, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", i ndryshuar.

Neni 84
Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", ligji nr. 8094, datë 21.3.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", si dhe çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, me

përjashtim të sa është parashikuar në nenin 83 të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 85
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.10.2025.

Shpallur me dekretin nr. 388, datë 7.11.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

SHTOJCA 1
OPERACIONET E ASGJËSIMIT[2]

D1 Depozitimi nën dhe ose mbi dhe (p.sh. në *landfill* etj.).

D2 Trajtimi në tokë (p.sh. biodegradimi i shkarkimeve të lëngshme ose llumrave në tokë etj.).

D3 Injektimi në thellësi (p.sh. injektimi i shkarkimeve me pompim në puse, kripore apo në vende që nga vetë natyra e tyre janë të përshtatshme për depozitim mbetjesh etj.).

D4 Mbulimi sipërfaqësor, përfshirë vendosjen e mbetjeve të lëngshme ose llumrave në gropa, pellgje ujore apo laguna etj.

D5 *Landfill*-et me projekte inxhinierike të posaçme (p.sh. vendosja në qeliza të veçanta, të renditura njëra pas tjetrës, të cilat mbulohen dhe izolohen nga njëra- tjetra dhe nga mjedisi etj.).

D6 Shkarkimi në një trup ujor, me përjashtim të deteve/oqeaneve.

D7 Shkarkimi në dete/oqeane, përfshirë futjen/depozitimin në shtratin e detit.

D8 Trajtimi biologjik që nuk specifikohet në ndonjë pjesë tjetër të kësaj shtojce, që rezulton me përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen me anë të cilitdo nga operacionet e renditura nga D 1 deri në D 12.

D9 Trajtimi fiziko-kimik që nuk specifikohet në ndonjë pjesë tjetër të kësaj shtojce, që rezulton me përbërje ose përzierje përfundimtare, të cilat shkarkohen me një nga operacionet e renditura nga D 1 deri në D 12 (p.sh. avullimi, tharja, kalcifikimi etj.).

D10 Incinerimi mbi tokë.

D11 Incinerimi në det.

D12 Ruajtja/magazinimi i përhershëm (p.sh. vendosja e kontejnerëve në një minierë etj.).

D13 Përzierja ose bashkimi para se t'i nënshtrohen cilitdo prej operacioneve të renditura nga D1 deri në D 12.

D14 Riambalazhimi para se t'i nënshtrohet cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 13.

D15 Ruajtja/magazinimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 14 (me përjashtim të ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

SHTOJCA 2
OPERACIONET E RIKUPERIMIT

R 1 Përdorimi kryesisht si lëndë djegëse ose mënyra të tjera për prodhimin e energjisë. Kjo përfshin impiantet e incinerimit, që përdoren për përpunimin e mbetjeve të ngurta bashkiake vetëm kur eficienca e energjisë është e barabartë me ose më e madhe se:

- 0,60 për impiantet që janë operative dhe kanë marrë një leje mjedisi në përputhje me legjislacionin përkatës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- 0,65 për impiantet që kanë marrë një leje mjedisi në përputhje me legjislacionin përkatës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Duke përdorur formulën e mëposhtme: Eficienca e energjisë = (Ep -(Ef + Ei)) / (0,97 x (Eë + Ef))

Ku:

Ep - është energjia vjetore e prodhuar si nxehtësi ose elektricitet. Është llogaritur me energji në trajtë elektriciteti shumëzuar me 2,6 dhe nxehtësi e prodhuar për përdorim tregtar e shumëzuar me 1,1 (GJ/vit).

Ef - është *in-put*-i vjetor i energjisë në sistem nga lëndët djegëse që kontribuojnë në prodhimin e avullit (GJ/vit).

Eë - është energjia vjetore që përmbahet në mbetjet e trajtuara të llogaritura, duke përdorur vlerën kalorifike neto të mbetjeve (GJ/vit).

Ei - është energjia vjetore e importuar duke përjashtuar Eë dhe Ef (GJ/vit).

[2] *Shtojca 1 ka efekt ilustrues.*

0,97 - është një faktor që merr parasysh humbjet e energjisë për shkak të hirave fundorë dhe rrezatimit.

R 2 Rikuperimi/rikrijimi i solventëve/tretësve.

R 3 Riciklimi/përtëritja e substancave organike që nuk janë përdorur si solventë/tretës (përfshirë përzierje plehrash dhe të tjera procese të transformimit biologjik). Ky përfshin gazifikimin dhe pirolizën, që i përdorin këta përbërës si kimikate.

R 4 Riciklimi/ripërtëritja e metaleve dhe komponimeve të tyre.

R 5 Riciklimi/ ripërtëritja e materialeve të tjera inorganike. Ky përfshin pastrimin e tokës, që rezulton me rikuperimin e dheut dhe riciklimin e materialeve inorganike të ndërtimit.

R 6 Ripërtëritja e acideve ose bazave.

R 7 Rikuperimi i përbërësve të përdorur për luftimin e ndotjes.

R 8 Rikuperimi i komponentëve të katalizatorëve.

R 9 Rirafinimi i naftës ose ripërdorime të tjera të saj.

R 10 Trajtimi i tokës që rezulton në të mirë të bujqësisë ose të përmirësimit ekologjik.

R11 Përdorimi i mbetjeve të përftuara nga cilido nga operacionet e renditura nga R 1 deri në R 10.

R 12 Shkëmbimi i mbetjeve për t'iu nënshtruar cilitdo nga operacionet e renditura nga R 1 deri tek R 11. Në qoftë se nuk ka një kod tjetër të përshtatshëm R, ky mund të përfshijë operacionet paraprake para rikuperimit përfshirë parapërpunimin siç është, *inter alia*, çmontimi, grumbullimi i diferencuar, thyerja/copëtimi, ngjeshja, peletizimi, tharja, grirja, zbutja, riambalazhimi, ndarja, bluarja apo përzierja para dorëzimit në cilindo nga operacionet e numëruara R1 deri R11.

R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim të ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

SHTOJCA 3
VETITË E MBETJEVE QË I KLASIFIKOJNË ATO SI TË RREZIKSHME

H P1 "Shpërthyese"

"Eksploziv": mbetje të cilat me reaksion kimik mund të prodhojnë gaz në një temperaturë dhe presion të tillë dhe me shpejtësi të tillë që të shkaktojnë dëme në mjedis. Përfshihen mbetjet piroteknike, mbetjet e peroksidit organik shpërthyes dhe mbetjet vetëreaktive shpërthyese.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara sipas njërit prej kodeve të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodeve të deklaratës së rrezikut të paraqitur në tabelën 1, mbetjet do të vlerësohen për HP 1, aty ku është e përshtatshme dhe proporcionale, sipas metodave të testimit. Nëse prania e një lënde, një përzierjeje ose një artikulli tregon se mbetjet janë shpërthyese, ato do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 1.

Tabela 1: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi (et) e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 1*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	Kodet e deklaratës së rrezikut
Shpërthyes i paqëndrueshëm (Unst. Expl 1)	H 200
Shpërthyes 1.1 (Expl 1.1)	H 201
Shpërthyes 1.2 (Expl 1.2)	H 202
Shpërthyes 1.3 (Expl 1.3)	H 203
Shpërthyes 1.4 (Expl 1.4)	H 204
Vetëreaktiv A (Self-react. A)	H 240
Peroksid organik A (Org. Perox. A)	
Vetëreaktiv B (Self-react. B)	H 241
Peroksid organik B (Org. Perox. B)	

HP 2 "Oksiduese"

"Oksidues": mbetje të cilat, në përgjithësi, duke siguruar oksigjen, mund të shkaktojnë ose të kontribuojnë në djegien e materialeve të tjera.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara sipas një prej kodeve të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodeve të deklaratës së rrezikut të paraqitur në tabelën 2, mbetjet vlerësohen për HP 2, aty ku është e përshtatshme dhe proporcionale, sipas metodave të provës. Nëse prania e një substance tregon se mbetjet janë oksiduese, ato do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 2.

Tabela 2: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi/et e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 2*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	Kodet e deklaratës së rrezikut
Të gazta oksiduese 1 (Ox. Gas 1)	H 270
Të lëngëta oksiduese 1 (Ox. Liq 1)	H 271
E ngurtë oksiduese 1 (Ox. Sol 1)	
Të lëngëta oksiduese 2 (Ox. Liq 2) Të lëngëta oksiduese 3 (Ox. Liq 3)	H 272
E ngurtë oksiduese 2 (Ox. Sol 2), e ngurtë oksiduese 3 (Ox. Sol 3)	

HP 3 "I djegshëm":

- Mbetje të lëngshme të ndezshme: mbetje të lëngshme që kanë një pikë ndezjeje nën 60 °C ose mbeturina vaj gazi, naftë dhe vajra të lehta për ngrohje që kanë një pikë ndezjeje > 55 °C dhe ≤ 75 °C;
- Mbetje të ngurta dhe të lëngshme piroforike të ndezshme: mbetje të ngurta ose të lëngshme, të cilat, edhe në sasi të vogla, mund të ndizen brenda pesë minutave pasi vijnë në kontakt me ajrin;
- Mbetje të ngurta të ndezshme: mbetje të ngurta që janë lehtësisht të djegshme ose mund të shkaktojnë ose të kontribuojnë në zjarr nëpërmjet fërkimit;
- Mbetjet e gazta të ndezshme: mbetje të gazta që janë të ndezshme në ajër në 20 °C dhe një presion standard prej 101.3 kPa;
- Mbetje reaktive ndaj ujit: mbetje të cilat, në kontakt me ujin, lëshojnë gazra të ndezshëm në sasi të rrezikshme;
- Mbetje të tjera të ndezshme: aerosole të ndezshme, mbetje të ndezshme vetënxehëse, perokside organike të ndezshme dhe mbetje të ndezshme vetëreaktive.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara nga një nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratave të rrezikut të paraqitura në tabelën 3, mbetjet do të vlerësohen, aty ku është e përshtatshme dhe proporcionale, sipas metodave të testimit. Nëse prania e një substance tregon se mbetjet janë të ndezshme, ato të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 3.

Tabela 3: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi (et) e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 3*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	Kodet e deklaratës së rrezikut
Të gazta të ndezshme 1 (Flam. Gas 1)	H220
Të gazta të ndezshme 2 (Flam. Gas 2)	H221
Aerosol 1	H222
Aerosol 2	H223
Të lëngëta të ndezshme 1 (Flam. Liq 1)	H224
Të lëngëta të ndezshme 2 (Flam. Liq 2)	H225
Të lëngëta të ndezshme 3 (Flam. Liq 3)	H226
Të ngurta të ndezshme 1 (Flam. Sol 1)	H228
Të ngurta të ndezshme 2 (Flam. Sol 2)	
Vetëreaktiv CD (Self-react. CD)	H242
Vetëreaktiv EF (Self-react. EF)	
Peroksid organik CD (Org. Perox. CD)	
Peroksid Organik EF (Org. Perox. EF)	
Të lëngëta piroforike 1 (Pyr. Liq. 1)	H250
Të ngurta piroforike 1 (Pyr. Sol. 2)	
Vetënxehëse 1 (Self-heat. 1)	H251

Vetënxehëse 2 (Self-heat. 2)	H252
Reaktive me ujin 1	H260
Reaktive me ujin 2 Reaktive me ujin 3	H261

HP 4 "Irritues – acarim i lëkurës dhe dëmtim i syve": mbetje të cilat me aplikim mund të shkaktojnë irritim të lëkurës ose dëmtim të syrit.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca në përqendrime mbi vlerën e ndërprerjes, të cilat klasifikohen nga një nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratave të rrezikut dhe një ose më shumë nga kufijtë e mëposhtëm të përqendrimit tejkalohen ose barazohen, mbetjet do të klasifikohet si i rrezikshëm nga HP 4.

Vlera e prerjes për shqyrtim në një vlerësim për Skin corr. 1A (H314), Acarim i lëkurës. 2 (H315), Eye dam. 1 (H318) dhe irritim i syve. 2 (H319) është 1%.

Nëse shuma e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara si Skin corr. 1A (H314) tejkalon ose është e barabartë me 1%, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 4.

Nëse shuma e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara si H318 tejkalon ose është e barabartë me 10%, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 4.

Nëse shuma e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara H315 dhe H319 tejkalon ose është e barabartë me 20%, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 4.

Vini re se mbetjet që përmbajnë substanca të klasifikuara si H314 (Skin corr.1A, 1B ose 1C) në sasi më të mëdha se ose të barabartë me 5% do të klasifikohen si të rrezikshme nga HP 8. HP 4 nuk do të zbatohet nëse mbetjet klasifikohen si HP 8.

HP 5 "Toksiciteti specifik i organit të synuar (STOT)/Toksiciteti i aspirimit": Mbetje që mund të shkaktojnë toksicitet specifik të organit të synuar qoftë nga një ekspozim i vetëm ose i përsëritur, ose që shkaktojnë efekte toksike akute pas aspirimit.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara nga një ose më shumë nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratave të rrezikut të paraqitura në tabelën 4, dhe një ose më shumë nga kufijtë e përqendrimit në tabelën 4 është tejkaluar ose barazuar, mbetjet të jenë klasifikuar si të rrezikshme sipas HP 5. Kur substancat e klasifikuara si STOT janë të pranishme në një mbetje, një substancë individuale të jetë e pranishme në ose mbi kufirin e përqendrimit që mbetjet të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 5.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara si Asp. Toks. 1 dhe shuma e këtyre substancave tejkalon ose barazohet kufiri i përqendrimit, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme nga HP 5 vetëm kur viskoziteti i përgjithshëm kinematik (në 40 °C) nuk i kalon 20,5 mm 2/s. (1)

Tabela 4: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi/et e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve dhe kufijtë përkatës të përqendrimit për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 5*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	**Kodet e deklaratës së rrezikut**	**Kufijtë e përqendrimit**
STOT SE 1	H 370	1%
STOS SE 2	H 371	10%
STOT SE 3	H 335	20%
STOT RE 1	H 372	1%
STOT RE 2	H 373	10%
Rrezik aspirimi 1 (Asp. Tox. 1)	H 304	10%

HP 6 "Toksiciteti akut": Mbetje të cilat mund të shkaktojnë efekte toksike akute pas administrimit oral ose dermal ose ekspozimit me frymëmarrje.

Nëse shuma e përqendrimeve të të gjitha substancave të përfshira në një mbetje, të klasifikuar me një klasë dhe kod kategorie rreziku akut toksik dhe kodin e deklaratës së rrezikut të dhënë në tabelën 5,

tejkalon ose barazohet pragu i dhënë në atë tabelë, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme nga HP 6. Kur më shumë se një substancë e klasifikuar si toksike akute është e pranishme në një mbetje, shuma e përqendrimeve kërkohet vetëm për substancat brenda së njëjtës kategori rreziku.

Vlerat e mëposhtme të prerjes do të zbatohen për t'u konsideruar në një vlerësim:

- Për toksin akut. 1, 2 ose 3 (H300, H310, H330, H301, H311, H331): 0,1%;
- Për toksin akut. 4 (H302, H312, H332): 1%.

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	Kodet e deklaratës së rrezikut	Kufijtë e përqendrimit
Toksicitet Akut 1 (Oral)	H300	0,1%
Toksicitet Akut 2 (Oral)	H300	0,25%
Toksicitet Akut 3 (Oral)	H301	5%
Toksicitet Akut 4 (Oral)	H302	25%
Toksicitet Akut 1 (Dermal)	H310	0,25%
Toksicitet Akut 2 (Dermal)	H310	2,5%
Toksicitet Akut 3 (Dermal)	H311	15%
Toksicitet Akut 4 (Dermal)	H312	55%
Toksicitet Akut 1 (Thithje)	H330	0,1%
Toksicitet Akut 2 (Thithje)	H330	0,5%
Toksicitet Akut 3 (Thithje)	H331	3,5%
Toksicitet Akut 4 (Thithje)	H332	22,5%

HP 7 "Kancerogjene": Mbetje që shkaktojnë kancer ose rrit incidencën e tij.

Kur një mbetje përmban një substancë të klasifikuar nga një nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratës së rrezikut dhe tejkalon ose barazohet me një nga kufijtë e mëposhtëm të përqendrimit të treguar në tabelën 6, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme nga HP 7. Kur më shumë se një substancë e klasifikuar si kancerogjene është e pranishme në një mbetje, një substancë individuale të jetë e pranishme në ose mbi kufirin e përqendrimit që mbetjet të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 7.

Tabela 6: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi (et) e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve dhe kufijtë përkatës të përqendrimit për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 7.*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	Kodet e deklaratës së rrezikut	Kufijtë e përqendrimit
Carc. 1A	H350	0,1%
Carc. 1B		
Carc. 2	H351	1,0%

HP 8 "Korozive/gërryes": Mbetje të cilat me aplikim mund të shkaktojnë korrozion të lëkurës.

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të klasifikuara si Skin corr.1A, 1B ose 1C (H314) dhe shuma e përqendrimeve të tyre tejkalon ose barazohet me 5%, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 8.

Vlera e prerjes për shqyrtim në një vlerësim për Skin corr. 1A, 1B, 1C (H314) është 1.0%.

HP 9 "Infektive": Mbetje që përmbajnë mikroorganizma të qëndrueshëm ose toksinat e tyre, të cilat dihet ose besohet se shkaktojnë sëmundje te njeriu ose organizma të tjerë të gjallë.

Atribuimi i HP 9 do të vlerësohet nga rregullat e përcaktuara në dokumentet e referencës ose legjislacionin në fuqi.

HP 10 "Toksike për riprodhim": Mbetje të cilat kanë efekte negative në funksionin seksual dhe fertilitetin te meshkujt dhe femrat e rritura, si dhe toksiciteti zhvillimor te pasardhësit.

Kur një mbetje përmban një substancë të klasifikuar nga një nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratës së rrezikut dhe tejkalon ose barazohet me një nga kufijtë e mëposhtëm të përqendrimit të paraqitur në tabelën 7, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 10. Kur më shumë se një substancë e klasifikuar si toksike për riprodhim është e pranishme në një

mbetje, një substancë individuale të jetë e pranishme në ose mbi kufirin e përqendrimit që mbetjet të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 10.

Tabela 7: *Kodi (et) e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi/et e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve dhe kufijtë përkatës të përqendrimit për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 10*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	**Kodet e deklaratës së rrezikut**	**Kufijtë e përqendrimit**
Toksicitet reproduktiv (Repr. 1A)	H360	0,3%
Toksicitet reproduktiv (Repr. 1B)		
Toksicitet reproduktiv (Repr. 2)	H361	3,0%

HP 11 "Mutagjene": Mbetje që mund të shkaktojnë një mutacion, që është një ndryshim i përhershëm në sasinë ose strukturën e materialit gjenetik në një qelizë.

Kur një mbetje përmban një substancë të klasifikuar nga një nga kodet e mëposhtme të klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodet e deklaratës së rrezikut dhe tejkalon ose barazohet me një nga kufijtë e mëposhtëm të përqendrimit të paraqitur në tabelën 8, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 11. Kur më shumë se sa një substancë e klasifikuar si mutagjene është e pranishme në një mbetje, një substancë individuale të jetë e pranishme në ose mbi kufirin e përqendrimit që mbetjet të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 11.

Tabela 8: *Kodi/et e klasës dhe kategorisë së rrezikut dhe kodi (et) e deklaratës së rrezikut për përbërësit e mbetjeve dhe kufijtë përkatës të përqendrimit për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 11*

Kodet e klasës dhe kategorisë së rrezikut	**Kodet e deklaratës së rrezikut**	**Kufijtë e përqendrimit**
Mutagjenicitet (Muta. 1A)	H340	0,1%
Mutagjenicitet (Muta 1B)		
Mutagjenicitet (Muta. 2)	H341	1,0%

HP 12 "Çlirimi i një gazi toksik akut": Mbetje që lëshojnë gazra toksikë akute (Acute Tox. 1, 2 ose 3) në kontakt me ujin ose një acid.

Kur një mbetje përmban një substancë të caktuar për një nga rreziqet shtesë të mëposhtme EUH029, EUH031 dhe EUH032, ajo do të klasifikohet si e rrezikshme nga HP 12 sipas metodave ose udhëzimeve të provës.

HP 13 "Sensitizues": Mbetje që përmbajnë një ose më shumë substanca të njohura se shkaktojnë efekte sensibilizuese në lëkurë ose në organet e frymëmarrjes.

Kur një mbetje përmban një substancë të klasifikuar si sensibilizuese dhe i është caktuar njërit prej kodeve të deklaratës së rrezikut H317 ose H334 dhe një substancë individuale është e barabartë ose tejkalon kufirin e përqendrimit prej 10%, mbetjet klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 13.

HP 14 "Ekotoksike": Mbetje që paraqesin ose mund të paraqesin rreziqe të menjëhershme ose të vonuara për një ose më shumë sektorë të mjedisit.

Mbetjet që plotësojnë ndonjë nga kushtet e mëposhtme do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 14:

- Mbetjeve që përmbajnë një substancë të klasifikuar si ozonholluese i është caktuar kodi i deklaratës së rrezikut H420 në përputhje me rregulloren (EC) nr.1272/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (1) dhe përqendrimi i një substance të tillë është i barabartë ose e kalon përqendrimin kufiri prej 0,1%.

[c(H420) ≥ 0,1%]

- Mbetjeve që përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara si akute ujore të cilës i është caktuar kodi i deklaratës së rrezikut H400 në përputhje me rregulloren (EC) nr. 1272/2008. Për këto substanca do të zbatohet një vlerë kufitare prej 0,1%.

[Σ c (H400) ≥ 25%]

- Mbetjet që përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara si kronike ujore 1, 2 ose 3 të caktuara në kodin (et) e deklaratës së rrezikut H410, H411 ose H412 në përputhje me rregulloren (EC) nr.1272/2008

dhe shumën e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara si kronike ujore 1 (H410) shumëzuar me 100 shtuar në shumën e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara si kronike ujore 2 (H411) shumëzuar me 10 shtuar në shumën e përqendrimeve të të gjitha substancave të klasifikuara si kronike ujore 3 (H412) barazohet ose tejkalon kufirin e përqendrimit prej 25%. Një vlerë kufitare prej 0,1% zbatohet për substancat e klasifikuara si H410 dhe një vlerë kufitare prej 1% zbatohet për substancat e klasifikuara si H411 ose H412.

[100 × Σc (H410) + 10 × Σc (H411) + Σc (H412) ≥ 25%]

- Mbetjeve që përmbajnë një ose më shumë substanca të klasifikuara si kronike ujore 1, 2, 3 ose 4, të cilave u është caktuar kodi/et e deklaratës së rrezikut H410, H411, H412 ose H413 në përputhje me rregulloren (EC) nr.1272/2008, dhe shumën e përqendrimet e të gjitha substancave të klasifikuara si kronike ujore janë të barabarta ose tejkalojnë kufirin e përqendrimit prej 25%. Një vlerë kufitare prej 0,1% zbatohet për substancat e klasifikuara si H410 dhe një vlerë kufitare prej 1% zbatohet për substancat e klasifikuara si H411, H412 ose H413.

[Σ c H410 + Σ c H411 + Σ c H412 + Σ c H413 ≥ 25%]

Ku: Σ = shuma dhe c = përqendrimet e substancave.

HP 15 "Mbetje të afta për të shfaqur një veti të rrezikshme të listuar më sipër që nuk shfaqet drejtpërdrejt nga mbetjet origjinale".

Kur një mbetje përmban një ose më shumë substanca të caktuara për një nga deklaratat e rrezikut ose rreziqet shtesë të paraqitura në tabelën 9, mbetjet do të klasifikohen si të rrezikshme sipas HP 15, përveç rasteve kur mbetjet janë në një formë të tillë që në asnjë rrethanë nuk do të shfaqen vetitë shpërthyese ose potencialisht shpërthyese.

Tabela 9: *Deklaratat e rrezikut dhe rreziqet shtesë për përbërësit e mbetjeve për klasifikimin e mbetjeve si të rrezikshme sipas HP 15*

Deklaratat e rrezikut dhe rreziqet shtesë	
Mund të shpërthejë masivisht në zjarr	H205
Shpërthyes kur është i thatë	EUH001
Mund të formojë peroksidë shpërthyes	EUH019
Rrezik shpërthimi nëse nxehet kur është i izoluar	EUH044

SHTOJCA 4
STRATEGJIA KOMBËTARE DHE PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE

1. Në përputhje me nenin 62 të këtij ligji, Strategjia Kombëtare përmban një sërë elementesh detyruese dhe jodetyruese.

2. Elementet detyruese janë të përcaktuara në pjesën A të kësaj shtojce.

3. Elementet jodetyruese që mund të përmbajë Strategjia Kombëtare, por përfshirja e të cilave nuk është detyruese, janë të përcaktuara në pjesën B të kësaj shtojce.

Pjesa A

1. Strategjia Kombëtare përmban elementet e mëposhtme:

a) Llojin, sasinë dhe burimin e mbetjeve të krijuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve dhe një vlerësim për zhvillimin e rrymave të mbetjeve në të ardhmen.

b) Impiantet e mëdha ekzistuese të rikuperimit dhe asgjësimit dhe të gjitha sistemet e posaçme për vajrat e përdorura, mbetjet e rrezikshme, mbetjet që përmbajnë sasi të konsiderueshme të materialeve të rralla ose rrymat e tjera të mbetjeve që rregullohen nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.

c) Vlerësimin e nevojës për mbylljen e impianteve ekzistuese të trajtimit të mbetjeve dhe për ngritjen e infrastrukturës së re të impianteve për trajtimin e mbetjeve, në përputhje me parimet e vetëqëndrueshmërisë dhe afërsisë. Në këtë kontekst kryhet edhe vlerësimi i investimeve dhe mjeteve të tjera financiare që janë të nevojshme për realizimin e mbylljes apo ndërtimit të impianteve të trajtimit të mbetjeve, përfshirë investimet që janë të nevojshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

ç) Objektivat e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve si dhe objektivat për reduktimin e operacioneve të asgjësimit të mbetjeve.

d) Vlerësimin e skemave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, përfshirë shtrirjen territoriale të grumbullimit të diferencuar dhe rrymat e mbetjeve për të cilat zbatohet, si dhe masat për përmirësimin e këtyre operacioneve, të gjitha përjashtimet e zbatuara sipas pikës 3 të nenit 11 të këtij ligji, si dhe vlerësimin e nevojës për ngritjen e skemave të reja të grumbullimit.

dh) Informacion të mjaftueshëm mbi kriteret e përdorura për identifikimin e vendndodhjes së territorit/sheshit të impianteve dhe kur është e nevojshme informacion mbi kapacitetin e impianteve të asgjësimit ose impianteve të mëdha të rikuperimit që planifikohen të ngrihen në të ardhmen.

e) Politikat e përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve, përfshirë metodat dhe teknologjinë e planifikuar për t'u përdorur për menaxhimin e integruar të mbetjeve ose politikat e menaxhimit të integruar të mbetjeve që paraqesin probleme specifike menaxhimi.

ë) Masat për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e hedhjes së paligjshme të mbetjeve në mjedis dhe për të pastruar të gjitha llojet e mbetjeve të hedhura në mjedis.

f) Indikatorë dhe objektiva të përshtatshëm sasiorë ose cilësorë duke përfshirë indikatorë dhe objektiva mbi sasinë e mbetjeve dhe trajtimin e tyre si dhe mbi sasinë e mbetjeve bashkiake që asgjësohen ose që janë subjekt i rikuperimit të energjisë.

d) Të gjitha masat dhe objektivat e tjerë që sipas dispozitave të këtij ligji rregullohen nga Strategjia Kombëtare.

2. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm për menaxhimin e ambalazheve dhe mbetjeve të ambalazheve ku përcaktohen:

a) masat specifike për parandalimin e krijimit të mbetjeve nga ambalazhe dhe për zvogëlimin e ndikimit në mjedis të paketimeve, përfshirë përdorimin e instrumenteve ekonomike dhe masave të tjera të parashikuara në nenin 28, të këtij ligji, për zbatimin e hierarkisë së mbetjeve;

b) masa për pakësimin e konsumit të qeseve mbajtëse me peshë të lehtë, të tilla si përcaktimi i objektivave kombëtarë të pakësimit të tyre, instrumente ekonomike si dhe kufizime për tregtimin e tyre, me kusht që këto kufizime të jenë proporcionale dhe jodiskriminuese;

c) masa për të nxitur hedhjen në treg të sasive më të mëdha të paketimeve që mund të ripërdoren dhe sisteme për ripërdorimin e paketimeve, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve, duke u kujdesur për impaktin në mjedis dhe pa cenuar sigurinë ushqimore ose sigurinë e konsumatorëve. Këto masa mund të përfshijnë, ndër të tjera, skema për depozitimin-kthimin e ambalazheve, vendosjen e objektivave cilësorë ose sasiorë, lehtësira ekonomike, përcaktimin e detyrimit vjetor për hedhjen në treg të një përqindjeje minimale të paketimeve që mund të ripërdoren, për secilën rrymë paketimesh;

ç) objektiva kombëtarë për rikuperimin dhe riciklimin e rrymave të ndryshme të paketimeve;

4. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm ku përcaktohen objektivat kombëtarë për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimi.

5. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të posaçëm, që përcakton strategjinë kombëtare për reduktimin e depozitimit në *landfill* të mbetjeve bashkiake të biodegradueshme dhe mbetjeve, veçanërisht mbetjeve bashkiake, të përshtatshme për riciklim apo për ndonjë lloj tjetër rikuperimi. Këtu përfshihen, objektivat kombëtarë për reduktimin e depozitimit në *landfill* të mbetjeve të sipërpërmendura dhe masat për përmbushjen e këtyre objektivave të tilla si riciklimi, kompostimi, prodhimi i biogazit apo rikuperimi i materialeve/ energjisë.

6. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të veçantë për menaxhimin e PCB-ve/PCT-ve, planet për grumbullimin dhe/ose çndotjen dhe/apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT, si dhe të vetë PCB-ve/PCT-ve.

7. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të veçantë për menaxhimin e integruar të mbetjeve të baterive.

8. Strategjia Kombëtare përmban një kapitull të veçantë për komunikimin dhe njohjen mjedisore, i cili bazohet në praktikat më të mira për rritjen e ndërgjegjësimit, të cilat efektivisht inkurajojnë qasjen drejt parandalimit të mbetjeve, ndarjes në burim, ripërdorimit dhe riciklimit me qëllim ndryshimin e sjelljes dhe qasjes së popullsisë dhe përmirësimin e eficiencës së menaxhimit të mbetjeve. Ky kapitull

përmban masat që merren për të realizuar fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar si dhe masa për të adresuar problematikat lidhur me menaxhimin e mbetjeve, si p.sh. por pa u kufizuar në mungesën e njohurive apo perceptimet dhe qëndrimet mbi menaxhimin e mbetjeve.

Pjesa B

Strategjia Kombëtare mund të përmbajë:

a) aspektet organizative të lidhura me menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë përshkrimin e ndarjes së përgjegjësive midis aktorëve të sektorit publik dhe atij privat që angazhohen me menaxhimin e integruar të mbetjeve;

b) vlerësimin e dobishmërisë dhe përshtatshmërisë së përdorimit të instrumenteve ekonomike dhe instrumenteve të tjera për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e mbetjeve, duke marrë në konsideratë nevojën për funksionimin normal të tregut në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) përdorimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe ofrimin e informacionit për publikun e gjerë ose për kategori specifike konsumatorësh;

ç) sheshet/territoret e asgjësimit të mbetjeve, që janë historikisht të ndotura dhe masat për rehabilitimin e tyre.

SHTOJCA 5
SHEMBUJ TË MASAVE TË PARANDALIMIT TË KRIJIMIT TË MBETJEVE

Masa që mund të ndikojnë te kushtet e përgjithshme që lidhen me krijimin e mbetjeve

1. Përdorimi i masave të planifikimit ose instrumenteve të tjera ekonomike që nxisin përdorimin e burimeve në mënyrë eficiente.

2. Nxitja e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit me qëllim realizimin e produkteve dhe teknologjive më të pastra dhe që krijojnë më pak mbetje dhe shpërndarjen dhe përdorimin e rezultateve të veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit.

3. Zhvillimi i indikatorëve kuptimplotë dhe efektivë të trysnive që ushtron krijimi i mbetjeve mbi mjedisin me qëllim dhënien e kontributit në parandalimin e krijimit të mbetjeve në të gjitha nivelet, duke filluar nga krahasimi i produkteve në nivel kombëtar te veprimet e ndërmarra nga autoritetet e pushtetit vendor e deri te masat në nivel kombëtar.

Masa që mund të ndikojnë te fazat e projektimit, prodhimit dhe shpërndarjes

4. Nxitja e ekoprojektimit (integrimi sistematik i aspekteve mjedisore në projektimin e produktit, me qëllim që të përmirësojë performancën e produktit në mjedis gjatë gjithë ciklit të jetës së tij).

5. Ofrimi i informacionit mbi teknikat për parandalimin e mbetjeve, që synon lehtësimin e zbatimit të teknikave më të mira të disponueshme për çdo industri.

6. Organizimi, për autoritetet përkatëse, i trajnimeve që instruktojnë se si të përfshihen kërkesat për parandalimin e mbetjeve në lejet e mjedisit të tipit A në bazë të ligjit për lejet e mjedisit.

7. Përfshirja e masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve në impiantet që kërkojnë leje mjedisi të tipit A ose B në bazë të ligjit për lejet e mjedisit. Aty ku është e përshtatshme, masa të tilla mund të përfshijnë plane ose vlerësime për parandalimin e mbetjeve.

8. Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuese apo dhënia e mbështetjes financiare, në vendimmarrje apo mbështetje të tjera për bizneset. Këto masa mund të jenë veçanërisht efektive kur ato kanë në fokus dhe përshtaten për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe funksionojnë përmes rrjeteve të ngritura/ekzistuese të biznesit.

9. Përdorimi i marrëveshjeve vullnetare, grupimeve/komiteteve të konsumatorëve dhe prodhuesve ose negociatave sektoriale me qëllim që bizneset apo sektorët industrialë përkatës të hartojnë planet ose objektivat e vet të parandalimit të mbetjeve ose të korrigjojnë produktet apo ambalazhet që krijojnë shumë mbetje.

10. Nxitja e sistemeve të besueshme të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë EMAS dhe ISO 14001.

Masa që mund të prekin fazën e konsumit dhe të përdorimit

11. Instrumentet ekonomike, si, për shembull, masa nxitëse për blerje të produkteve të pastra ose vendosja e një pagese të detyrueshme për t'u paguar nga konsumatorët për një produkt apo element të caktuar të ambalazhit, që në rast të kundërt do të jepej falas.

12. Përdorimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe shpërndarja e informacionit për publikun ose për një kategori të veçantë konsumatorësh.

13. Promovimi i ekoetiketave të besueshme.

14. Marrëveshjet me industrinë, si përdorimi i grupimeve/komiteteve për produktet siç janë ato që mund të jenë ngritur në kuadër të politikave të integruara për produktet ose me shitësit me pakicë mbi disponueshmërinë e informacionit për parandalimin e mbetjeve dhe produkteve me ndikim më të ulët në mjedis.

15. Në kontekstin e prokurimeve publike apo të lidhjes së kontratave të shoqërive tregtare, përfshirjen e kritereve mjedisore dhe atyre të parandalimit të mbetjeve si kritere të tenderit /prokurimit publik dhe të kushteve të lidhjes së kontratave.

16. Nxitja e ripërdorimit dhe/ose e riparimit të produkteve që janë hedhur apo pjesëve të tyre përbërëse, që janë të përshtatshme për ripërdorim dhe/ose riparim, veçanërisht përmes përdorimit të masave edukative, ekonomike, logjistike apo masave të tjera, si mbështetja apo ngritja e rrjeteve dhe qendrave të akredituara për riparimin dhe ripërdorimin, sidomos në zonat me densitet të lartë të popullsisë.

SHTOJCA 6
INSTRUMENTE EKONOMIKE DHE MASA NXITËSE PËR ZBATIMIN E HIERARKISË SË MBETJEVE

Politikat dhe kuadri ligjor që nxisin zbatimin e hierarkisë së mbetjeve në nivel qendror dhe vendor, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji, mund të përfshijnë instrumentet ekonomike dhe masat nxitëse të mëposhtme:

a) Planifikimi investimeve të nivelit qendror dhe vendor në përputhje me nevojat e ngritjes së infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;

b) Prokurimi publik i qëndrueshëm për të inkurajuar menaxhimin më të mirë të mbetjeve dhe përdorimin e produkteve dhe materialeve të ricikluara;

c) Mbështetje për kërkimin dhe inovacionin në teknologjitë e avancuara të riciklimit dhe riprodhimit me një miks materialesh të rikuperuara dhe të reja;

d) Përdorimi i teknikave më të mira të disponueshme për trajtimin e mbetjeve;

e) Incentiva ekonomikë për autoritetet qendrore dhe vendore, veçanërisht për promovimin e parandalimit të mbetjeve dhe përforcimin e skemave të grumbullimit të diferencuar;

f) Fushata ndërgjegjësimi publik;

g) Sisteme koordinuese, edhe përmes mjeteve digjitale, ndërmjet të gjitha autoriteteve publike të përfshira në menaxhimin e mbetjeve.

SHTOJCA 7
PLANI ZONAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE

Plani zonal i menaxhimit të integruar të mbetjeve përmban të paktën elementet e mëposhtme:

1. Objektivat dhe shtrirja

- Objektivat për reduktimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve.
- Zona e mbuluar dhe llojet e mbetjeve të menaxhuara (si p.sh., por pa u kufizuar në, mbetje ndërtimi, mbetje të rrezikshme, organike etj.).
- Përputhshmëria me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret vendore për menaxhimin e mbetjeve.

2. Organizimi institucional i zonës së menaxhimit të mbetjeve

- Funksionet e strukturës administruese të ZMM-së.
- Alternativat institucionale dhe organizative për ZMM-në.
- Pjesëmarrja e sektorit privat në menaxhimin zonal të mbetjeve.
- Alternativa e parapëlqyer për administrimin e ZMM-së.
- Procedurat për themelimin e një autoriteti të kompetencave të përbashkëta.

3. Vlerësimi i mbetjeve dhe mbledhja e të dhënave

- Sasia dhe përbërja aktuale e mbetjeve të krijuara.
- Burimet e mbetjeve (sektori familjar, sektori tregtar, industrial, ndërtimor etj.).
- Kapaciteti dhe infrastruktura ekzistuese për menaxhimin e mbetjeve.

4. Vlerësimi i nevojave për investime në infrastrukturën e nevojshme të menaxhimit të mbetjeve dhe teknologjitë e përdorura

- Lloji i infrastrukturës së nevojshme.
- Analizë e teknikave më të mira të disponueshme.
- Burimet e financimit për mbulimin e investimeve në infrastrukturë.

5. Strategjitë për Reduktimin dhe Riciklimin e Mbetjeve

- Iniciativa për reduktimin e mbetjeve (si p.sh. por pa u kufizuar në promovimin e ripërdorimit, reduktimin e përdorimit dhe prodhimit të materialeve të panevojshme etj.).
- Objektivat për riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve.
- Menaxhimi i mbetjeve organike dhe kompostimi.
- Incentiva për bizneset dhe qytetarët për të marrë pjesë në programet e riciklimit.

6. Grumbullimi, transporti dhe asgjësimi i mbetjeve

- Rrugët dhe oraret e grumbullimit të mbetjeve.
- Sistemet e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve (kosha të veçantë për mbetjet e riciklueshme, organike etj.).
- Vendndodhjet e miratuara për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve *(landfill*-e, incineratorë, qendra riciklimi).
- Përdorimi i transportuesve të licencuar të mbetjeve dhe rregulloret e transportit.

7. Menaxhimi i mbetjeve të ndërtimit

- Procedurat për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ndërtimit.
- Kërkesat për ndarjen në burim dhe riciklimin e mbetjeve në vendin e krijimit (si p.sh., druri, betoni, metalet).
- Lejet dhe detyrimet për raportim për subjektet përkatëse.

8. Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme dhe rrymat specifike të mbetjeve

- Procedurat për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme (p.sh., asbesti, kimikatet, mbetjet mjekësore).
- Politikat për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë dhe kategori të tjera të veçanta.

9. Ndërgjegjësimi publik dhe përfshirja e palëve të interesuara

- Programet edukative mbi reduktimin e mbetjeve dhe asgjësimin e duhur.
- Pjesëmarrja e komunitetit në iniciativat e riciklimit.
- Bashkëpunimi me bizneset, industritë dhe organizatat lokale.

10. Buxheti dhe burimet e financimit

- Kostot e parashikuara për grumbullimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve.
- Të ardhurat e mundshme nga mbetjet e ricikluara ose tarifat e menaxhimit të mbetjeve.
- Grante, fonde qeveritare ose partneritete për mbështetje financiare.

11. Monitorimi, raportimi dhe përputhshmëria

- Treguesit e performancës (p.sh., normat e devijimit të mbetjeve, reduktimi i asgjësimeve në *landfill*).
- Auditimet e rregullta dhe përditësimi i planit zonal të menaxhimit të mbetjeve.
- Mekanizmat e zbatimit të rregullave për shkeljet e menaxhimit të mbetjeve (gjoba, penalitete).

DEKRET
Nr. 388, datë 7.11.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 77/2025

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË ZYRTARËVE SHQIPTARË NË RAPORT ME ISH-AGJENTIN SPECIAL TË FBI-së *CHARLES MCGONIGAL*"

Në mbështetje të neneve 77, pika 2, dhe 78 të Kushtetutës dhe neneve 25 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të 1/4 së deputetëve të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së, *Charles Mcgonigal*".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 78/2025

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTVENDIMIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË PUSHTETIT QENDROR DHE PUSHTETIT VENDOR, SI DHE PËR TË VERIFIKUAR PËRDORIMIN E BURIMEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PËR QËLLIME ELEKTORALE NË ZGJEDHJET E 11 MAJIT 2025"

Në mbështetje të neneve 77, pika 2, dhe 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 25 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të 1/4 së deputetëve të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektvendimit "Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 79/2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 64/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 64/2025, bëhen shtesat e mëposhtme:

Deputeti Besnik Brahimi caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes.

Deputeti Shkurt Lasku caktohet anëtar në Komisionin për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 80/2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 65/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 21 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikat IV, VI, VII dhe IX, të vendimit nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" bëhen këto shtesa:

Deputeti Besart Xhaferi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.

Deputeti Bledion Nallbati caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Deputeti Agron Gjekmarkaj caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

Deputeti Bujar Rexha caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 81/2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 74/2025, TË KUVENDIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE"

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78 të Kushtetutës, neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, si dhe përcaktimeve në pikën III, të vendimit nr. 74/2025, të Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste:

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit nr. 74/2025, shtohen emrat e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore si më poshtë:

1. Damian Gjiknuri	bashkëkryetar
2. Arbjan Mazniku	anëtar
3. Bledar Çuçi	anëtar
4. Ulsi Manja	anëtar
5. Olsi Komici	anëtar
6. Aurora Mara	anëtare
7. Ogerta Manasterliu	anëtare

Anëtarët zëvendësues:
1. Aulona Bylykbashi
2. Ermal Pacaj
3. Ermal Elezi
4. Erion Malaj
5. Erjona Ismaili

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 82/2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 75/2025,"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78 të Kushtetutës, neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, si dhe përcaktimeve në pikën III, të vendimit nr. 75/2025, të Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit nr. 75/2025, shtohen emrat e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale, si më poshtë:

1. Arbjan Mazniku	bashkëkryetar;
2. Blendi Klosi	anëtar
3. Damian Gjiknuri	anëtar
4. Romina Kuko	anëtare
5. Ermal Pacaj	anëtar
6. Marjana Koçeku	anëtare
7. Ermal Elezi	anëtar
8. Klevis Jahaj	anëtar

Anëtarët zëvendësues:
1. Tërmet Peçi
2. Etleva Budini
3. Aulona Bylykbashi
4. Agron Malaj
5. Vasil Llajo

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

VENDIM
Nr. 86/2025

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zonjës Ilirjana Nano kryetare të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 87/2025

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zotit Arben Ristani anëtar të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 88/2025

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zotit Dritan Çaka anëtar të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 89/2025

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zotit Bledar Skënderi anëtar të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 90/2025

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zonjës Helga Vukaj anëtare të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 97/2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 74/2025, TË KUVENDIT, "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE"

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78 të Kushtetutës; të neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe përcaktimeve në pikën III, të vendimit nr. 74/2025, të Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve të pakicës parlamentare dhe deputetëve jashtë grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit nr. 74/2025, shtohen emrat e anëtarëve të tjerë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore, si më poshtë:

1. Oerd Bylykbashi	bashkëkryetar	(PD)
2. Ivi Kaso	anëtar	(PD)
3. Gent Strazimiri	anëtar	(PD)
4. Albana Vokshi	anëtare	(PD)
5. Gjin Gjoni	anëtar	(PD)
6. Tedi Blushi	anëtar	(PL)
7. Fatmir Mediu	anëtar	(AN)
8. Tedi Mula	anëtar	(i pavarur)

Anëtarë zëvendësues:

1. Arian Ndoja	(PD)
2. Klevis Balliu	(PD)
3. Elda Hoti	(PD)
4. Erisa Xhixho	(PL)
5. Artan Luku	(AN)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 98/2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 75/2025, "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78 të Kushtetutës, neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe përcaktimeve në pikën III, të vendimit nr. 75/2025, të Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve të pakicës parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit nr. 75/2025, shtohen emrat e anëtarëve të tjerë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale, si më poshtë:

1. Luçiano Boçi	bashkëkryetar	(PD)
2. Jorida Tabaku	anëtare	(PD)
3. Bledion Nallbati	anëtar	(PD)
4. Xhelal Mziu	anëtar	(PD)
5. Ramadan Likaj	anëtar	(PD)
6. Enno Bozdo	anëtar	(PD)
7. Edmond Haxhinasto	anëtar	(PL)
8. Vangjel Dule	anëtar	(AN)

Anëtarë zëvendësues:

1. Bardh Spahia	(PD)
2. Igli Cara	(PD)
3. Ina Zhupa	(PD)
4. Brunilda Haxhiu	(PL)
5. Artan Luku	(AN)

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke vlerësuar rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Duke vlerësuar angazhimin në zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF;

Në vlerësim të raportit të paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij konstaton:

Është rritur angazhimi institucional për ndjekjen penale të veprave që prekin interesin publik dhe sundimin e ligjit, përmes hetimeve të nisura kryesisht dhe rritjes së cilësisë në hetim.

Janë ndërmarrë hapa pozitivë për zbatimin e standardeve të mbrojtjes së të miturve dhe viktimave të dhunës në familje, përfshirë bashkëpunimin me institucionet mbrojtëse dhe përdorimin e masave alternative të sigurimit.

Është avancuar bashkëpunimi me autoritetet e huaja përmes strukturave ndërkombëtare si Eurojust dhe janë zhvilluar operacione të përbashkëta për goditjen e veprimtarisë kriminale transnacionale.

Është demonstruar përkushtim në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit në Bashkimin Evropian, veçanërisht në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Janë marrë masa për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, përfshirë zhvillimin e sistemit PRESTO dhe përgatitjen për implementimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve.

Janë ndërmarrë hapa konkretë për bashkëpunim të zgjeruar me autoritetet e huaja në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut ndërkombëtar, përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve dhe krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore në bashkëpunim me Eurojust dhe Europol.

Ka pasur angazhim në përgatitjen e raporteve dhe përgjigjeve institucionale për organizmat ndërkombëtarë, në kuadër të procesit të integrimit dhe monitorimit ndërkombëtar, duke treguar një qasje më të organizuar dhe të koordinuar në zbatimin e planit të veprimit të FATF/ICRG dhe rekomandimeve të GRECO-s.

Është konsoliduar funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm në orientimin e politikës penale, përmes nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme dhe rekomandimeve për uniformizimin e praktikës, duke synuar përmirësimin e cilësisë së ndjekjes penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2025 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të intensifikohen hetimet proaktive dhe hetimet që nisin kryesisht nga prokuroria, duke forcuar rolin aktiv të prokurorit dhe duke rritur përdorimin e teknikave të posaçme hetimore.

2. Të zgjerojë përdorimin e hetimeve financiare dhe analizës pasurore, duke garantuar trajnimin e strukturave përkatëse, përdorimin sistematik të instrumenteve të ndjekjes së pasurisë dhe bashkëpunimin me agjencitë e tjera ligjzbatuese përgjegjëse, gjithashtu, në këtë fushë.

3. Të zbatohen në mënyrë më të gjerë dhe të strukturuar masat alternative të sigurimit për raste me rrezikshmëri të ulët shoqërore, duke respektuar parimin e proporcionalitetit në masat kufizuese të lirisë.

4. Të përgatisë një analizë mbi masat e sigurisë të marra në këto 5 vjet (2021–2025), politikat e ndjekura, problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për reflektim në praktikat e vendeve evropiane në këtë fushë dhe standardet e rekomanduara nga KiE, BE, GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

5. Në bashkëpunim me SPAK-un dhe KQZ-në të zhvillojnë një analizë të përbashkët për zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025 dhe masat ligjore e institucionale që mund të ndërmerren për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të parandaluar e ndëshkuar çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

6. Të vijojë me tej zhvillimi dhe përfundimi i sistemit e-PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme.

7. Të vijojë puna për funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së

Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Të hartohet një strategji kombëtare për komunikim publik dhe transparencë, me fokus publikimin periodik të statistikave dhe treguesve kryesorë, edukimin përmes fushatave mediatike për të drejtat e viktimave dhe transparencën mbi trajtimin e çështjeve me interes të lartë publik.

9. Të publikohet strategjia afatmesme e institucionit dhe të raportohet periodikisht për nivelin e zbatueshmërisë së saj.

10. Të formalizohet një mekanizëm bashkëpunimi i vazhdueshëm me ILD-në dhe KLP-në për të adresuar problematikat e konstatuara, për të ndarë të dhëna dhe praktika të mira bashkëpunimi, për forcimin e integritetit dhe përgjegjshmërisë në detyrë të prokurorëve.

11. Të vijojë intensifikimi i masave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të miturve dhe grave, përmes koordinimit të veçantë ndërinstitucional, trajnimeve dhe zbatimit të masave mbrojtëse.

12. Të përmirësojë cilësinë e hetimeve për veprat penale që prekin grupet vulnerabël, me theks të veçantë te dhuna me bazë gjinore dhe dhuna digjitale, si dhe të bashkëpunojë për amendimet e nevojshme ligjore në këtë drejtim.

13. Të vlerësohet mundësia për ngritjen e një njësie të specializuar brenda prokurorisë për luftën kundër krimit kibernetik, duke pasur në fokus rritjen e kapaciteteve dhe përdorimin e teknologjive të avancuara.

14. Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin e vazhdueshëm me shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së (përfshirë Europolin, EMPACT dhe Eurojust).

15. Të vijojë zbatimi i rekomandimeve të BE-së duke intensifikuar bashkëpunimin me agjencitë e BE-së (Eurojust, Europol, OLAF) dhe vendet anëtare për ndjekjen e çështjeve transnacionale dhe duke përmbushur plotësisht rekomandimet e progresraportit të BE-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore për prokurorët e të gjitha niveleve;

Duke mbajtur parasysh rolin kyç të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës,

Në vlerësim të raportit të paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për veprimtarinë e tij për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij, konstaton:

Zhvillimin nga Këshilli të 38 seancave plenare dhe nxjerrjen e 300 vendimeve, përfshi edhe miratimin e ndryshimin e 5 akteve nënligjore, me qëllim mirëfunksionimin e sistemit të prokurorisë në tërësi, rritjes së performancës të trupës së prokurorëve dhe promovimit të tyre, bazuar në integritet, profesionalizëm dhe meritokraci.

Përditësimin dhe konsolidimin e databazës elektronike nga KLP-ja për gjendjen reale të burimeve njerëzore, në funksion të garantimit të funksionalitetit të zyrave të prokurorive përballë vakancave të shumta të krijuara nga procesi i vetingut dhe lëvizjet në sistem gjatë vitit 2024.

Realizimin e ndryshimeve në rregulloren "Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve", në funksion të përmirësimit të efikasitetit dhe thjeshtimit të procedurave të vlerësimit.

Fillimin e procesit të bllokuar të vlerësimit etik dhe profesional me miratimin e 9 raporteve të para, ku përfshihet 1 raport vlerësimi për drejtues, 1 raport vlerësimi të përshpejtuar dhe 7 raporte vlerësimi periodik.

Realizimin e procesit të verifikimit të kushteve ligjore për pranimin e kandidatëve në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024–2025 dhe përcaktimin e kuotës prej 25 kandidatësh për profilin prokuror.

Zhvillimin e procesit të verifikimit të pasurisë, figurës dhe kushteve të tjera ligjore për 23 kandidatë të diplomuar në profilin prokuror nga Shkolla e Magjistraturës përmes miratimit të vendimeve individuale dhe listës përfundimtare të kandidatëve për kandidim për emërim si prokurorë.

Miratimin e transferimeve me pëlqim me prioritet për të adresuar mangësitë në burimet njerëzore në disa prokurori.

Realizimin e procedurave për ngritje në detyrë për 3 prokurorë në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Realizimin në kohë të të gjitha procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Këshillit për plotësimin e 3 vakancave të fundit për pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme.

Trajtimin e çështjeve nga KLP-ja të paraqitura nga ILD-ja për procesin e llogaridhënies së prokurorëve. Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 3 procedura disiplinore të paraqitura nga ILD-ja duke përmbyllur një procedurë me vendim përfundimtar, dy procedura disiplinore pa një vendim përfundimtar për shkak të shkarkimit nga procesi i vetingut dhe humbjes së statusit të magjistratit dhe lënë 1 procedurë disiplinore në proces trajtimi për vitin në vazhdim.

Përmirësimin e komunikimit institucional përmes faqes *online* dhe rritjes së komunikimit me median.

Nisjen e procesit për hartimin e Strategjisë së Komunikimit me Median dhe caktimin e një anëtari të posaçëm përgjegjës për marrëdhëniet me median.

Zhvillimin e mbledhjes së përbashkët vjetore në kuadër të bashkëpunimit me KLGJ-në dhe miratimin e rregullores "Për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një prokuror dhe një gjyqtar janë të përfshirë në të njëjtën shkelje disiplinore".

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të zhvillojë brenda vitit 2025 një analizë mbi reflektimet ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportet e BE-së për sistemin e drejtësisë dhe posaçërisht për punën e KLP-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në angazhimet e marra nga shteti shqiptar në kuadrin e procesit të negociatave për anëtarësim në BE.

2. Të reflektojë mbi rekomandimet e BE-së për vlerësimin dhe miratimin e mekanizmave garantues për unifikimin e standardeve dhe kritereve të përzgjedhjes së anëtarëve jomagjistratë me ato të magjistratëve të Këshillit për të siguruar një nivel më të lartë transparence dhe konkurrencë të drejtpërdrejtë dhe përfundimet përkatëse t'ia bëj të njohura Kuvendit brenda muajit dhjetor 2025.

3. Të vijojë angazhimin aktiv për përmbushjen me efektivitet të angazhimeve institucionale, lidhur me detyrimet në kuadër të raportimeve gjatë procesit të negociatave për anëtarësimin në BE.

4. Të përmbyllë miratimin e të gjitha akteve nënligjore të mbetura në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi brenda vitit 2025.

5. Të konsiderojë prioritet të punës së tij rritjen e përgjegjshmërisë, angazhimit dhe eficiencës së punës të anëtarëve dhe stafit të Këshillit për të ndryshuar situatën lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, duke rritur ndjeshëm numrin e raporteve analitike të vlerësimit për vitin në vazhdim. Lidhur me përmbushjen e kësaj përgjegjësie ligjore, të informojë Kuvendin me një raport të veçantë për këtë gjë në muajin dhjetor 2025.

6. Të zhvillojë një analizë të dedikuar të Këshillit për situatën aktuale dhe përcaktimin e masave të mundshme për plotësimin e vakancave të përkohshme dhe të përhershme të prokurorëve në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm përfshi edhe miratimin e masave për efikasitetin e shpërndarjes së barabartë të ngarkesës për prokurorinë në të gjitha nivelet.

7. Të hartojë në bashkëpunim edhe me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm metodologjinë lidhur me strategjinë dhe masat konkrete që do të ndërmerren për të zvogëluar stokun e prapambetur të çështjeve

në hetim në të gjitha nivelet (mbështetur edhe në përvojën e KLGJ-së) dhe për këtë të informohet Kuvendi brenda muajit nëntor.

8. Të intensifikojë masat për procesin e digjitalizimit të arkivave të sistemit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për ruajtjen, sistemimin dhe digjitalizimin e arkivave të sistemit të prokurorisë në tërësi.

9. Të vijojë bashkëpunimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, duke i propozuar brenda muajit nëntor 2025 vlerësimin e Këshillit për inspektimet tematike për vitin në vazhdim, trajtimin në kohë të çështjeve disiplinore dhe komandimin e inspektorëve magjistratë pranë ILD-së.

10. Të forcojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për emërimet, formimin fillestar dhe atë vazhdues të prokurorëve, përfshirë përmirësimin e përmbajtjes së kurikulave të trajnimeve sipas nevojave të sistemit.

11. Të miratojë rregullat dhe mekanizmat e domosdoshëm për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2024

Kuvendi i Republikës Shqipërisë,

Duke vlerësuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2024, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:

Zhvillimin e 65 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 764 vendimeve.

Miratimin e Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024–2027). Strategjia përcakton 7 objektiva, për zbatimin e të cilave nga ana e Këshillit janë miratuar një tërësi aktesh nënligjore.

Realizimin e vlerësimeve etiko-profesionale të gjyqtarëve si proces të lidhur ngushtë me zhvillimin e karrierës së tyre. Miratimin e 34 raporteve të vlerësimit, ndërsa gjatë periudhës 2020–2024 janë miratuar në total 190 raporte vlerësimi (nga të cilët, 78 gjyqtarë janë vlerësuar për 2 periudha vlerësimi dhe 41 gjyqtarë janë vlerësuar për 1 periudhë vlerësimi) për 119 gjyqtarë, duke vlerësuar rreth 63% të gjyqtarëve për 303 procedura vlerësimi të filluara.

Angazhimin në përgatitjen dhe rekrutimin e gjyqtarëve të rinj përmes emërimit të 32 magjistratëve të rinj, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023–2024; miratimit të 20 kuotave për kandidatë për magjistratë profili "gjyqtar" dhe të 15 kuotave për kandidatë për "ndihmës ligjorë" për vitin akademik 2024–2025; verifikimit të kritereve dhe kushteve formale-ligjore, si dhe të pasurisë dhe figurës për 56 kandidatë.

Finalizimin e 4 procedurave të ngritjes në detyrë në gjykatat që kanë edhe stokun më të lartë të çështjeve në pritje për gjykim në sistemin gjyqësor, 3 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; dhe 1 në Gjykatën Administrative të Apelit.

Caktimin e 66 gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme; 2 gjyqtarëve në skemën e delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit; transferimin në mënyrë të përkohshme të 21 gjyqtarëve, si dhe transferimin në mënyrë të përhershme, për shkak të suprimimit të pozicionit, për 6 gjyqtarë të tjerë.

Angazhimin në kuadër të rritjes së transparencës dhe forcimin e besimit të publikut përmes trajtimit të kërkesave për të drejtën e informimit; përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave për publikun, mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, vendimmarrjet e Këshillit, si dhe njoftimet dhe aktivitetin e tij.

Miratimin e vendimeve që kanë siguruar vazhdimësinë e funksionit të gjyqtarëve të medias, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë të gjyqtarëve.

Zbatimin e reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes miratimit të akteve strategjike dhe nënligjore me fokus nëpunësin civil gjyqësor, si dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullave dhe vlerësimin e kategorive të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Trajtimin e procedimeve disiplinore të reja gjatë vitit 2024, si dhe 5 çështje të mbartura nga vitet e mëparshme.

Mbështetjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes përpjekjeve për plotësimin e vakancave, krijimin e infrastrukturës mbështetëse, si dhe standardizimin e pajisjeve *hardware*.

Rritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe stafin administrativ.

Analizën për situatën e gjykatave në vend.

Bashkëpunimin ndërinstitucional me shumë aktorë, si dhe zhvillimin e takimeve me përfaqësues të diplomacisë dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Bashkëpunimin në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në BE nëpërmjet raportimit të zhvillimeve kryesore dhe rezultateve të arritura, si dhe përditësimit të masave të kërkuara nga Bashkimi Evropian por edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", si dhe kapitullit 24 "Drejtësia, liria dhe siguria".

Vijimin e ndjekjes dhe zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat, nëpërmjet raportimeve periodike të gjykatave, lidhur me zbatimin e objektivave strategjikë që përmbante ky plan, duke kontribuar në përmirësimin e komunikimit me publikun dhe mediat.

Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të bëjë një analizë mbi gjetjet dhe rekomandimet e BE-së (raport progresi dhe raporti "*Rule of Law*") dhe angazhimeve të marra në kuadrin e procesit të negociatave. Përfundimet e kësaj analize t'ia bëjë të njohur Kuvendit brenda muajit dhjetor 2025.

2. Të përmirësojë mekanizmat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore mbi funksionimin e gjykatave, për të siguruar transparencë, krahasueshmëri dhe raportim të standardizuar sipas udhëzimeve të CEPEJ.

3. Të intensifikojë monitorimin e zbatimit të planit të reduktimit të çështjeve të prapambetura (*backlog*), duke përcaktuar objektiva të matshëm për çdo gjykatë dhe duke raportuar periodikisht mbi progresin e arritur.

4. Të përmirësojë procesin e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve, në mënyrë që të garantojë objektivitet, transparencë dhe lidhje të qartë ndërmjet vlerësimit dhe avancimit në karrierë.

5. Të forcojë masat për rritjen e integritetit gjyqësor, duke përfshirë programe trajnimi mbi etikën, konfliktin e interesit dhe komunikimin publik.

6. Të sigurojë ndarjen e balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve, në mënyrë që të garantohet efikasiteti dhe barazia në trajtimin e çështjeve.

7. Të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të harmonizuar proceset e emërimit, trajnimit dhe vlerësimit të magjistratëve.

8. Të rrisë transparencën në procesin e komandimeve dhe emërimeve të përkohshme, duke siguruar respektimin e parimit të meritokracisë dhe shmangien e praktikave arbitrare.

9. Të intensifikojë masat për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave dhe kushteve të punës së gjyqtarëve, dhe veçanërisht sigurinë në të gjitha gjykatat e vendit, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Kuvendin dhe institucionet e ekzekutivit përmes Ministrisë së Drejtësisë.

10. Të zbatojë masat për digjitalizimin e plotë të procesit gjyqësor, përfshirë sistemin e regjistrimit elektronik të çështjeve, nënshkrimin elektronik dhe komunikimin elektronik me palët.

11. Të përgatisë raporte periodike mbi zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, duke e bërë këtë një pjesë integrale të procesit vjetor të raportimit.

12. Të përgatisë brenda muajit dhjetorit 2025 një analizë krahasuese të çështjeve gjyqësore të mbartura (*backlog*) përpara dhe pas reformës në drejtësi, përfshirë krahasimet me vendet e tjera të rajonit dhe me standardet e CEPEJ, me qëllim vlerësimin objektiv të ecurisë së sistemit gjyqësor dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme ligjore dhe institucionale.

13. Të raportojë mbi ecurinë e përgatitjes dhe miratimit të rregulloreve të parashikuara në ligj, duke adresuar pengesat që ndikojnë në përmbylljen e kuadrit nënligjor dhe duke siguruar funksionim të plotë institucional.

14. Të hartojë deri në dhjetor 2025 një analizë të plotë të vakancave në sistemin gjyqësor, duke përfshirë gjyqtarët e komanduar dhe nevojat për burime njerëzore, me qëllim hartimin e një plani të unifikuar për rekrutimin, trajnimin dhe sistemimin e gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjyqësorit, si dhe kërkesat për sistemin e rekrutimeve në Shkollën e Magjistraturës, nevojat për staf mbështetës etj.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe ministrin e Drejtësisë në kuadër të inspektimeve tematike dhe përmbushjes së detyrave të tjera funksionale;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Praktikën për të zhvilluar një proces konsultimi ndërinstitucional lidhur me përzgjedhjen e tematikave të inspektimeve, duke garantuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë dhe shoqërisë civile, me gjithë mungesën e angazhimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këtë proces.

Krijimin e mekanizmit të dedikuar për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, i cili përfshin kërkesa për informacion të adresuara institucioneve të inspektuara pas përfundimit të afatit të zbatimit të rekomandimeve, dhe analizë të përgjigjeve nga institucionet përkatëse nga ana e grupeve të inspektimit.

Rritjen e numrit dhe kompleksitetin e hetimeve, përfshirë rastet e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë, përmes dhe bashkëpunimit me ILDKPI-në dhe institucionet e tjera, e cila ka forcuar standardet e llogaridhënies.

Transparencën institucionale dhe qasjen e hapur ndaj qytetarëve përmes komunikimit publik, asistencës dhe aksesit në informacion, edukimi ligjor si domosdoshmëri për rritjen e besimit te drejtësia.

Kuvendi rekomandon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një format periodik të raportimit për zbatimin e rekomandimeve të inspektimeve, me tregues të matshëm, përmirësime të identifikuara apo raste të përsëritura, për të forcuar ndikimin dhe efektivitetin e inspektimeve.

2. Të përfshijë inspektimet vijuese si pjesë të planifikimit vjetor të inspektimeve dhe të parashikojë burimet përkatëse për realizimin e tyre për të siguruar verifikim të drejtpërdrejtë të zbatimit të rekomandimeve dhe analizë krahasuese ndër vite.

3. Të iniciojë një protokoll bashkëpunimi ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar akses në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive.

4. Të zhvillojë konsultime me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim identifikimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes inspektimeve tematike.

5. Të marrë masa për krijimin një sistemi për menaxhimin e çështjeve të ILD-së, me qëllim që të digjitalizojë proceset e shqyrtimit të ankesave, të verifikimit dhe hetimit, për të përmirësuar eficiencën, reduktuar vonesat dhe ndihmuar në ndjekjen në kohë reale të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve, por dhe transparencën me qytetarët.

6. Të hartojë raporte analitike periodike mbi tematikat e ankesave të qytetarëve, me qëllim identifikimin e prirjeve kryesore të problematikave të evidentuara nga publiku, institucionet dhe identifikimin e çështjeve për inspektime tematike.

7. Të zgjerojë dhe forcojë veprimtarinë ndërgjegjësuese të komunikimit institucional përmes fushatave tematike dhe përmbajtjeve edukative të përshtatura për publikun e gjerë. Këto nisma të synojnë rritjen e njohjes së të drejtave të qytetarëve dhe rolit të ILD-së, duke përmirësuar ndërveprimin qytetar-institucion dhe duke rritur besimin te mekanizmat e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

8. Të përgatitet deri në dhjetor 2025 një analizë përgjithësuese për inspektimet e kryera në periudhën 2020–2025; përputhshmërinë e tyre me prioritetet e përcaktuara nga vet sistemi, ashtu dhe nga pritshmëritë e qytetarëve gjatë kësaj periudhe; efektin e krijuar në sistem dhe në besimin e qytetarëve te drejtësia; problematikat e konstatuara; bashkëpunimin me institucionet e drejtësisë dhe ato të lidhura me procesin; si dhe nevojat për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit në të ardhmen.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke konsideruar tejet të rëndësishëm misionin kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke njohur, respektuar dhe mbështetur pavarësinë ligjore dhe institucionale të institucionit të SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit);

Duke vlerësuar rolin e saj të rëndësishëm në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë;

Duke vlerësuar angazhimin dhe rezultatet e arritura nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit gjatë vitit 2024 në përmbushje të përgjegjësive të tyre kushtetuese dhe ligjore dhe në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë;

Duke marrë në konsideratë rritjen e besimit të publikut dhe të partnerëve ndërkombëtarë, si dhe vlerësimet pozitive të shprehura për veprimtarinë e këtij institucioni nga BE-ja edhe në kuadrin e anëtarësimit të vendit në BE;

Në vlerësim të raportit të paraqitur për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij konstaton:

Përmirësim të treguesve statistikorë të hetimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Posaçme, veçanërisht për hetimet e nisura kryesisht, rritjes së procedimeve penale të regjistruara gjatë vitit 2024, si dhe intensifikimit të hetimeve financiare.

Rritje të ndjeshme të vlerës së pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në vlerën totale prej rreth 65.5 milionë eurosh, çka përfaqëson një rritje me 59.7% krahasuar me vitin 2023 dhe konfirmon efektivitetin në luftën kundër pasurimit të paligjshëm dhe pastrimit të parave.

Ruajtjen e një qasjeje proaktive në regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe rritje të numrit të hetimeve të nisura në këtë formë, duke reflektuar angazhimin institucional për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Përmirësimin e kapaciteteve institucionale përmes miratimit të udhëzimeve të reja, forcimit të hetimeve financiare, përfshirë hetimet me kriptovaluta, dhe zhvillimit të trajnimeve të specializuara për hetuesit dhe prokurorët.

Miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e brendshëm të institucionit dhe forcimin e integritetit dhe etikës institucionale.

Miratimin e Strategjisë së Komunikimit me Publikun për përmirësimin e marrëdhënieve me median dhe me publikun.

Angazhimin për hartimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025, si shprehje e vullnetit për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të ndjekur penalisht çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

Bashkëpunim të mirë dhe të qëndrueshëm me autoritetet e drejtësisë e agjencitë ligjzbatuese të BE-së, vendeve anëtare të saj dhe më gjerë, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja dhe krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore ndërkombëtare, të cilat përbëjnë një praktikë të mirë në luftën ndërkombëtare kundër krimit të organizuar.

Kuvendi rekomandon që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2025 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Ngritjen e një grupi pune në bashkëpunim edhe me Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për përgatitjen e një analize për Grupet e Krimit të Organizuar aktive në aktivitetin e tyre brenda e jashtë vendit dhe strategjinë e thellimit të luftës kundër tyre.

2. Përgatitjen e një analize për masat e sigurisë të marra në këto 5 vjet (2021 – 2025), politikat e ndjekura, problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për reflektim në praktikat e vendeve evropiane në këtë fushë dhe standardet e rekomanduara nga KiE, BE, GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

3. Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe KQZ-në, të zhvillojnë një analizë të përbashkët për zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025 dhe masat ligjore e institucionale që mund të ndërmerren për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të parandaluar e ndëshkuar çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

4. Zgjerimin e përdorimit të teknologjive të avancuara për gjurmimin e pasurive dhe rrjeteve financiare për çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

5. Vijimin e përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve teknike dhe logjistike për hetimet financiare, hetimin e krimeve kibernetike dhe pastrimit të parave, përfshirë kriptovalutat edhe përmes trajnimeve të specializuara dhe bashkëpunimit më të ngushtë me Europol dhe EMPACT.

6. Të bëhen përpjekje për unifikimin/ standardizimin e metodologjisë së hetimit lidhur me marrjen e provave dhe masat e sigurisë etj., bazuar edhe në vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet e GJEDNJ-së.

7. Finalizimin e miratimit të akteve të mbetura nënligjore, përfshirë udhërrëfyesin për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe aktet që lidhen me qarkullimin e brendshëm të dosjeve etj.

8. Zbatimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, përfshirë aktivizimin e moduleve të mbetura dhe përdorimin e sistemit për raportim të brendshëm dhe gjenerim statistikash në kohë reale.

9. Rritjen e efikasitetit institucional të Byrosë Kombëtare të Hetimit në zbatim të përcaktimeve të ligjit organik përmes plotësimit të vakancave dhe sigurimit të kushteve të nevojshme logjistike për funksionim të plotë të strukturës.

10. Vazhdimin e përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatim edhe të rekomandimeve të BE-së duke intensifikuar bashkëpunimin me agjencitë e BE-së (Eurojust, Europol, OLAF) dhe vendet anëtare për ndjekjen e çështjeve transnacionale për të përmbushur plotësisht rekomandimet e progresraportit të BE-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjanëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në formimin e gjykimeve të përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomike e sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë përparimin e INSTAT-it në forcimin e sistemit kombëtar statistikor, harmonizimin me standardet evropiane dhe zgjerimin e qasjes publike në informacion statistikor cilësor e të verifikuar.

Duke vlerësuar se statistikat zyrtare shpërndahen në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke garantuar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare, brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar, si dhe për të siguruar krahasueshmëri me vendet e tjera të rajonit dhe të Evropës;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Realizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, me mbulim rreth 97% të popullsisë dhe publikimin e rezultateve paraprake e të detajuara sipas kalendarit zyrtar dhe shoqërimit të procesit me një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi dhe përdorimit të teknologjive bashkëkohore për monitorim në kohë reale të intervistimeve.

Zhvillimit të platformës *"Geodata Hub"* dhe komponentit "*Web GIS*", që mundësojnë akses publik dhe institucional në të dhënat gjeohapësinore, duke forcuar përdorimin e informacionit statistik për planifikim dhe analiza territoriale.

Digjitalizimit dhe inovacionit teknik në proceset statistikore përmes përdorimit të pajisjeve elektronike dhe integrimit të burimeve administrative të të dhënave, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Rishikimit të llogarive kombëtare në vitin 2024, në bashkëpunim me Eurostat, përfshirë për herë të parë Tabelat e Furnizim-Përdorimit dhe llogaritë e sektorëve institucionalë, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë, krahasueshmërinë dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së (ESA 2010).

Zgjerimit të Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS) me përfshirjen e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si prodhues zyrtar të statistikave të energjisë, dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR) për shkëmbimin e të dhënave për rininë, duke forcuar koordinimin ndërinstitucional dhe unifikimin e standardeve metodologjike.

Rritjes së cilësisë dhe sasisë së të dhënave të transmetuara në Eurostat, përfshirë llogaritë kombëtare vjetore dhe rajonale, tregtinë e jashtme dhe statistikat fiskale (EDP/GFS), të cilat sipas Komisionit Evropian kanë shënuar përmirësime të ndjeshme në prodhim dhe raportim.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë puna për publikimet tematike "Post Census", me analiza që u përgjigjen nevojave të politikave publike, planifikimit vendor dhe kërkimit shkencor, dhe të përditësohet platforma e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.

2. Të rrisë numrin e treguesve në platformën "*Geodata Hub"* dhe "*Web GIS"*, si dhe të zhvillohen materiale orientuese dhe tutoriale për përdorues joteknikë, veçanërisht për njësitë e statistikave vendore dhe planifikuesit urban.

3. Të vijojë përgatitjet për realizimin e Censit të Ekonomive Bujqësore, ndjekur nga një strategji organizimi, kalendar të aktiviteteve dhe burime të përcaktuara financimi. Të bashkëpunohet me Ministrinë e Bujqësisë, FAO, Eurostat dhe të ndërmarrë një fushatë informuese për fermerët.

4. Të vazhdojë të udhëheqë koordinimin teknik dhe institucional me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave për përgatitjen e *metadata*-ve me standardet e FMN-së dhe përshtatjen e treguesve sipas SDDS.

5. Të vazhdojë punën për përmirësimin e llogarive sektoriale dhe financiare sipas standardeve të ESA 2010 dhe të sigurojë transmetimin në Eurostat.

6. Të përmirësojë statistikat mjedisore dhe të energjisë përmes zhvillimit të llogarive për emetimet në ajër, flukset fizike të energjisë dhe taksat mjedisore sipas sektorëve ekonomikë.

7. Të hartojë një kornizë strategjike për përdorimin e metodave moderne në prodhimin statistikor, me qëllim plotësimin e nevojave të përdoruesve në kohë dhe të detajuara.

8. Të mbajë aktive dhe të përditësojë rregullisht faqen e INSTAT-it në të gjitha kategoritë: statistika, publikime dhe dokumentim, si mjeti kryesor i aksesueshmërisë dhe komunikimit të INSTAT-it.

9. Të shpallë vakancat dhe të rekrutojë sa më shpejt stafin sipas sektorëve që paraqesin mangësi.

10. Të përmirësojë mbledhjen e statistikave për kërkimin dhe inovacionin duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet universiteteve dhe sektorit privat, mbështetur në manualet metodologjike të *Frascati*-t dhe *Oslo*-s.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Në mbështetje të mandatit të Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke marrë në konsideratë angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias;

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Fushëveprimin e gjerë të veprimtarisë së institucionit dhe rekomandimet që kanë pasur efekt të menjëhershëm rregullues, ndonëse kërkohet ndjekje më efektive e zbatimit të tyre;

Forcimin e aksesit dhe besimit të publikut ndaj institucionit, ku vihet re rritje e ndjeshme e numrit të kërkesave të adresuara.

Zhvillimin e një veprimtarie të gjerë mbikëqyrëse në sistemin penitenciar dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar nga liria, duke ushtruar ndikim konkret për respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut.

Mbikëqyrjen e strukturave të rendit dhe sigurisë publike, ku janë adresuar shkelje të të drejtave të qytetarëve dhe janë mbrojtur, gjithashtu, interesat legjitime të punonjësve të policisë dhe gardës, në një kuadër të balancuar institucional.

Analizën e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale përmes evidentimit të problematikave sistemike, si: vonesat, mungesa e transparencës dhe shkeljet e procesit të rregullt ligjor, si dhe adresimit të rekomandimeve konkrete për institucionet përgjegjëse.

Trajtimin e çështjeve të pronësisë dhe qeverisjes vendore, me theks te mangësitë institucionale dhe procedurale, që ndikojnë në sigurinë juridike të qytetarëve dhe cilësinë e shërbimeve publike.

Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, avokimit edukues dhe rritjes së ndërgjegjësimit, ku vihet re edhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e fëmijëve në paraqitjen e kërkesave.

Adresimin e problematikave në sistemin shëndetësor dhe të mbrojtjes sociale, me fokus në përmirësimin e qasjes në shërbime dhe garantimin e dinjitetit të qytetarëve.

Promovimin e të drejtave të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara përmes ndërhyrjeve konkrete, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe kontributit në hartimin e politikave kombëtare për moshimin aktiv dhe gjithëpërfshirës.

Angazhimin në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe femicidit përmes ngritjes së Observatorit për Femicidet, publikimit të raporteve analitike dhe zhvillimit të fushatave ndërgjegjësuese, që kanë forcuar rolin e institucionit në parandalimin dhe adresimin e kësaj forme të dhunës.

Kuvendi rekomandon që Avokati i Popullit për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë punën për hartimin e draftit të ri për ndryshimet në ligjin organik të Avokatit të Popullit, Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit për periudhën 2025–2029, duke reflektuar prioritetet dhe objektivat për rritjen e ndikimit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

2. Të ushtrojë më tej të drejtën për propozime ligjore dhe të rrisë ndikimin në konsultimet formale publike dhe institucionale, me synim harmonizimin e legjislacionit me standardet më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e procesit të integrimit evropian.

3. Të forcojë transparencën institucionale përmes publikimit të rregullt dhe të aksesueshëm të statistikave, rekomandimeve dhe dokumenteve relevante, si dhe përmes përmirësimit të mëtejshëm të faqes zyrtare në funksion të informimit dhe ndërveprimit me qytetarët.

4. Të zgjerojë aktivitetet ndërlidhëse me komunitetin, duke bashkëpunuar edhe me Kuvendin për të ndikuar direkt në informimin dhe fuqizimin e shtresave më të pambrojtura të shoqërisë.

5. Të forcojë kapacitetet institucionale dhe burimet buxhetore të institucionit për të përballuar rritjen e kërkesave për ndërhyrje dhe shërbime, në zbatim të detyrimit kushtetues për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

6. Të përditësojë dhe strukturojë faqen zyrtare të Avokatit të Popullit si një instrument funksional transparence dhe llogaridhënieje, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë për publikun dhe ndikimin e informacionit të publikuar në politikëbërje dhe ndërgjegjësim qytetar.

7. Të vijojë roli proaktiv në monitorimin dhe analizimin e zbatimit të rekomandimeve, në funksion të përmirësimit të përputhshmërisë me standardet e të drejtave të njeriut dhe realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në vend, në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe në nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2024, për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjikë afatmesëm, në këto drejtime:

Përmirësimit në hartimin e politikës monetare për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve analizuese, parashikuese dhe kërkimore.

Avancimit të integrimit financiar të Shqipërisë në Evropë, duke kulmuar me përfshirjen historike në zonën SEPA në vitin 2024, si një hap thelbësor që jo vetëm përmbush objektivat e Planit të Ri të Rritjes 2024–2027 të Komisionit Evropian, por, gjithashtu, fuqizon lidhjet ndërkombëtare, ul kostot e transaksioneve ndërkufitare dhe rrit efikasitetin e sistemit financiar, duke kontribuar në formalizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Fokusimit më tej në çështjet klimatike si pjesë e rëndësishme e mbikëqyrjes financiare, përmes hartimit dhe publikimit për herë të parë të udhëzuesit të pritshmërive mbikëqyrëse për përfshirjen e rreziqeve klimatike në proceset e brendshme të bankave, si dhe realizimit të një ushtrimi të posaçëm të provës së rezistencës me mbështetjen e Bankës Botërore. Paralelisht, u hartua një pyetësor për kompanitë më të mëdha në vend për ndikimin e ndryshimeve klimatike, i cili do të përdoret gjatë vitit 2025. Këto masa përfaqësojnë hapa konkretë drejt forcimit të qëndrueshmërisë klimatike të sistemit financiar dhe përgatitjes së sektorit bankar për zhvillimet rregullative në këtë fushë.

Forcimit të kuadrit makroprudencial përmes zbatimit të plotë të shtesave të kapitalit, duke përfshirë shtesën konservuese prej 2.5% dhe shtesat për bankat me rëndësi sistemike, ku për herë të parë u vendos dhe u rrit gradualisht shtesa kundërciklike e kapitalit, që arriti në 0.5% në fund të vitit. Njëkohësisht, Banka u angazhua edhe në përmirësimin e kuadrit rregullativ, duke rishikuar metodologjinë për identifikimin e bankave sistemike dhe përcaktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit, si dhe duke krijuar për herë të parë një bazë të detajuar të dhënash për standardet e kreditimit në sektorin e pasurive të paluajtshme.

Administrimit në mënyrë të kujdesshme të kërcënimeve kibernetike të vazhdueshme përmes përmirësimit të infrastrukturës së TI-së, përsosjes së kuadrit rregullator dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, si dhe përditësimit të sistemeve të sigurisë dhe planeve të vijimësisë, duke rritur aftësinë për reagim ndaj kërcënimeve kibernetike.

Monitorimit për sa i takon rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit atij operacional, etj., nëpërmjet realizimit të 11 ekzaminimeve në vend, nga të cilat 3 ekzaminime të plota në banka, 5 në subjekte financiare jobanka, 2 ekzaminime në institucione të parasë elektronike dhe 1 ekzaminim i plotë në shoqëri kursim-krediti (SHKK). Ekzaminimet kanë evidentuar nevoja për përmirësimin e administrimit të përgjithshëm të rreziqeve financiare, rrezikut operacional dhe të TIK-së, sigurimit të burimeve njerëzore të mjaftueshme etj. Për shkeljet e evidentuara, Banka ka marrë masat për revokim licence për 2 subjekte jobanka, pezullim aktiviteti për 2 subjekte jobanka dhe për 2 SHKK, gjobitje dhe dhënie vërejtjeje për administratorët për një bankë, tërheqje vëmendjeje për 1 ZKV; masë administrative (gjobë) për 12 ZKV dhe revokim licence për 1 ZKV.

Fuqizimit të kuadrit institucional dhe operativ për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka përmes plotësimit të kërkesave rregullatore për MREL, operacionalizimit të fondit përkatës dhe intensifikimit të bashkëpunimit me aktorët kombëtarë e ndërkombëtarë, duke synuar rritjen e gatishmërisë për ndërhyrje efektive dhe garantimin e stabilitetin financiar. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në fund të vitit 2024 arriti në rreth 5.7 nga 4.5 miliardë lekë që ishte në fund të vitit 2023, duke përbërë rreth 67.6% të nivelit të synuar për vetëm pas dy vitesh në vitin 2027.

Sigurimin e funksionimit maksimal të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe një për shlyerjen e titujve.

Në sistemin AIPS për vitin 2024 u shlyen një volum prej 168.6 mijë transaksionesh, me një vëllim total të likuiditetit të qarkulluar në sistem prej 13343 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje vjetore me rreth 3.8% në numër.

Në vitin e dytë të funksionimit të tij, në sistemin AIPS EURO janë procesuar 325 mijë transaksione pagesash për klientë, me vlerë totale prej rreth 5217 milionë eurosh, duke diktuar një vlerë mesatare për transaksion prej 16.1 mijë eurosh.

Në sistemin AECH për vitin 2023 janë realizuar një numër prej 1.62 milionë transaksionesh, duke shënuar rritje me 17.2 %, në krahasim me vitin 2023. Vlera e tyre arriti në 221.7 miliardë lekë, me një rritje prej 12%.

Gjithashtu, edhe sistemi AFISaR arriti të përfshijë 14 institucione financiare pjesëmarrëse, duke shënuar një rritje të konsiderueshme të numrit të llogarive të individëve në sistem në 19840. Vlera nominale e emetimeve të titujve të shtetit shqiptar në lekë u rrit me 7.68% duke arritur 788.51 miliardë lekë, duke dëshmuar zgjerimin dhe konsolidimin e këtij sistemi financiar.

Zgjerimit të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, duke treguar rritje të vazhdueshme të pagesave me karta, pagesave me para elektronike dhe pagesave *home banking*, dhe ku numri i pagesave në total pati rritje vjetore prej 24.4%, ndërsa vlera e pagesave u rrit me 17.8%. Ndërsa vetëm pagesat *home banking* në krahasim me vitin 2023, janë rritur me 22.1% në numër transaksionesh dhe me 19% në vlerë transaksionesh.

Nxitjes së inovacionit dhe përmirësimit të infrastrukturës së pagesave, si dhe të angazhimit aktiv për zhvillimin e një sistemi të integruar rajonal të pagesave të shpejta, i cili rrit efikasitetin financiar, përmirëson shërbimet për qytetarët dhe mbështet procesin e integrimit evropian, siç është edhe bashkëpunimi me Bankën e Italisë (BdI) për krijimin e një sistemi pagesash të shpejta identik me sistemin TIPS të Bankës Qendrore Evropiane (BQE-së) për Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkanit (sistemi referohet si TIPS Clone).

Akomodimin e kërkesës për *cash* në ekonomi, si dhe përfundimin e emetimit të plotë të serisë së re të kartëmonedhave. Në fund të vitit 2024 rezultuan rreth 161 milionë copë kartëmonedha në qarkullim

me vlerë 433 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2023, ka rritje të vlerës së kartëmonedhave me pothuajse 8% dhe rritje të numrit të monedhave në qarkullim me 4 milionë copë më shumë. Gjithashtu, Banka ka vijuar punën për frenimin e veprimtarisë së falsifikimit të kartëmonedhave duke sekuestruar 156 copë kartëmonedha dhe 50 monedha metalike.

Administrimin e rezervës valutore në përputhje me politikën e administrimit, ku për vitin 2024 rezerva valutore është rritur me rreth 422 milionë euro në krahasim me vitin 2023. Kthimi i rezervës valutore ka rezultuar pozitiv 2.9%, si rezultat i normave të larta të interesit në tregun ndërkombëtar.

Harmonizimin e statistikave me *acquis communitare*, intensifikimi i punës kërkimore në mbështetje të vendimmarrjes dhe rritjes së transparencës dhe edukimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me publikun përmes botimeve të rregullta për politikën monetare, stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen bankare, si dhe përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë në lidhje me veprimtarinë e Bankës.

Kuvendi kërkon që Banka e Shqipërisë për periudhën në vijim të angazhohet në këto drejtime:

1. Të pasurojë modelet makroekonomike, duke përfshirë adoptimin në vazhdimësi të metodave bashkëkohore të kërkimit shkencor, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë, saktësinë dhe përshtatshmërinë e parashikimeve dhe vlerësimeve ekonomike dhe financiare, duke mbajtur gjithmonë në fokus orientimin e politikës monetare drejt garantimit të qëndrueshmërisë së çmimeve si një parakusht themelor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

2. Të koordinojë politikën monetare me atë fiskale, në mënyrë që të sigurohet një qasje e harmonizuar dhe sinergjike që jo vetëm të mbështesë stabilitetin makroekonomik dhe kontrollin efektiv të inflacionit, por edhe të krijojë kushtet për një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe përmirësim të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.

3. Të adoptojë një qasje të matur dhe të kujdesshme ndaj ndërhyrjeve në tregun valutor, duke i kufizuar ato në raste të nevojshme dhe të justifikuara nga rrethanat e tregut, në mënyrë që të forcohet funksioni i kursit të këmbimit si një mekanizëm vetërregullues i ekonomisë, i cili ndihmon në zbutjen e goditjeve të jashtme, ruajtjen e konkurrueshmërisë dhe mbështetjen e një ekuilibri të qëndrueshëm makroekonomik.

4. Të forcohet mbikëqyrja për sa i takon ekspozimit të sistemit bankar ndaj kredimarrësve të mëdhenj dhe të diversifikohet portofoli i kredive, me qëllim zbutjen e përqendrimit në sektor dhe në territor, duke rritur kapacitetin e bankave në mënyrë që sistemi bankar të ruajë kapitalizimin dhe qëndrueshmërinë edhe në raste të vështirësive të huamarrësve kryesorë, si dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

5. Të intensifikojë monitorimin e kredive ndaj sektorit të ndërtimit dhe projekteve të mbështetura me pasuri të paluajtshme, duke siguruar vlerësim më konservativ të kolateralit dhe aftësisë paguese, për të reduktuar rrezikun e përqendruar në këtë sektor dhe për të ruajtur stabilitetin e sistemit bankar.

6. Të integrojë rreziqet klimatike dhe ato të tranzicionit në kuadrin mbikëqyrës përmes zhvillimit të një kornize gjithëpërfshirëse për identifikimin, matjen, menaxhimin dhe raportimin e ekspozimeve ndaj sektorëve të ndjeshëm, e cila duhet të parashikojë kërkesën që bankat e nivelit të dytë të dokumentojnë politikat përkatëse të menaxhimit të rreziqeve klimatike, të raportojnë rregullisht ekspozimet përkatëse dhe të kryejnë analiza e stres-teste mbi ndikimet e mundshme klimatike dhe të tranzicionit, si dhe të ofrojnë instrumente të domosdoshme për financimin e projekteve, që janë në përputhje me këtë agjendë të Shqipërisë në linjë me procesin e integrimit evropian.

7. Të përshpejtojë procesin e përafrimit të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës me standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Bazel III, në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar dhe përgatitjes së vendit për integrimin në tregun e përbashkët evropian.

8. Të forcojë mbikëqyrjen ndaj institucioneve financiare jobanka, për të synuar zbatimin e plotë të ndryshimeve rregullatore të miratuara gjatë vitit të kaluar, për të përmirësuar cilësinë e portofolit të kredive dhe mbrojtjen e kredimarrësve.

9. Në bashkëpunim me autoritetet e tjera përgjegjëse, të harmonizojë dhe të përditësojë në vijimësi planet për reagimin ndaj sulmeve kibernetike në sektorin bankar dhe në sistemet e pagesave të operuara prej saj, si dhe të angazhohet

në vazhdimësi për realizimin e testimeve të sigurisë për çdo bankë sistemike.

10. Të shtojë mbikëqyrje të vazhdueshme mbi aktivitetin e zyrave të këmbimit valutor, specifikisht për plotësimin e kërkesave të reja rregullatore, me synim garantimin e integritetit dhe transparencës së sistemit financiar.

11. Në bashkëpunim me institucionet e tjera të fushës, të sigurojë zbatimin rigoroz të të gjithë kuadrit rregullativ raportues, parandalues dhe të vigjilencës në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të gjitha subjektet që mbikëqyr.

12. Të vijojë përditësimin dhe përfshirjen e kuadrit ligjor dhe rregullativ në fushën e pagesave në përputhje me legjislacionin dhe treguesit orientues (*benchmarks*) të Bashkimit Evropian të përcaktuar në procesin e negociatave, si dhe me nevojat e tregut. Të vazhdojë procesin e integrimit në sistemin TIPS dhe të mbështesë nisma për rritjen e aksesit në pagesa në kohë reale për popullatën dhe bizneset përmes inovacionit teknologjik.

13. Të rrisë bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet publike për ndërgjegjësimin mbi dëmet e dezinformimit financiar, si dhe të hartojë dhe zbatojë rregullore standarde për parandalimin dhe monitorimin e tij, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe forcimin e sigurisë kombëtare.

Gjithashtu, Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave të përshpejtojë plotësimin e kuadrit ligjor për institucionet financiare jobankare përmes:

1. Finalizimit të procesit të ndryshimeve në ligjin nr. 9902/2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, duke parashikuar vendosjen e një tavani mbi normat e interesit dhe penalitetet për kreditë konsumatore, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikat abuzuese dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit nga autoriteti mbikëqyrës.

2. Ndërmarrjes së ndryshimeve të nevojshme në Kodin Civil për përcaktimin me ligj të normës së penalitetit për vonesat në shlyerjen e detyrimeve dhe të kamatës ligjore, me qëllim krijimin e një kuadri të qartë dhe të parashikueshëm që parandalon abuzimet dhe garanton trajtim të drejtë për palët kontraktuese.

3. Hartimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr. 26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", me qëllim forcimin e mbrojtjes ligjore të palëve, specifikisht konsumatorit, dhe parandalimin e abuzimeve gjatë ekzekutimit të detyrimeve.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicave kombëtare;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar gjatë vitit 2024 në drejtim të:

Transmetimit në strukturën programore të RTSH-së, me 16 kanale televizive dhe 11 radiofonike duke mbuluar mbi 95% të territorit dhe rreth 80% të popullsisë, të një programacioni të larmishëm, me qëllim plotësimin e misionit informues, edukues dhe argëtues.

Forcimit të diversitetit kulturor përmes transmetimit të përmbajtjeve programore në 8 gjuhë minoritare, duke garantuar përfshirje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet.

Transmetimit të disa prej ngjarjeve kryesore sportive ndërkombëtare dhe vendase dhe rritjes së audiencës përmes transmetimit të Kampionatit Shqiptar të Futbollit.

Vijimit të procesit të digjitalizimit të arkivit së institucionit me qëllim ruajtjen dhe aksesin e sigurt

të materialeve audiovizive, si dhe modernizimin e pasurisë arkivore.

Kuvendi kërkon që Radiotelevizioni Shqiptar, për vitin 2025, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të angazhohet në hartimin dhe miratimin e një plani strategjik për rimodelimin e transmetuesit publik, me qëllim ristrukturimin organizativ e strukturor, ristrukturimin buxhetor (fokusim të fondeve nga pagat drejt investimeve në përmbajtje dhe teknologji), përmirësimin e përmbajtjeve programore, si dhe zhvillimin e teknologjive digjitale, në përputhje me standardet bashkëkohore.

2. "RTSH Kuvend", përmes angazhimit të stafit redaksional, të përfshijë në programacion përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

3. Të realizojë një audit të plotë, me qëllim vlerësimin e situatës financiare aktuale të institucionit, analizimin e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike, si dhe t'ia përcjellë raportin analitik Kuvendit të Shqipërisë.

4. Të intensifikojë procesin e digjitalizimit të arkivit së institucionit.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar se pavarësia dhe pluralizmi i mediave, transparenca e burimeve të financimit, si dhe transparenca e pronësisë së mediave kanë një rëndësi të veçantë në forcimin e demokracisë dhe integrimin evropian të vendit;

Duke konsideruar matjen e audiencës si një instrument të rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri;

Duke theksuar nxitjen dhe mbështetjen e standardeve profesionale të transmetimeve audiovizive përmes praktikave më të mira ndërkombëtare;

Për vitin 2024 vlerëson:

Punën e bërë nga AMA në kuadër të transparencës së strukturës së pronësisë nëpërmjet miratimit të rregullores "Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të pronësisë së OSHMA", si dhe paraqitjen grafike në faqen *web* të AMA-s të transparencës e strukturës së pronësisë së shoqërive/individëve të pajisur me licencë/autorizim nga AMA dhe deklaratën e pronarit përfitues të këtyre subjekteve.

Punën e bërë nga AMA për realizimin e procesit të matjes së audiencës, duke organizuar tri tryeza me ofrues të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) dhe agjenci komunikimi e marketingu, të cilat sollën si rezultat krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), funksionimi i të cilit do të mundësojë matjen e audiencës si një instrument i rëndësishëm për vetë operatorët, por dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen dhe transparencën e tregut audioviziv në Shqipëri.

Punën e bërë nga AMA për miratimin e rregullores "Për kërkesat e posaçme që ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove duhet të përmbushin për krijimin e ofrimin e sistemeve transparente, efektive e miqësore në përdorim", e cila është një akt i rëndësishëm nënligjor që trajton në mënyrë të posaçme rregullimin ligjor të Platformave të Shpërndarjes së Videove (PSV).

Bashkëpunimin ndërmjet AMA-s dhe platformës "Tik-Tok" në mbrojtje të përdoruesve shqiptarë të kësaj platforme lidhur me përmbajtje të dëmshme dhe komunikime tregtare, me qëllim piratimin e produktit audioviziv shqiptar. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, janë shqyrtuar në total nga ekipet e AMA-s 743 video për përmbajtje të dëmshme dhe 1513 për pirateri dhe në bashkëpunim me platformën "Tik-Tok" u arrit të hiqeshin 286 video me përmbajtje të dëmshme, 1505 video dhe 193 profile të raportuara për pirateri.

Punën e bërë nga AMA në drejtim të zbatimit nga ana e OSHMA-ve të Kodit të Ri të

Transmetimit, veçanërisht pikat të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, që janë zgjeruar në Seksionin "Fëmijë në mediat audivizive" dhe nënndarjet përkatëse.

Organizimin nga AMA të tryezës me temë: "Fol shqip – të mbrojmë dhe të duam gjuhën shqipe", si pjesë e një fushate tepër të rëndësishme, pasi gjuha është tipar themelor i një kombi, prandaj atë duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë.

Punën e bërë nga AMA në lidhje me ndryshimet ligjore të propozuara në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të forcuar luftën kundër piraterisë televizive, ndryshime të cilat bëjnë të mundur përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* e BE-së në fushën e medias audiovizive.

Punën e bërë nga AMA si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për lirimin e brezit digjital divident dy (DD2), veçanërisht kontributin e saj në ofrimin e zgjidhjeve të përkohshme për trajtimin e problematikave të procesit.

Punën e bërë nga AMA, në kuadër të përmirësimit të kapaciteteve njerëzore të Autoritetit, përmirësimit të sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të rolit rregullator të saj.

Kuvendi i rekomandon AMA-s për vitin 2025:

1. Në kuadër të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të rekomandimeve të BE-së, bazuar në praktikat e së drejtës evropiane mbi reklamat institucionale, të propozojë ndryshimet përkatëse në ligj, të cilat ndër të tjera rregullojnë procesin që AMA kryen lidhur me matjen e volumit të reklamës institucionale.

2. Me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit, të punojë për rritjen e kapaciteteve për monitorimin cilësor dhe sasior të transmetimeve audiovizive, duke shtuar shqyrtimet që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrregullimeve në informacion, proceset zgjedhore etj.

3. Në kuadër të zbatimit të Kodit të ri të Transmetimit, duke pasur parasysh, nga njëra anë, rritjen e ndjeshme të numrit të ankesave që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (59.5% të ankesave krahasuar me 16.4% në 2023) dhe nga ana tjetër duke parë rritjen e ndjeshme të ankesave lidhur me shmangiet e tjera etike, ku përfshihen përdorimi i fjalorit joetik, pasaktësitë apo devijimet në ligjërim, apo moskuptimi i specifikave të gjinive mediatike etj., institucioni të tregojë vëmendje të veçantë lidhur me rastet e ankesave për të drejtat e fëmijëve dhe privatësisë së tyre, si dhe të marrë masa për intensifikimin e edukimit mediatik.

4. Të kërkojë që Ofruesit e Shërbimeve të Mediave Audiovizive të hartojnë plane veprimi mbi aksesin në mënyrë progresive në shërbimet e ofruara prej tyre nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ketë në vëmendje që pika e kontaktit në faqen e saj zyrtare për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave për personat me aftësi të kufizuara të jetë funksionale dhe lehtësisht e arritshme prej tyre.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet, që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024 në drejtim të:

Mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike të 34 subjekteve me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil.

Realizimit të mbikëqyrjes së skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore.

Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Mbikëqyrjes së orientuar nëpërmjet monitorimit *online* dhe në subjekt, në lidhje me rekrutimet e realizuara nga Departamenti i Administratës Publike.

Monitorimit të proceseve të rekrutimit në administratën vendore, me qëllim parandalimin e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

Trajtimit të 95% të informacioneve/ kërkesave/ sinjalizimeve, që kanë ardhur për shqyrtim në drejtim të Komisionerit brenda vitit 2024.

Kuvendi kërkon që Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1.Të intensifikohen inspektimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u dhënë përparësi atyre me shkelje të përsëritura të procedurave të shërbimit civil.

2.Të zhvillohen mekanizma për monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në nivel vendor.

3. Me qëllim përmirësimin e transparencës dhe komunikimit publik, KMSHC-ja të zhvillojë platformat digjitale për raportim dhe ankim nga nëpunësit civilë, dhe qytetarët për shkelje të procedurave.

4. Në bashkëpunim të ngushtë me DAP-in, të intensifikojë angazhimin në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore për rikthim në detyrë të nëpunësve civilë.

5.Të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2025 dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike për gjetjet e këtij monitorimi.

6. Të investohet në hartimin e një raporti vjetor me listimin e institucioneve me shkelje të përsëritura dhe propozime për ndërhyrje nga institucionet mbikëqyrëse.

7. Të angazhohet në hartimin e një raporti analitik në lidhje me kostot financiare për buxhetin e shtetit në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, si dhe në lidhje me vendimet gjyqësore të paekzekutuara.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 30.10.2025.

DEKRET
Nr. 389, datë 10.11.2025

PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "dh", nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ermal Dredha emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Konfederatën e Zvicrës, rezident, dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Principatën e Lihtenshteinit, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 1120, datë 3.11.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MENAXHIMIN E PESHKIMIT NË ZONËN E KUFIZUAR TË PESHKIMIT NË KANALIN E OTRANTOS (GSA 18)"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 3, të marrëveshjes "Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun", të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për menaxhimin e peshkimit në Zonën e Kufizuar të Peshkimit në Kanalin e Otrantos (GSA 18)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të peshkimit dhe akuakulturës, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe inspektorati që mbulon fushën e peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E PESHKIMIT NË ZONËN E KUFIZUAR TË PESHKIMIT NË KANALIN E OTRANTOS (GSA 18)

Objektivi dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qellim menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit në Zonën e Kufizuar të Peshkimit në Kanalin e Otrantos (GSA 18) miratuar me rekomandimin GFCM/47/2024/6 për miratimin e një zone të kufizuar peshkimi në Kanalin e Otrantos (GSA 18), në rrjedhojë të rekomandimit GFCM/43/2019/5 dhe rezolutës GFCM/44/2021/3, me synim kontributin në mbrojtjen e ekosistemeve detare të ndjeshme (në veçanti të koraleve si *Isidella elongata)* dhe të habitateve thelbësore për peshqit (EFH) të specieve fundore, veçanërisht karkalecave të thellësisë, si dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të rezervave kryesore fundore në detin Adriatik, të cilat menaxhohen në kuadër të planit të menaxhimit për peshkimin fundor në Detin Adriatik.

2. Për qëllimet të kësaj rregullore, Zona e Kufizuar e Peshkimit, e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni do të ndahet në zonën A dhe në zonën B dhe do të kufizohet në koordinatat gjeografike të përcaktuara në shtojcën 1.

Përkufizimet

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Anije e peshkimi e autorizuar" nënkupton një anije peshkimi e pajisur me një autorizim/leje specifike peshkimi;

b) "Autorizimi për peshkim" ka të njëjtin kuptim si në ligjin 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

c) "Ditë peshkimi" nënkupton çdo periudhë të pandërprerë prej 24 orësh, ose pjesë të saj, gjatë së cilës një anije peshkimi është në kërkim të peshkut, hedh, vendos, tërheq, nxjerr vegla peshkimi, ngarkon zëniet në bord, transbordon, mban në bord, përpunon në bord, transferon ose zbarkon peshk dhe produkte peshkimi;

d) "Leje peshkimi" ka të njëjtin kuptim si në ligjin 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

e) "Ministria" është ministria që mbulon aktivitetin e peshkimit;

f) "Peshkim çlodhës-argëtues" ka të njëjtin kuptim si në ligjin 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

g) "Zonë e kufizuar e peshkimit" ka të njëjtin kuptim si në ligjin 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

Menaxhimi dhe monitorimi i kapacitetit të peshkimit dhe i sforcos së peshkimit në zonën e kufizuar të peshkimit në Kanalin e Otrantos

1. Ndalohet çdo aktivitet peshkimi tregtar profesional fundor ose çlodhës argëtues në zonën A (zona bërthamë).

2. Ndalohen në periudhën 1 tetor–30 nëntor të çdo vit, aktivitetet e peshkimit me rrjeta fundore, trata fundore, linjë grepash dhe kurthe në zonën B (zonë buferike).

3. Në përjashtim të parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, aktivitetet profesionale të peshkimit me rrjeta fundore, trata fundore, linjë grepash dhe kurthe lejohet në zonën B, me kusht që mjeti lundrues të jetë i pajisur me një leje të vlefshme peshkimi dhe që të dëshmohet historiku i aktiviteteve të peshkimit në zonën B. Ministria krijon një regjistër të anijeve të peshkimit të autorizuara për të peshkuar në këtë zonë gjatë periudhës në fjalë.

4. Anijet e peshkimit të autorizuara për të peshkuar në zonën B nuk mund të peshkojnë për më shumë se shtatëdhjetë ditë peshkimi në vit ose dy ditë peshkimi në javë.

Masat e kontrollit

1. Ministria mban një regjistër të anijeve të peshkimit të autorizuara për të peshkuar në zonën B.

2. Ministria i dërgon Sekretariatit të Komisionit të Përgjithshme për Peshkimin në Mesdhe (KPPM/GFCM), jo më vonë se data 30 nëntor 2025, listën e anijeve të peshkimit të autorizuara për të peshkuar në zonën e kufizuar të peshkimit. Çdo vit pasues, kjo listë dorëzohet jo më vonë se data 30 qershor. Për çdo anije peshkimi, lista duhet të përmbajë informacionin e detajuar në shtojcën 2.

3. Anijet e peshkimit të autorizuara për të peshkuar në zonën B duhet të jenë të pajisura me sistemin e monitorimit të anijeve (VMS) dhe me sistemin sistem automatik identifikimi (AIS) në gjendje të rregullt pune, dhe veglat e peshkimit në bord duhet të jenë të shënuara dhe numëruara përpara fillimit të çdo operacioni peshkimi ose lundrimi në zonën e kufizuar të peshkimit.

4. Çdo aktivitet peshkimi, i cili zhvillohet në zonën B nga anijet e peshkimit të pajisura me rrjeta fundore, trata fundore, linjë grepash dhe kurthe duhet të regjistrohet në Sistemin e Raportimit Elektronik (ERS).

5. Anijet e peshkimit të pajisura me rrjeta fundore, trata fundore, linjë grepash dhe kurthe, të paautorizuara për të peshkuar në zonën e kufizuar të peshkimit, lejohen të lundrojnë përmes kësaj zone, vetëm nëse:

a) ndjekin një kurs të drejtë lundrimi me një shpejtësi të qëndrueshme jo më të vogël se 7 nyja, përveçse në rastet e forcës madhore. Në këtë rast, kapiteni i anijes informon QNOD-në.

b) të jenë të pajisura me VMS dhe AIS aktiv në bord.

c) të gjitha mjetet e peshkimit në bord janë hequr dhe lidhur gjatë transitit;

6. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) monitorojnë nëpërmjet sistemeve elektronike të përmendura në piken 5 të këtij neni, anijet e shqiptare gjatë hyrjes, transitimit dhe daljes nga Zona e Kufizuar e Peshkimit.

7. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës monitorojnë konsumin e kufirit vjetor të ditëve të peshkimit të vendosur për secilën anije peshkimi, të autorizuara për të peshkuar në zonën B, në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe raporton në MBZHR me frekuencë mujore. Nga data kur kufiri vjetor i ditëve të peshkimit është konsumuar, Ministria urdhëron ndalimin e aktivitetit të peshkimit në zonën B për anijet e peshkimit për të cilat kufiri vjetor i ditëve të peshkimit është konsumuar.

8. Me qëllim monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të peshkimit në zonën e kufizuar të peshkimit në Kanalin e Otrantos, inspektorati përgjegjës për peshkimin në bazë të një analize risku, zhvillon aktivitete inspektuese në det dhe në porte, vetëm ose në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve detare.

9. Aktivitetet e përmendura në pikën 8 duhet të planifikohen në planin vjetor dhe mujor të inspektimit, duke përfshirë institucionet pjesëmarrëse, si dhe mjetet lundruese që do të përdorën.

SHTOJCA 1
KOORDINATAT GJEOGRAFIKE NË ZONËN E KUFIZUAR TË PESHKIMIT NË KANALIN E OTRANTOS



Zona A (zona bërthamë)			
Pika	**ID**	**Latitude**	**Longitude**
1	A	40° 57' 43.84800000" N	018° 33' 17.85600000" E
2	B	40° 58' 28.03368000" N	018° 42' 45.85824000" E
3	C	40° 55' 15.45024000" N	018° 46' 23.21868000" E
4	D	40° 52' 28.76988000" N	018° 48' 11.33568000" E
5	D2	40° 50' 10.64724000" N	018° 50' 36.78360000" E
6	E	40° 46' 36.26328000" N	018° 52' 23.60856000" E
7	F	40° 39' 36.98856000" N	018° 57' 26.91756000" E
8	G	40° 30' 42.01848000" N	018° 59' 22.69464000" E
9	H	40° 21' 40.96800000" N	019° 04' 21.28800000" E
10	I	40° 18' 30.42000000" N	018° 54' 06.12000000" E
11	P	40° 18' 09.88610400" N	018° 44' 56.45333400" E
12	O	40° 21' 35.41141080" N	018° 42' 55.44978840" E
13	N	40° 33' 48.79144800" N	018° 41' 47.41117440" E
14	M	40° 42' 56.59378560" N	018° 37' 57.75797640" E
15	L	40° 48' 08.42628600" N	018° 30' 02.37403440" E
16	K	40° 50' 53.47825080" N	018° 21' 48.06343080" E
17	J	40° 52' 12.60584760" N	018° 19' 11.93260080" E

Zone B (Zona buferike)			
Pika	**ID**	**Latitude**	**Longitude**
1	Q	40° 59' 23.96400000" N	018° 32' 23.78400000" E
2	R	40° 52' 28.12800000" N	018° 13' 56.20800000" E
3	S	40° 49' 07.64400000" N	018° 20' 31.88400000" E
4	T	40° 46' 24.38400000" N	018° 28' 43.32000000" E
5	U	40° 41' 39.37200000" N	018° 35' 56.79600000" E
6	V	40° 33' 24.44400000" N	018° 39' 13.14000000" E
7	W	40° 21' 05.61600000" N	018° 40' 20.71200000" E
8	X	40° 16' 05.62800000" N	018° 43' 17.50800000" E
9	Y	40° 16' 31.94400000" N	018° 54' 19.65600000" E
10	Z	40° 20' 34.40400000" N	019° 06' 31.70916000" E
11	AA	40° 30' 59.31612000" N	019° 00' 54.54936000" E
12	AB	40° 40' 45.02136000" N	018° 58' 40.49868000" E
13	AC	40° 45' 45.86436000" N	018° 54' 12.23640000" E
14	AD	40° 47' 56.52672000" N	018° 53' 17.58480000" E
15	AD2	40° 49' 19.90344000" N	018° 51' 20.36196000" E
16	AF	40° 53' 15.18144000" N	018° 48' 36.66528000" E
17	AE	41° 00' 17.90856000" N	018° 44' 47.24772000" E

SHTOJCA 2

Në listën e anijeve të peshkimit të lejuara, për të ushtruar aktivitet peshkimi brenda zonës së kufizuar të peshkimit, duhet të përmbahet informacioni i mëposhtëm për secilën anije:

- Emri i anijes;
- Numri i regjistrimit i caktuar në regjistrin detar;
- Numër unik identifikimi i një anijeje peshkimi (NFR);
- Emri i mëparshëm i anijes (nëse ka);
- Flamuri i mëparshëm (nëse ka);
- *(International radio call sign)* Shenja ndërkombëtare radio e thirrjes (nëse ka);
- Lloji i anijes, gjatësia e përgjithshme në metra e anijes dhe tonazhi bruto;
- Emri dhe adresa e pronarit;
- Vegla kryesore e peshkimit e përdorur në Zonën e Kufizuar të Peshkimit;
- Periudha në të cilën anija është e autorizuar për të peshkuar në zonën e kufizuar të peshkimit;
- Ditët e peshkimit të kryera nga secila anije në zonën e kufizuar të peshkimit gjatë vitit të mëparshëm.

URDHËR
Nr. 1124, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Warmińsko-Mazurskie	Iława	Susz*
Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
Wielkopolskie	Turek	Przykona*
Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
Warmińsko-Mazurskie	Iława	Iława (rural)*
Warmińsko-Mazurskie	Iława	Zalewo*
Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
Wielkopolskie	**Środa Wielkopolska**	**Środa Wielkopolska***

Shënim. Simboli (*****) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1097, datë 30.10.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1125, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Baranya	Szigetvár*	
Borsod-Abaúj-Zemplén	Sátoraljaújhely*	
Somogy	Kadarkút*	
Somogy	Kaposvár*	
Vas	Sárvár*	

Vas	Szentgotthárd*	
Vas	**Őriszentpéter***	
Veszprém	Ajka*	
Veszprém	Tapolca*	
Zala	Lenti*	
Zala	Zalaegerszeg*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, ose;

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të

Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermëd dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1096, datë 30.10.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Hungarisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1126, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Bolzano	Bolzano	Renon*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Grado*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Gorizia*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	Mossa*
Friuli-Venezia Giulia	Gorizia	San Pier d' Isonzo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Arzene*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Budoia*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Cordenons*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Erto E Casso*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Frisanco*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Fontanafredda*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Maniago*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Montereale Valcellina*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Vito d' Asio*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	San Giorgio Della Richinvelda*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	San Quirino*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	San Vito Al Tagliamento*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Sequals*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Spilimbergo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Polcenigo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sopra*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sotto*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Travesio*
Friuli-Venezia Giulia	Trieste	Muggia*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Attimis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Arta Terme*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Basiliano*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cassacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cividale Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Chiusaforte*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Comeglians*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Gemona Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paluzza*

Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ravascletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Raveo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Premariacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pontebba*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Nimis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Magnano In Riviera*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Malborghetto Valbruna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Moggio Udinese*
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Moruzzo***
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Prepotto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Grimacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paularo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pagnacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Artegna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Leonardo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Daniele Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Forgaria Nel Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Faedis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Savogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ragogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ovaro*
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Tarvisio***
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Taipana*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tricesimo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tolmezzo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Torreano*
Sardegna	Cagliari	Quartucciu*
Sardegna	Sud Sardegna	Giba*
Sardegna	Sud Sardegna	Masainas*
Sardegna	Sud Sardegna	Narcao*
Sardegna	Sud Sardegna	Nuxis*
Sardegna	Sud Sardegna	Perdaxius*
Sardegna	Sud Sardegna	Piscinas*
Sardegna	Sud Sardegna	Sant' Anna Arresi*
Sardegna	Sud Sardegna	Santadi*
Sardegna	Sud Sardegna	Teulada*
Sardegna	Sud Sardegna	Tratalias*
Sardegna	Sud Sardegna	Villaperuccio*
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Antey-Saint-André*
Valle d'Aosta	Aosta	Arvier*
Valle d'Aosta	Aosta	Arnad*
Valle d'Aosta	Aosta	Ayas*
Valle d'Aosta	Aosta	Aymavilles*
Valle d'Aosta	Aosta	Bard*
Valle d'Aosta	Aosta	Bionaz*
Valle d'Aosta	Aosta	Brissogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Brusson*
Valle d'Aosta	Aosta	Charvensod*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*
Valle d'Aosta	Aosta	Champorcher*
Valle d'Aosta	Aosta	Chamois*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Victor*
Valle d'Aosta	Aosta	Cogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Emarèse*
Valle d'Aosta	Aosta	Fénis*
Valle d'Aosta	Aosta	Fontainemore*
Valle d'Aosta	Aosta	Gignod*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressan*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressoney-Saint-Jean*
Valle d'Aosta	Aosta	Hone*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Pontey*
Valle d'Aosta	Aosta	Pollein*
Valle d'Aosta	Aosta	Roisan*
Valle d'Aosta	Aosta	Rhemes-Saint-Georges*
Valle d'Aosta	Aosta	Nus*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Issogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Issime*
Valle d'Aosta	Aosta	La Salle*
Valle d'Aosta	Aosta	Jovençan*
Valle d'Aosta	Aosta	Lillianes*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Christophe*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Marcel*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Nicolas*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Vincent*
Valle d'Aosta	Aosta	Torgnon*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrès*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer

të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes, dhe;

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1112, datë 3.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1127, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
Bourgogne-Franche-Comté	**Côte-d'Or**	**Beaune***
Grand Est	**Marne**	**Vitry-le-François***

Shënim. Simboli (*****) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1116, datë 3.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1128, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Veneto	Verona	Oppeano*
Veneto	Verona	Isola Della Scala*
Piemonte	Alessandria	Occimiano*
Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
Emilia-Romagna	Forli' - Cesena	Forlì*
Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolasco*
Emilia-Romagna	**Bologna**	**San Giovanni In Persiceto***
Emilia-Romagna	**Modena**	**Soliera***

Shënim. Simboli (*****) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1117, datë 3.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1129, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr.

10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55ºC në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55ºC në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55ºC në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57ºC në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65ºC në 39.8 sekonda;

ii. 70ºC në 3.6 sekonda;

iii. 74ºC në 0.5 sekonda;

iv. 80ºC në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
4	Podlaskie	Białystok	Łapy*
5	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
6	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chełmża (rural)*
7	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
8	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
9	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
10	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
11	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
12	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
13	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
14	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
15	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
16	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
17	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
18	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
19	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
20	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
21	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
22	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
23	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
24	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
25	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
26	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
27	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
28	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
29	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
30	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
31	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
32	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
33	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
34	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
35	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
36	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
37	**Zachodniopomorskie**	**Białogard**	**Białogard (rural)***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 2.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 1115, datë 3.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1130, datë 4.11.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
Niedersachsen	Vechta	Vechta*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
Niedersachsen	**Emsland**	**Geeste***
Niedersachsen	**Stade**	**Fredenbeck***
Niedersachsen	**Harburg**	**Tostedt***
Niedersachsen	**Oldenburg**	**Ganderkesee***
Mecklenburg-Vorpommern	**Vorpommern-Greifswald**	**Peenetal/Loitz***
Brandenburg	**Märkisch-Oderland**	**Letschin***
Niedersachsen	**Cloppenburg**	**Friesoythe***
Brandenburg	**Uckermark**	**Lychen***
Nordrhein-Westfalen	**Wesel**	**Kamp-Lintfort***
Niedersachsen	**Rotenburg (Wümme)**	**Selsingen***
Niedersachsen	**Vechta**	**Goldenstedt***
Thüringen	**Nordhausen**	**Ellrich***
Sachsen-Anhalt	**Mansfeld-Südharz**	**Goldene Aue***
Niedersachsen	**Emsland**	**Lengerich***
Niedersachsen	**Rotenburg (Wümme)**	**Bremervörde***

Shënim. Simboli (*****) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1113, datë 3.11.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 48, datë 22.9.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.9.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 48 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Astrit Meli

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Nikolin Kodhima, Bukurie Agaj, Meleqe Binaj, Gramoz Haxhiraj, në mungesë.

Barjam Meminaj, përfaqësuar nga avokate Majlinda Shehu, me prokurë.

Shoqëria "Çika" sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Fredi Xhoshi, me prokurë.

Shoqëria "Sevast" sh.p.k., në mungesë.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, në mungesë.

Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Vlorë, në mungesë.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, në mungesë.

OBJEKTI: Rihapja e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese.

Shfuqizimi i vendimit nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Astrit Melit, *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Barjam Meminaj, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë "Çika" sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim nga subjektet e interesuara, Nikolin Kodhima, Bukurie Agaj, Meleqe Binaj, Gramoz Haxhiraj, shoqëria "Sevast" sh.p.k., Agjencia e Trajtimit të Pronave *(ATP)*, Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Vlorë *(KRRT-ja, Vlorë)* dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë *(ZVRPP-ja, Vlorë)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Çështja në shqyrtim lidhet me një mosmarrëveshje pronësie për një sipërfaqe toke të ndodhur në qytetin e Vlorës, e cila, në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve (ligji nr. 7698, datë 15.4.1993), u është njohur dhe kthyer ish-pronarëve Kodhima, sikundër po ashtu ajo i është dhënë në pronësi, si kompensim fizik, edhe trashëgimtares së ish-pronarit J.B., subjektit të interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), ndërsa në vijim prona është tjetërsuar në favor të subjekteve të interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj (djali i shtetases Meleqe Binaj (Haxhiraj)) dhe, më tej akoma, për atë pronë është dhënë leje sheshi dhe ndërtimi për dy objekte 8 dhe 10 kate.

2. Për pronën si më lart, në vijim, kanë ngritur pretendime pronësie edhe shtetasi Xh.M., babai dhe njëherazi trashëgimlënësi i kërkuesit, sikundër edhe trashëgimtarët e M.M., një nga të cilët subjekti i interesuar Barjam Meminaj. Këta të fundit, pra babai i kërkuesit dhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, i janë drejtuar organit publik të ngarkuar nga ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 me kërkesa për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës, por kërkesat e tyre nuk janë pranuar dhe ata në vijim kanë paraqitur padi në gjykatë. Gjatë procesit gjyqësor, kur çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, babai i kërkuesit ka ndërruar jetë, duke u zëvendësuar në proces nga kërkuesi si trashëgimtar i tij, ndërsa është kërkuesi ai që ka ndjekur në vazhdim procedurat përkatëse deri më sot. Nisur nga kjo, në vijim të arsyetimit të këtij vendimi, me qëllim shmangien e përsëritjeve të panevojshme dhe në funksion të qartësisë së tij, edhe veprimet/mosveprimet e babait të kërkuesit dhe vendimet e dhëna për kërkesat e tij do të referohen si veprime/mosveprime të kërkuesit ose si vendime të dhëna për kërkesat e tij.

3. Më konkretisht, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Vlorës *(KKKP-ja e Bashkisë së Vlorës),* me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996 *(vendimi nr. 106/1996),* u ka njohur ish-pronarëve Kodhima, konkretisht shtetasve Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., të drejtën e pronësisë për truallin me sipërfaqe 21.392 m^2, të ndodhur në Vlorë, në lagjen "24 Maji", me kufij të përcaktuar dhe u ka kthyer në natyrë sipërfaqen 5.600 m^2. Nga ana tjetër, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Vlorë *(KKKP-ja e Këshillit të Rrethit Vlorë),* me vendimin nr. 352, datë 14.2.1997 *(vendimi nr. 352/1997),* i ka njohur ish-pronarit J.B. të drejtën e pronësisë për një sipërfaqe toke bujqësore në fshatin Sevaster, Vlorë dhe e ka kompensuar fizikisht trashëgimtaren e tij, subjektin e interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), me sipërfaqen 4.800 m^2, të ndodhur në qytetin e Vlorës, në lagjen "Çole", me kufij të përcaktuar.

4. Ndërsa gjatë procesit të regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme ka rezultuar se pronat e disponuara përmes këtyre vendimeve krijonin mbivendosje, subjekti i interesuar Meleqe Binaj (Haxhiraj), me deklaratën noteriale nr. 633/266, datë 1.3.2006, ka hequr dorë nga regjistrimi i pronës në favor të pronarëve Kodhima, duke mbetur vetëm formalisht në fuqi vendimi nr. 352/1997 i KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë.

5. Në vijim, pronarët Kodhima, shtetasit Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., të përfaqësuar me prokurë nga subjekti i interesuar Nikolin Kodhima, me kontratën noteriale të shitblerjes nr. 2556/889, datë 31.7.2006, u kanë shitur subjekteve të interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj një pjesë të pronës së njohur dhe kthyer me vendimin nr. 106/1996 të KKKP-së së Bashkisë së Vlorës, konkretisht sipërfaqen 2.949 m^2, e cila krijonte mbivendosje me pronën e trajtuar me vendimin nr. 352/1997 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë. Po në të njëjtën datë, me kontratën noteriale të shitblerjes nr. 2559/891, ata i kanë shitur subjektit të interesuar Bukurie Agaj edhe një pjesë tjetër të

pronës, sipërfaqen 2.371 m^2. Në datën 24.11.2008 për këtë truall është dhënë leja e sheshit të ndërtimit dhe në vijim, në datën 23.2.2009, edhe lejet e ndërtimit për dy objekte 8 dhe 10 kate për shoqëritë subjekte të interesuara.

6. Nga ana tjetër, kërkuesi, me pretendimin se ka qenë pronar i një sipërfaqeje toke prej 7 vretenësh në vendin e quajtur "Çole", me kufij të përcaktuar, e cila i është shpronësuar në vitin 1948, i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(AKKP)* (sot ATP-ja), Zyrës Rajonale Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e saj sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave (ligji nr. 9235, datë 29.7.2004). Po ashtu, kësaj zyre i është drejtuar edhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, me pretendimin se trashëgimlënësi i tij M.M. ka qenë pronar i një sipërfaqeje toke prej 4 vretenësh në lagjen "Çole", në vendin e quajtur "Kume", me kufij të përcaktuar, e cila i është shpronësuar pas vitit 1948. Këto kërkesa nuk janë pranuar nga Zyra Rajonale Vlorë me shkakun se prona e pretenduar ishte trajtuar më herët nga ish-KKKP-ja e Bashkisë Vlorë. Ankimet e paraqitura nga ata në vijim në Zyrën Qendrore të AKKP-së nuk janë shqyrtuar në afatin e parashikuar nga ligji.

7. Në këtë situatë, në datën 29.7.2008, me pretendimin se është pronar i tokës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar njohjen e tij pronar, anulimin e vendimeve të KKKP-ve respektive dhe pavlefshmërinë e të gjitha transaksioneve të bëra me pronën, krahas edhe anulimit të vendimeve për miratimin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit për atë pronë. Për të vërtetuar të drejtën e pronësisë ai ka paraqitur si provë një dokument arkivor të vitit 1946, që përcakton madhësinë e sipërfaqes prej 7 vretenësh, në vendin e quajtur "Çole", me kufij të përcaktuar të kohës. Sipas këtij dokumenti arkivor, mbi këtë sipërfaqe toke ndodhej edhe një ndërtesë me konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla dhe kjo pronë i është shpronësuar në vitin 1948. Sipas kërkuesit, mbi themelet e ndërtesës së vjetër, pas viteve `90, ai ka ndërtuar një ndërtesë tjetër, të cilën e përdor si punishte dhe që është në proces legalizimi. Në lidhje me ish-pronarët Kodhima, shtetasit Xh.K., E.K., S.K. dhe Xh.K., ai ka pretenduar se ata nuk ekzistojnë dhe ka qenë subjekti i interesuar Nikolin Kodhima dhe babai i tij (P.K.), ata që kanë falsifikuar dokumentet për të përfituar pronën në emër të tyre dhe për ta tjetërsuar atë më pas.

8. Gjatë gjykimit, në datën 21.5.2009, subjekti i interesuar Barjam Meminaj ka paraqitur kërkesë për ndërhyrje kryesore dhe në vijim një padi, duke kërkuar edhe ai njohjen pronarë të trashëgimtarëve të shtetasit M.M., babait të tij, krahas anulimit të vendimeve të KKKP-ve respektive dhe pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes, përveç edhe anulimin e vendimeve për leje sheshi dhe ndërtimi. Padia e ndërhyrësit kryesor është pranuar për shqyrtim në një gjykim të vetëm me padinë e kërkuesit.

9. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 580, datë 16.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: a) rrëzimin e padisë së kërkuesit si të pabazuar në prova; b) pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor Barjam Meminaj, duke: i. detyruar kërkuesin dhe të paditurit Bukurie Agaj, Gramoz Haxhiraj dhe Meleqe Binaj (Haxhiraj) të njohin trashëgimtarët e M.M. pronarë të truallit me sipërfaqe 4 vreten ose 4.800 m^2, të ndodhur në Vlorë, me kufij të përcaktuar; ii. shfuqizuar tërësisht vendimin nr. 106/1996 të KKKP-së së Bashkisë së Vlorës, si të dhënë në kundërshtim me ligjin; iii. anuluar vendimin nr. 352/1997 të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë; iv. konstatuar si të pavlefshme kontratat e shitblerjes nr. 2556/889 dhe nr. 2559/891, datë 31.7.2006 dhe urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme; v. detyruar ZVRPP-në, Vlorë të çregjistrojë pasurinë në emër të të paditurve; vi. anuluar vendimin për miratimin e sheshit të ndërtimit për truallin objekt konflikti dhe lejet e ndërtimit për të dyja objektet 8 dhe10 kate.

10. Mbi ankimin edhe të kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 390, datë 23.4.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs disa nga palët, përfshirë edhe kërkuesi, ndërkohë që ndërhyrësi kryesor ka paraqitur kundërrekurs.

11. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, me vendimin nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekurset e paraqitura nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij.

12. Vendimet e dhëna në këtë proces gjyqësor janë kundërshtuar me ankim kushtetues individual

nga kërkuesi dhe nga subjekti i interesuar Nikolin Kodhima. Për ankimin e këtij të fundit, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata),* me vendimin nr. 289, datë 20.12.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

13. Ndërkohë, ankimi individual i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata në seancë plenare mbi bazë dokumentesh dhe në përfundim, me vendimin nr. 12, datë 9.3.2021 *(vendimi nr. 12/2021),* është vendosur rrëzimi i kërkesës së tij.

14. Referuar arsyetimit të vendimit, Gjykata nuk e ka legjitimuar kërkuesin në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit* për argumentin e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, me arsyetimin se nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak për mbrojtjen e saj. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se për pretendimin e cenimit të *parimit të paanshmërisë në gjykim* kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndërsa për pretendimin e cenimit të *së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit,* vetëm në lidhje me argumentin se gjykata e apelit ka shtyrë shpalljen e vendimit, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë pasojat e ardhura dhe cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

15. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi legjitimohet për pretendimet e tjera, duke i shqyrtuar në themel ato. Kështu, për pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykim, të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim* (për argumentet e tjera), si dhe të *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj,* Gjykata ka arritur në përfundimin se ato janë të pabazuara. Kurse për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* dhe të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* nuk është arritur shumica e nevojshme e votave prej 5 gjyqtarësh për bazueshmërinë ose jo në themel të tyre dhe Gjykata ka vlerësuar se kërkesa për këto pretendime konsiderohet e rrëzuar referuar nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

16. Në datën 30.7.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) *(aplikimi nr. 41373/21 Astrit Meli kundër Shqipërisë)* për shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), duke pretenduar mohimin e aksesit në Gjykatë, mosdhënien e vendimit të arsyetuar nga ajo gjykatë për shkak të rrëzimit të ankimit kushtetues, sepse nuk u arrit shumica e ligjshme prej pesë gjyqtarësh, për mungesën e arsyetimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta, barazinë e armëve dhe kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës *(shih paragrafin 1 të vendimit të GJEDNJ-së).* Me vendimin e datës 16.7.2024, në dispozitivin e tij, GJEDNJ-ja ka shpallur të papranueshëm ankimin e kërkuesit për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka vendosur, se: i. nuk ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës për mungesën e pretenduar të aksesit në Gjykatën Kushtetuese; ii. ka shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës për të drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata; iii. nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e tjera sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

17. Referuar arsyetimit të vendimit, GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje për të drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata, pasi kjo e fundit, për shkeljet e pretenduara të barazisë së armëve dhe për një vendim gjyqësor të arsyetuar, në vendimin e saj është kufizuar me vënien në dukje të rezultatit të votimit dhe rezultatit përfundimtar, përfshirë një të dhënë të shkurtër në shënimin fundor për mënyrën e votimit nga secili gjyqtar, por duke mos dhënë arsye për themelin e çështjes dhe për mendimet e shumicës efektive (pra, gjyqtarët që votuan për të refuzuar ankimet) ose ato të pakicës efektive (gjyqtarët që votuan në favor të pranimit të ankimeve), pra duke mos dhënë arsyet dhe shkaqet thelbësore mbi të cilat ajo gjykatë kishte dalë në ato konkluzione *(shih paragrafët 12-13 dhe 68-76 të vendimit të GJEDNJ-së).*

18. Në lidhje me korrigjimin e shkeljes së konstatuar, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se nisur nga natyra e ankimit të kërkuesit dhe e shkeljes së gjetur, forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për atë shkelje do të ishte rihapja e procesit gjyqësor të brendshëm, duke evidentuar në këtë drejtim parashikimin e nenit 71(c) të ligjit për Gjykatën *(shih paragrafin 83 të vendimit të GJEDNJ-së).* Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte në atë moment pretendimet e kërkuesit për arsyetimin e vendimit nga gjykatat e zakonshme dhe për shkeljen e pretenduar të barazisë së armëve, duke pasur parasysh gjetjen e saj në lidhje me shkeljen e së drejtës së kërkuesit për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, pasi kërkuesi tani ka mundësi të kërkojë rihapjen e

procesit përpara Gjykatës Kushtetuese, e cila aktualisht ka trupë gjyqësore të plotë me nëntë gjyqtarë dhe në parim kjo mundëson shqyrtimin e kësaj pjese të ankimit të kërkuesit përmes një vendimi të arsyetuar si duhet të kësaj gjykate, duke qenë e hapur në vijim për të mundësia për të depozituar kërkesë të re përpara saj, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin e tij kushtetues në nivel kombëtar *(shih paragrafët 77-78 të vendimit të GJEDNJ-së).*

19. Vendimi i GJEDNJ-së, pasi është bërë përfundimtar, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 12.11.2024.

20. Në datën 16.12.2024, bazuar në nenin 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit të përfunduar me vendimin nr. 12/2021 të Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi dhe të vendimeve gjyqësore sipas objektit të saj. Kolegji i Gjykatës në datën 12.2.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen si subjekte të interesuara të palëve në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat në vijim janë njoftuar rregullisht, duke u ftuar për të paraqitur parashtrimet e tyre në lidhje me kërkesën e kërkuesit.

21. Në këtë kuadër, subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k., në parashtrimet e dërguara përmes shërbimit postar në datën 31.3.2025, ka kundërshtuar procesin gjyqësor objekt i ankimit kushtetues, duke ngritur pretendime për cenimin asaj, por edhe të personave të tjerë jo palë në gjykim, të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret në lidhje me ankimin kushtetues individual të kërkuesit, si dhe në situatën kur ky subjekt i interesuar edhe pse ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt i këtij gjykimi, nuk i është drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e tij me ankim kushtetues individual për sa procesi gjyqësor dhe rezultati i tij mund të kenë prekur interesat e tij, pretendimet dhe kërkimet ngushtësisht personale të paraqitura nga ky subjekt, për aq sa ato nuk lidhen dhe as kontribuojnë për çështjen në këtë gjykim, nuk u morën në konsideratë.

22. Po ashtu, ndonëse afati i caktuar nga Gjykata ka qenë deri në datën 31.3.2025, subjekti i interesuar Nikolin Kodhima, përfaqësuesi me prokurë i tij, parashtrimet me shkrim i ka depozituar në datën 16.9.2025, ditën e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, ndërsa seanca për më tepër kishte përfunduar. Për këtë shkak, në zbatim të nenit 38, pika 6, të ligjit nr. 8577/2000, parashtrimet e subjektit të interesuar në fjalë nuk u bënë pjesë e shqyrtimit nga Gjykata dhe ato iu kthyen atij pa veprim.

II. Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

23. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

a) Për kërkesën për rihapjen e procesit:

23.1. Kërkesa plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 71/c, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000, pasi është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga hyrja në fuqi e vendimit të GJEDNJ-së, referuar datës së botimit të tij në Fletoren Zyrtare, ajo përmban një përmbledhje të vendimit të GJEDNJ-së me çështjet kryesore të trajtuara dhe kërkuesi ka kërkuar shprehimisht rihapjen e procesit në Gjykatë, sikurse GJEDNJ-ja ka përcaktuar në vendimin e saj, ndërkohë që nuk mund të zbatohen parashikimet e pikës 5 të kësaj dispozite të ligjit, sepse është vetë GJEDNJ-ja që ka deleguar, sipas parimit të subsidiaritetit, shqyrtimin në themel nga Gjykata të pretendimeve substanciale të kërkuesit për gjykatat e zakonshme, thelbi i të cilave lidhet me cenimin e së drejtës së pronës private për shkak të shkeljeve të kryera nga gjykatat e zakonshme në gjykimin e çështjes së tij. Duke pasur parasysh se GJEDNJ-ja jo vetëm ka gjetur shkelje në procesin e zhvilluar nga Gjykata, por është shprehur se i takon kësaj të fundit të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për vendimet gjyqësore objekt kërkese, kërkohet që çështja të shqyrtohet sërish për pretendimet e ngritura në kërkesën e gjykuar me vendimin nr. 12/2021, që është gjetur nga GJEDNJ-ja si i papajtueshëm me KEDNJ-në.

b) Për themelin e çështjes:

23.2. Duke pasur parasysh se GJEDNJ-ja jo vetëm ka gjetur shkelje në procesin e zhvilluar nga Gjykata, por është shprehur se i takon kësaj të fundit të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit për vendimet gjyqësore objekt kërkese, duke iu përmbajtur të njëjtave pretendime dhe shkaqe të parashtruara në kërkesën e parë për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

23.2.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë,* pasi gjykatat e faktit, pa e hetuar, kanë rrëzuar padinë e kërkuesit, me arsyetimin se i mungon legjitimimi aktiv dhe se

dokumenti arkivor i paraqitur nga ai nuk përbën provë për ta legjitimuar atë. Ky qëndrim është i gabuar, pasi legjitimimi aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, e cila lidhet me shqyrtimin në themel të saj, gjë e cila nuk ka ndodhur.

23.2.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhdonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

23.2.3. *Parimit të paanshmërisë në gjykim,* pasi gjyqtari H.S., i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka marrë pjesë më parë edhe në dhënien e një vendimi për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të një personi tjetër, ku është pranuar se prona e kërkuesit gjendet në vendin e pretenduar në padinë në shqyrtim, por megjithatë në rastin konkret ai gjyqtar është shprehur se paditësi nuk provoi ku gjendej prona e tij.

23.2.4. *Së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim,* pasi ndërgjyqësia nuk është ndërtuar drejt dhe në gjykim nuk janë thirrur si palë personat që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konflikti. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë dhe nuk ka vijuar me njoftimin e palëve që nuk kanë qenë të pranishme kur janë shtyrë seancat gjyqësore. Për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit gjykata e apelit duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të KPC-së.

23.2.5. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me atë të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti, pa marrë dhe administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime, ndërkohë që nuk është në misionin e ekspertit të vlerësojë provat ku palët mbështesin pretendimet e tyre. Kërkuesi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij, për më tepër kur ekspertimi, i cili ka qenë prova e vetme dhe vendimtare ku gjykatat janë mbështetur për dhënien e vendimeve, ka qenë i paplotë dhe i pasaktë. Gjykatat, qoftë edhe kryesisht, përballë pretendimeve të palëve dhe kontradiktave të dokumenteve shkresore, në zbatim të nenit 224 të KPC-së, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna për akte e dokumente që ishin të nevojshme për gjykimin. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët, ku në vlerësim të provave të paraqitura dhe në përgjigje të kërkesave të tyre, ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e vjetër të paditësit, vendndodhjen e saj, por edhe të palëve të tjera në gjykim, e më pas të konkludonin. Vetëm nëse do të pranonin kërkesën për riekspertim, gjykatat do t'u krijonin mundësi kërkuesit, ashtu dhe subjekteve të interesuara për të pasur mjetet provuese të nevojshme për pretendimet e tyre. Duke mos administruar në gjykim një provë thelbësore, e cila mund të sigurohej vetëm prej tyre, si dhe duke mos i dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me këto prova, gjykatat nuk kanë respektuar parimin e barazisë së armëve.

23.2.6. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm,* pasi gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, sepse ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.3.2012, por e ka vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura.

23.2.7. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi arsyetimi i vendimeve nga gjykatat e faktit është i mangët, përveçse alogjik dhe ato nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit. Gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, i cili nuk ka arritur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit, në një kohë kur eksperti, nga ana tjetër, ka arritur të përcaktojë me saktësi vendndodhjen e pronës së ndërhyrësit kryesor, megjithëse prona e këtij të fundit, sipas dokumenteve të vjetra, ka kufij tokësorë dhe kufitarë të përcaktuar, por jo moçal dhe kënetë, sikurse kufizohej pjesërisht prona e kërkuesit sipas dokumenteve të vjetra. Për sa kohë eksperti i thirrur në gjykim nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit, gjykatat duhet të kërkonin mendimin e një eksperti tjetër. Kjo vendndodhje do të përcaktohej lehtësisht nga ekspertë me njohuri të posaçme, pasi pas shtetëzimit në vitin 1948, kërkuesit (babait të tij) i është lënë në pronësi sipërfaqja prej 1 vretenësh, ku aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit, lehtësisht e verifikueshme në planshetat ndër vite, shtëpi kjo e

transkriptuar më pas familjes P. dhe e regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 275 të vitit 1942, fakt ky që është anashkaluar nga gjykatat, pa hetuar për gjendjen juridike të shtëpisë, kufijtë e saj të kohës dhe kufitarët përkatës, ku një pjesë e tyre ndodhen në kufijtë e kësaj prone. Gjykatat janë shprehur se kërkuesit i mungon legjitimimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për ta legjitimuar atë, ndërkohë që dokumentin arkivor për pronën e ndërhyrësit kryesor e konsideron si provë për legjitimimin e tij. Ato kanë anashkaluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se i padituri Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimit objekt padie që lidhet me kthimin e pronës. Po ashtu, ndonëse kanë konstatuar pavlefshmërinë e kontratave të shitblerjes dhe kanë anuluar aktet administrative objekt gjykimi, gjykatat nuk kanë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë, pra mosmarrëveshjen në gjykim, duke krijuar kështu një konflikt të ri, ndërsa mbi truallin objekt gjykimi ka dy pallate shumëkatëshe. Pavarësisht shkeljeve të lejuara gjatë procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë i ka legjitimuar ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit. Në shtesë të këtyre, në kërkesën për rihapjen e procesit, parashtrohet edhe se gjykatat kanë legjitimuar ndërhyrësin kryesor edhe me arsyetimin se pretendimi i tij mbështetet edhe në dokumentet e kufitarëve, megjithëse ato dokumente flasin për prona që ndodhen në vende të tjera, të ndryshme nga ajo objekt gjykimi. Gjykatat, po ashtu, nuk kanë arsyetuar edhe për faktin se ndërhyrësi kryesor përpara komisionit të pronave ka pretenduar se është kufitar me Gj.E. dhe S.K., për të cilët prokuroria ka verifikuar se nuk ekzistojnë.

24. ***Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj***, në mënyrë të përmbledhur, ka paraqitur prapësime vetëm për themelin e çështjes, duke parashtruar si vijon:

24.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit nuk qëndron, pasi kërkuesi ka ushtruar të drejtën e padisë dhe gjykatat janë shprehur me vendim përfundimtar në lidhje me të, sikundër u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të tij, pavarësisht se ato nuk janë parashtruar nëpërmjet mjeteve procedurale në formën e kërkuar dhe sipas afateve ligjore. Në ankimin përpara gjykatës së apelit kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për ekspertin e caktuar nga gjykata e shkallës së parë dhe pavarësisht se ai nuk kishte ngritur pretendime të tilla dhe as kishte kërkuar përjashtimin e tij në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, gjykata e apelit i ka shqyrtuar dhe u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, duke arsyetuar se fakti se eksperti ka arritur në përfundimin se dokumenti arkivor i kërkuesit nuk shoqërohet me hartë (skicë) dhe nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, nuk dëshmon për pamjaftueshmëri të njohurive të posaçme ose për paaftësi profesionale të ekspertit. Po ashtu, pavarësisht pretendimeve për ekspertimin, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose raport alternativ në mbështetje të tyre dhe të kërkesës për një ekspertim të ri, fakt që është evidentuar edhe nga GJEDNJ-ja në paragrafin 9 të vendimit të saj.

24.2. Nuk qëndron as pretendimi i kërkuesit në lidhje me parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kërkuesi keqinterpreton ligjin dhe aktet e dosjes gjyqësore, sikundër me të drejtë ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, kur edhe pse janë ndryshuar dy anëtarë të trupit gjykues, zëvendësimi i tyre është bërë në kohë të ndryshme e jo në të njëjtën seancë gjyqësore, përveçse nga ana e gjyqtarëve është deklaruar vazhdimi i gjykimit pas njohjes së tyre me përmbajtjen e procesit gjyqësor.

24.3. Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë për sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit H.S. në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, për sa kohë një pretendim të tillë ai nuk e ka ngritur më parë në instancat e zakonshme, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

24.4. Pretendimi i kërkuesit në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim është i pabazuar. Ai ka ngritur pretendime edhe për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë dhe për mosrespektimin e rregullave të njoftimit për palët në mungesë, për të cilat jo vetëm ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme, por ai nuk legjitimohet në ngritjen e tyre për sa kohë ato nuk lidhen me të drejtat e tij, por të personave të tretë. Lidhur me pretendimet e kërkuesit për ekspertimin, sikurse u parashtrua, ato janë marrë në shqyrtim dhe gjykata e apelit u ka kthyer përgjigje. Eksperti ka pasur njohuri të posaçme dhe në përmbushje të detyrës ka dhënë mendimin e tij, ndërkohë që kërkuesi nuk ka dhënë asnjë arsye bindëse përpara gjykatës së apelit se përse duhej të bëhej një ekspertim i ri referuar nenit 229 të KPC-së, duke marrë përgjigje për kërkesën për

riekspertim. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk parashtron fakte konkrete për kërkesat që pretendon të ketë paraqitur dhe që nuk janë pranuar nga gjykatat, qoftë për marrje të provave shkresore, ashtu edhe ato me dëshmitarë. Po ashtu, ai nuk ka treguar ndonjë akt shkresor, të cilin gjykatat duhet ta kishin kërkuar, qoftë edhe kryesisht. Pra, është i pabazuar pretendimi i tij për mungesë hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm.

24.5. Nuk qëndron as pretendimi i kërkuesit në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Ky pretendim, përveçse kontradiktor, nuk është ngritur në nivel kushtetues, duke mos provuar kërkuesi ndonjë pasojë të ardhur në të drejtën e pretenduar si të cenuar. Ndryshe nga sa ai pretendon, çështja jo vetëm ishte komplekse, por gjykata e apelit, nisur nga pretendimet e palëve, ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke ia nënshtruar debatit provat e paraqitura nga të paditurit.

24.6. Edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk qëndron dhe për këtë vlejnë argumentet e parashtruara edhe për pretendimin tjetër të tij për të drejtën e aksesit. Për sa i përket faktit të dënimit penal të të paditurit, subjektit të interesuar Nikolin Kodhima, gjykatat kanë hetuar dhe kanë arsyetuar për paligjshmërinë e vendimit të komisionit të pronave të dhënë në favor të ish-pronarëve Kodhima dhe të veprimeve juridike të kryera më pas. Për më tepër që kërkuesi nuk ka ngritur pretendime në këtë drejtim as në ankimin përpara gjykatës së apelit, as në rekursin në Gjykatën e Lartë. Ai, po ashtu, nuk ka paraqitur asnjë provë shtesë për vendndodhjen e pronës në vendin e pretenduar, çka evidentohet dukshëm edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës, ku nuk tregohet asnjë provë konkrete, e cila duhet të ishte dhe nuk është administruar nga gjykatat. Është i pabazuar pretendimi në lidhje me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe anulimin e akteve administrative, pasi gjykatat i kanë zgjidhur ato në përputhje me ligjin, për më tepër që kërkimet në këtë drejtim kanë qenë edhe të tijat (ndërhyrësit kryesor) dhe për sa kërkuesi pretendon ato nuk lidhen me cenimin atij të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

24.7. Pretendimet e parashtruara nga subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k, janë të pabazuara dhe kontradiktore, pasi, nga njëra anë, mbështesin kërkuesin që proceduralisht konsiderohet palë kundërshtare në procesin gjyqësor, ndërsa, nga ana tjetër, parashtrojnë argumente në mbështetje të lejes së ndërtimit (sipas kontratës së sipërmarrjes për ndërtim të lidhur me familjen Kodhima) dhënë në favor të kësaj shoqërie, mbi një pasuri, e cila, sipas hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit, ka rezultuar se ishte përfituar nga persona inekzistentë dhe mbi dokumente të falsifikuara, ndërsa vendimi i KKKP-së është shfuqizuar. Shoqëria në fjalë nuk ka paraqitur asnjë argument për shkeljen asaj të të drejtave kushtetuese, për më tepër kur ajo nuk ka paraqitur më parë as ankim kushtetues individual.

25. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k.,*** në mënyrë të përmbledhur, ka paraqitur prapësime vetëm për themelin e çështjes, duke parashtruar si vijon:

25.1. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit qëndron, pasi gjykatat, pa hetuar, kanë rrëzuar padinë e tij, me arsyetimin se i mungon legjitimiteti aktiv në ngritjen e saj, pra pa e shqyrtuar atë në themel. Po ashtu, gjykatat nuk kanë shqyrtuar në themel as pretendimet e saj (shoqërisë "Çika" sh.p.k.) për cenimin e të drejtave nga shfuqizimi i akteve administrative, lejes së ndërtimit. Marrja e masës së sigurimit nga gjykata, në shkelje të ligjit dhe në mungesë të shoqërisë, përbën shkelje të rëndë të rregullave për formimin e ndërgjyqësisë. Të tria shkallët e gjykimit nuk e kanë gjykuar në themel çështjen, sepse nuk janë bazuar në dokumentet arkivore që disponoheshin nga palët dhe vendndodhja e pronës, sipas dokumenteve arkivore, është zhvendosur, pra prona e ndërhyrësit kryesor nuk është aty ku pretendohet dhe për këtë nuk ka pasur një hetim gjyqësor të plotë e të gjithanshëm. Harta topografike e paraqitur në gjykim nuk paraqet realitetin, sepse është ndryshuar në mënyrë të padrejtë.

25.2. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj qëndron, pasi gjatë gjykimit në shkallë të parë është bërë zëvendësimi i dy gjyqtarëve të trupit gjykues, duke u lejuar kështu shkelje e rëndë procedurale në lidhje me vazhdimin e procesit aty ku ishte lënë para zëvendësimit të gjyqtarëve njëri pas tjetrit, ndërkohë që gjykimi i çështjes duhet të fillonte nga fillimi sipas parashikimit të nenit 181 të KPC-së. Kjo shkelje nuk u mor parasysh as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë.

25.3. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim është i bazuar, pasi

Gjykata e Lartë, si një gjykatë ligji, kishte detyrimin që në bazë të fakteve të çështjes të përcaktonte se cilat ishin normat ligjore të zbatuara gabim. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur dhe ajo gjykatë ka legjitimuar shkeljet e kryera nga gjykatat e faktit. Edhe pse pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është ngritur në seancë gjyqësore nga kërkuesi dhe shoqëria "Çika" sh.p.k., ai nuk u mor parasysh nga Gjykata e Lartë dhe ajo nuk u shpreh në lidhje me të.

25.4. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim qëndron, pasi gjykatat e të tria shkallëve kanë lejuar shkelje procedurale në lidhje me formimin e drejtë të ndërgjyqësisë, sepse në gjykim nuk janë thirrur palë që tërheqin të drejta mbi truallin objekt konflikti. Po ashtu, gjykatat nuk kanë administruar provat përkatëse që mund të silleshin nga palët, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve për provat, qoftë të kërkuesit, ashtu edhe të shoqërisë "Çika" sh.p.k.

III . Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për rihapjen e procesit

26. Gjykata vëren se referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, nëse ajo ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

27. Gjykata thekson se çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues, duke mos përjashtuar edhe rastin e rihapjes së procesit sipas nenit 71/c të ligjit nr. 8577/2000. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës për rihapje të procesit në këtë Gjykatë, sikurse të ankimit kushtetues individual, janë të natyrës kumulative, pra ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Prandaj, në vijim, Gjykata do të analizojë nëse kriteret ligjore të lartpërmendura plotësohen në rastin në shqyrtim.

28. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës për rihapjen e procesit, pasi ka qenë palë në procesin kushtetues, vendimin nr. 12/2021 të të cilit e ka ankimuar përpara GJEDNJ-së. Kjo e fundit, me vendimin e datës 16.7.2024, pasi ka konstatuar shkeljen e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së të lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata, për sa u përket dy prej pretendimeve të tij, atyre për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka vlerësuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës, ndërsa trupa e saj tashmë është plotësuar dhe është i mundur shqyrtimi i atyre pretendimeve të kërkuesit përmes një vendimi të arsyetuar siç duhet.

29. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis,* në rastin e kërkesave për rihapjen e procesit, Gjykata ka pohuar se llogaritja e afatit ligjor 4-mujor fillon nga hyrja në fuqi i vendimit të gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 *(shih vendimin nr. 67, datë 3.10.2024, të Gjykatës Kushtetuese).* Në rastin konkret, vendimi i GJEDNJ-së për çështjen Meli kundër Shqipërisë është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 12.11.2024 dhe kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit në datën 16.12.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi e përmbush edhe kriterin *ratione temporis.*

30. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata evidenton se në rastet e rihapjes së procesit, kufijtë e shqyrtimit të çështjes përcaktohen nga shkaku i rihapjes. Kjo do të thotë që kur shkaku i rihapjes së procesit ka të bëjë me një shkelje, e cila prek vetëm një pjesë të vendimit të dhënë, atëherë procesi rihapet vetëm për atë pjesë. Nga ana tjetër, në rastet e rihapjes së procesit, kërkuesi nuk mund të zgjerojë shkaqet e ankimit kushtetues fillestar dhe as të shtojë argumente të tjera në lidhje me to. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se kërkuesi në kërkesën për rihapjen e procesit përpara saj, ashtu si dhe në ankimin fillestar drejtuar asaj ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte të tij, përfshirë edhe për sa i përket parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për të cilat Gjykata, në vendimin e saj nr. 12/2021, ka pranuar se bëjnë pjesë në juridiksionin

kushtetues dhe se ankuesi plotëson kriteret paraprake të legjitimimit.

31. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit për rihapjen e procesit është e bazuar dhe duhet të pranohet, duke shfuqizuar vendimin e saj nr. 12/2021 vetëm për atë pjesë të tij, për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje nga ana e saj (Gjykatës), pra vetëm për sa Gjykata ka disponuar për rrëzimin e kërkesës (ankimit kushtetues fillestar) në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për pretendimet e tjera të kërkuesit, për të cilat GJEDNJ-ja nuk ka konstatuar shkelje nga ana e Gjykatës, ato nuk mund të rimerren në shqyrtim për sa kohë Gjykata është shprehur me vendim në lidhje me to, vendim i cili për këtë pjesë ka natyrë përfundimtare *(res judicata),* ndaj këto pretendime nuk mund t'i nënshtrohen sërish kontrollit kushtetues. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të GJEDNJ-së, e përcaktuar në nenin 46 të KEDNJ-së, detyrimi që lind në kuadër të zbatimit të vendimit të asaj gjykate në rastin konkret, konsiston vetëm në shqyrtimin e këtyre dy pretendimeve të kërkuesit, shqyrtim i cili përmbush detyrimet që rrjedhin nga Konventa për korrigjimin e shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ-ja.

32. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të parashtruara në kërkesën fillestare dhe të përsëritura edhe në kërkesën për rihapjen e procesit drejtuar asaj. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se disa nga argumentet e kërkuesit në lidhje me standardin e arsyetimit kanë të bëjnë, në thelb, me parimin e barazisë së armëve, ndaj do të trajtohen në këtë aspekt. Po ashtu, Gjykata çmon të evidentojë se në kërkesën për rihapjen e procesit gjyqësor, në lidhje me pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në shtesë të argumenteve në ankimin kushtetues fillestar, kërkuesi ka parashtruar edhe se gjykatat e zakonshme kanë legjitimuar ndërhyrësin kryesor edhe me arsyetimin se pretendimi i tij mbështetet edhe në dokumentet e kufitarëve, megjithëse ato dokumente flasin për prona që ndodhen në vende të tjera, të ndryshme nga ai objekt gjykimi, përveçse po ashtu ato nuk kanë arsyetuar edhe për faktin se ndërhyrësi kryesor përpara komisionit të pronave ka pretenduar se është kufitar me Gj.E. dhe S.K., për të cilët prokuroria ka verifikuar se nuk ekzistojnë. Në lidhje me këto argumente, Gjykata vëren se ato nuk ka qenë pjesë e ankimit kushtetues fillestar, prandaj pretendimi i kërkuesit për këto argumente nuk mund të merret në shqyrtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të barazisë së armëve

33. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë ngatërruar rolin e tyre me të ekspertit, për sa kohë vendimet e tyre i kanë mbështetur në konstatimet e ekspertit, pa administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime, ndërkohë që nuk është në misionin e ekspertit të vlerësojë provat ku palët mbështesin pretendimet e tyre. Sipas tij, ai është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e kërkuesit për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij, për më tepër kur ekspertimi, i cili ka qenë prova e vetme dhe vendimtare ku gjykatat janë mbështetur për dhënien e vendimeve, është i paplotë dhe i pasaktë. Gjykatat, vijon kërkuesi, qoftë edhe kryesisht, përballë pretendimeve të palëve dhe kontradiktave të dokumenteve shkresore, në zbatim të nenit 224 të KPC-së, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna për akte e dokumente që ishin të nevojshme për gjykimin. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët, ku në vlerësim të provave të paraqitura dhe në përgjigje të kërkesave të tyre, ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e vjetër të kërkuesit (babait të tij), vendndodhjen e saj, por edhe të palëve të tjera në gjykim, e më pas të konkludonte. Sipas kërkuesit, për sa kohë eksperti i thirrur në gjykim nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, gjykatat duhej të kërkonin mendimin e ekspertëve të tjerë me njohuri të posaçme dhe vendndodhja e pronës do të përcaktohej lehtësisht nisur nga fakti se pas shtetëzimit në vitin 1948, babait të tij i është lënë në pronësi sipërfaqja prej 1 vretenësh, ku aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit, lehtësisht e verifikueshme në planshetat ndër vite, shtëpi kjo e transkriptuar më pas familjes P. dhe e regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 275 të vitit 1942, çka është anashkaluar nga gjykatat, pa hetuar për gjendjen juridike të shtëpisë, kufijtë e saj të kohës

dhe kufitarët përkatës, ku një pjesë e tyre ndodhen në kufijtë e kësaj prone. Vetëm nëse do të pranonin kërkesën për riekspertim, sipas nenit 229 të KPC-së, gjykatat do t'i krijonin mundësi kërkuesit për të pasur mjetet provuese të nevojshme për pretendimet e tij. Duke mos administruar në gjykim një provë thelbësore, e cila mund të sigurohej vetëm nga ato, si dhe duke mos i dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me këto prova, gjykatat nuk kanë respektuar parimin e barazisë së armëve.

34. Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit për ekspertimin, pavarësisht se ai nuk i ka ngritur ato në gjykimin në shkallë të parë dhe as ka kërkuar përjashtimin e ekspertit, janë marrë në shqyrtim dhe gjykata e apelit u ka kthyer përgjigje, duke arsyetuar se fakti se eksperti ka arritur në përfundimin se dokumenti arkivor i paditësit nuk shoqërohet me hartë (skicë) dhe nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, nuk dëshmon për pamjaftueshmëri të njohurive të posaçme ose për paaftësi profesionale të ekspertit. Po ashtu, vijon subjekti i interesuar, pavarësisht pretendimeve për ekspertimin, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose raport alternativ në mbështetje të tyre dhe të kërkesës për një ekspertim të ri, fakt që është evidentuar edhe nga GJEDNJ-ja në paragrafin 9 të vendimit të saj. Edhe në ankimin e tij kushtetues kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë shtesë për vendndodhjen e pronës së pretenduar, e cila duhet të ishte dhe nuk është administruar nga gjykatat. Po sipas subjektit të interesuar, kërkuesi nuk parashtron fakte konkrete për kërkesat që pretendon të ketë paraqitur dhe që nuk janë pranuar nga gjykatat, qoftë për marrje të provave shkresore, ashtu edhe ato me dëshmitarë. Po ashtu, ai nuk ka treguar ndonjë akt shkresor, të cilin gjykatat duhet ta kishin kërkuar, qoftë edhe kryesisht, duke qenë i pabazuar pretendimi i tij për mungesë hetimi gjyqësor të plotë e të gjithanshëm.

35. Subjekti i interesuar, shoqëria "Çika" sh.p.k., duke mbështetur pretendimin e kërkuesit, ka parashtruar se gjykatat nuk kanë administruar provat përkatëse që mund të silleshin nga palët dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në lidhje me provat.

36. Për sa i takon parimit të barazisë së armëve, Gjykata është shprehur se ai nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 21, datë 20.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

37. Mbi bazën e këtyre standardeve dhe nisur nga pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse atij i janë krijuar mundësi të barabarta për paraqitjen e provave, si dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen.

38. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton fillimisht se kërkuesi është përfaqësuar me avokatë në të gjitha shkallët e gjykimit. Në gjykimin e çështjes në shkallë të parë ai ka parashtruar kërkesa për marrjen e provave shkresore, të cilat janë pranuar nga gjykata dhe ajo ia ka nënshtruar shqyrtimit gjyqësor të gjitha provat e paraqitura nga ai. Nuk konstatohet që ajo gjykatë të ketë refuzuar ndonjë kërkesë të tij për marrje të provës, me përjashtim të asaj që konsistonte në marrjen nga gjykata të akteve të dosjes penale në ngarkim të të paditurit, subjektit të interesuar Nikolin Kodhima dhe të akteve të dosjes së AKKP-së që i përkiste ndërhyrësit kryesor Barjam Meminaj. Për këtë kërkesë, ajo gjykatë, me vendim të ndërmjetëm të datës 25.11.2009, është shprehur se kërkuesi duhej t'u drejtohej më parë atyre organeve dhe nëse ato nuk ia vinin në dispozicion aktet e kërkuara, mund t'i kërkonte gjykatës marrjen e tyre. Pas kësaj kërkuesi nuk i ka parashtruar gjykatës ndonjë kërkesë tjetër në këtë drejtim.

39. Në lidhje me provën e ekspertimit topografik, Gjykata konstaton se ajo është marrë nga gjykata e shkallës së parë mbi kërkesën e ndërhyrësit kryesor, subjektit të interesuar Barjam Meminaj. Për ekspertin e caktuar nga gjykata, asnjë nga palët fillimisht nuk ka ngritur pretendime, ndërkohë që

kërkuesi është shprehur kundër edhe një kërkese të bërë në vijim të gjykimit nga një prej të paditurve, për përjashtimin e ekspertit dhe që motivohej mbi pretendime rreth përmbushjes së detyrës nga ai. Për sa u përket detyrave të ekspertimit, kërkuesi ka kërkuar që eksperti të aplikonte (përcaktonte) në terren vetëm pronën e palës kundërshtare (ndërhyrësit kryesor), sipas dokumentit arkivor të saj. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e palëve të tjera, gjykata i ka caktuar ekspertit edhe një tërësi detyrash të tjera që konsistonin në aplikimin në terren të pronës për të gjitha palët ndërgjyqëse, sipas dokumentacionit të paraqitur nga ato. Përpara përgatitjes së aktit të ekspertimit, eksperti ka parashtruar në gjykim se nuk mund të aplikonte në terren pronat e palëve ndërgjyqëse bazuar vetëm në ato dokumente që ato kishin depozituar deri në atë kohë, ndaj nevojiteshin dokumente të tjera shtesë. Kërkuesi ka kërkuar kohë për paraqitjen e provave të tjera, megjithatë ai në vijim nuk ka paraqitur të tilla dhe eksperti ka përgatitur aktin e ekspertimit të datës 21.10.2009. Pas kësaj, kërkuesi ka paraqitur disa prova shkresore, të cilat, sipas tij, bënin fjalë për pronën e kufitarit. Ato prova janë pranuar nga gjykata, e cila ka urdhëruar ekspertin të plotësojë aktin e ekspertimit dhe ai në vijim ka përgatitur aktin e ekspertimit shtesë të datës 17.11.2009.

40. Gjatë debatit gjyqësor për aktin e ekspertimit topografik, në seancën gjyqësore të datës 25.11.2009 kërkuesi ka shprehur kundërshtime për përfundimet e ekspertimit vetëm në lidhje me aplikimin në terren të pronës së palës kundërshtare, të ndërhyrësit kryesor Meminaj dhe të pronës së familjes Kodhima, ndërkohë që nuk ka pasur pyetje për ekspertin. Nga ana tjetër, eksperti u ka dhënë përgjigje me shkrim pyetjeve të palëve të tjera. Pas kësaj, kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë koment ose kërkesë në lidhje me ekspertimin, ndërsa në seancën gjyqësore të datës 4.3.2010 ka kërkuar dhënien fund të shqyrtimit gjyqësor. Edhe në pretendimet përfundimtare me shkrim ai nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje ose objeksion, qoftë në lidhje me procesin gjyqësor dhe respektimin e të drejtave të tij procedurale, ashtu edhe për përfundimet e ekspertimit topografik, të cilave as nuk iu është referuar. Duke konsideruar të provuar pronësinë e tij mbi pronën objekt gjykimi, në bazë të dokumentit arkivor të vitit 1946, sikundër edhe në padinë fillestare dhe në parashtrimet e bëra gjatë procesit, kërkuesi është përqendruar kryesisht në paligjshmërinë e akteve të dhëna në favor të të paditurve dhe të veprimeve juridike mes tyre.

41. Në vijim, Gjykata konstaton se në ankimin e paraqitur fillimisht kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kërkuesi ka ngritur pretendime vetëm për vlerësim të gabuar të provave dhe interpretim të keq të ligjit, duke përsëritur në fakt ato çka kishte parashtruar në pretendimet përfundimtare përpara gjykatës së shkallës së parë. Në vijim, ai ka paraqitur një shtesë ankimi, duke ngritur pretendime për shkelje procedurale të lejuara nga gjykata e shkallës së parë në drejtim të mungesës së juridiksionit gjyqësor për padinë e ndërhyrësit kryesor ose për mungesën e një kërkimi në padinë e këtij të fundit për kundërshtimin e vendimit të AKKP-së që kishte rrëzuar kërkesën e tij për njohjen e pronësisë, si dhe për mungesën e njoftimit për Avokaturën e Shtetit. Po ashtu, ai ka pretenduar edhe pabazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor, duke pretenduar falsitetin e dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit, shkak për të cilin ka kërkuar edhe përsëritjen e hetimit gjyqësor, rimarrjen nga gjykata e apelit të provave të administruara në gjykimin në shkallë të parë, por edhe të provave të reja, por pa treguar ndonjë të tillë. Në veçanti, kërkuesi ka kërkuar rivlerësimin e aktit të ekspertimit topografik dhe urdhërimin e një ekspertimi të ri, duke ngritur pretendime për përcaktimin, vendosjen në terren të pronës së ndërhyrësit kryesor, duke u shprehur po ashtu se për këtë arsye eksperti duhej të ripyetej.

42. Në gjykimin e çështjes në apel, në seancën e parë gjyqësore të zhvilluar (të datës 28.10.2011), në kërkesat paraprake, vetëm një nga të paditurit ka kërkuar përsëritjen pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke kërkuar administrimin si prova të disa akteve shkresore, ndërsa seanca është shtyrë me kërkesë të kërkuesit për t'u njohur me ato prova. Në seancën e zhvilluar të radhës (të datës 16.3.2012), asnjë nga palët nuk ka paraqitur kërkesa të tjera për prova dhe gjykata i ka ftuar ato për parashtrimet përfundimtare. Nga ana e tij, kërkuesi ka kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, duke pretenduar, ndër të tjera, edhe se hetimi gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë nuk ka qenë i plotë. Pas parashtrimit nga palët të pretendimeve përfundimtare, gjykata e apelit është tërhequr për

vendim dhe në vijim e ka shpallur atë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

43. Gjykata konstaton po ashtu se kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndër të tjera, edhe me pretendimet se gjykatat kanë vlerësuar keq provat veçanërisht ekspertimin topografik dhe se ato nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, me të njëjtat argumente, si në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen në seancë publike në prani të palëve dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se gjykatat më të ulëta kanë hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme për provat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, duke arritur në përfundime bazuar në provat e administruara në gjykim, të cilat janë analizuar në tërësinë e tyre. Ajo gjykatë, ndërsa ka marrë në analizë në mënyrë të veçantë pretendimet për juridiksionin gjyqësor dhe formimin e trupit gjykues, për pretendimet e tjera të parashtruara në rekurset e palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe në atë të kërkuesit, ka vlerësuar se ato lidhen kryesisht me vlerësimin e provave, të cilat i janë nënshtruar hetimit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit, ndaj si të tilla ato pretendime dilnin jashtë natyrës së gjykimit nga ana e saj.

44. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, ndryshe nga sa kërkuesi pretendon, ka pranuar çdo kërkesë të tij për prova, duke administruar në gjykim të gjitha provat shkresore të paraqitura nga ai. Ndërkohë, nuk ka nga ai ndonjë kërkesë për marrjen e provës me dëshmitarë. Për kërkesën e tij për marrjen nga gjykata pranë organeve shtetërore të disa provave shkresore që kishin lidhje me të paditurit dhe ndërhyrësin kryesor, gjykata ka arsyetuar se kërkuesi duhej t'i drejtohej më parë atyre organeve dhe nëse ato nuk ia vinin në dispozicion aktet, mund t'i kërkonte asaj marrjen e tyre, ndërkohë që në vijim ai nuk i ka parashtruar gjykatës ndonjë kërkesë tjetër në këtë drejtim. Në lidhje me ekspertimin topografik nuk rezulton që kërkuesi të këtë kërkuar marrjen e një prove të tillë dhe as të ketë kërkuar riekspertim në gjykimin në shkallë të parë. Një kërkesë e tillë është paraqitur nga ai në ankimin (shtesë) në gjykatën e apelit, me argumentet se eksperti kishte gabuar në përcaktimin, vendosjen në terren të pronës së ndërhyrësit kryesor, arsye për të cilën ai duhej të ripyetej. Megjithatë, në gjykimin në apel kërkuesi nuk ka kërkuar nga gjykata përsëritjen e hetimit gjyqësor dhe rimarrjen e provës së ekspertimit topografik dhe as pyetjen e ekspertit që kishte përgatitur aktin e ekspertimit në gjykimin në shkallë të parë. Ai është mjaftuar vetëm me paraqitjen e vërejtjeve të tij për ekspertimin në parashtrimet përfundimtare, në funksion të kërkesës për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin asaj të çështjes për rigjykim.

45. Në lidhje me argumentin e kërkuesit se gjykatat e faktit, qoftë edhe kryesisht, duhet të kishin kërkuar nga organet shtetërore të dhëna dhe akte që ishin të nevojshme për gjykimin, referuar nenit 224 të KPC-së, Gjykata vëren se ky argument i kërkuesit dhe përmbajtja e asaj dispozite ligjore nuk duket se kanë të bëjnë me ndonjë të drejtë procedurale të palëve, e cila, nga ana tjetër, të jetë cenuar për shkak të qëndrimit joaktiv të mbajtur nga gjykatat për të kërkuar dhe administruar në gjykim prova që mbështesnin ose jo pretendimet e palëve. Për më tepër, ndërsa nuk është në rolin e gjykatës të veprojë në mënyrë aktive në këtë drejtim, por iu takon palëve barra e provës për të provuar pretendimet e tyre, kërkuesi nuk tregon ndonjë kontradiktë në provat dokumentare të palëve, për sheshimin e të cilave gjykatat e faktit duhet të kishin ndërhyrë në kuptim të dispozitës ligjore të referuar nga ai (kërkuesi).

46. Gjykata vëren po ashtu se edhe argumenti i kërkuesit se gjykatat e faktit duhej që kryesisht të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar vendndodhjen e pronës së tij, por edhe të palëve të tjera në gjykim, nuk duket se ka të bëjë me ndonjë të drejtë procedurale të tij, e cila të jetë cenuar nga ato gjykata për shkak se nuk kanë vlerësuar nevojën për përsëritjen e ekspertimit topografik. Për më tepër, përsëritja e ekspertimit, referuar nenit 229 të KPC-së, mund të urdhërohet nga gjykata në hipotezat kur ai është i metë ose i paqartë apo kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve. Ndërsa hipoteza e dytë as nuk shtrohet për diskutim, për hipotezën e parë kërkuesi nuk del të ketë parashtruar arsye të qenësishme për të meta ose paqartësi të ekspertimit të realizuar në gjykimin në shkallë të parë, qoftë në gjykimin në këtë shkallë, ashtu edhe përpara gjykatës së apelit. Sikurse ka prapësuar edhe subjekti i interesuar Barjam Meminaj, por edhe GJEDNJ-ja ka evidentuar në vendimin e saj *(shih paragrafin 9 të vendimit të GJEDNJ-së),* kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re ose ekspertim alternativ, qoftë në

gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe në gjykatën e apelit, për të mbështetur kundërshtimet e tij për ekspertimin e realizuar në shkallë të parë, por edhe kërkesë për kryerjen e një ekspertimi të ri. Për më tepër, në gjykimin në shkallë të parë, kërkuesi as nuk ka kundërshtuar ekspertimin në lidhje me konkluzionet e arritura për pronën e pretenduar nga ai dhe as ka pretenduar nevojën për një ekspertim të ri. Argumenti i kërkuesit se gjykatat duhej të kërkonin mendimin e një eksperti tjetër për sa kohë eksperti i caktuar nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, nuk duket i arsyeshëm në kontekst të rrethanave të çështjes. Sikurse gjykatat kanë pranuar, eksperti nuk ka mundur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së kërkuesit jo për mungesë të njohurive të posaçme, por për shkak të mungesës të të dhënave konkrete dhe të mjaftueshme për kufijtë e pronës në aktin (dokumentin arkivor të vitit 1946) ku ai ka bazuar pretendimin për të drejtën e pronësisë, por edhe në aktet e tjera dokumentare të paraqitura nga ai.

47. Gjykata po ashtu vëren se në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit, kërkuesi ka pretenduar edhe se prona e tij ka qenë lehtësisht e përcaktueshme, pasi aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit e regjistruar në regjistrat hipotekarë të vitit 1942 dhe që është transkriptuar më vonë në emër të familjes P., duke qenë ajo e verifikueshme në planshetat ndër vite. Megjithatë, gjatë gjithë gjykimit në vijimësi ai ka pretenduar se referuar dokumentit arkivor të vitit 1946, pas shpronësimit në vitin 1948, i është lënë në pronësi një sipërfaqe toke prej 1 vretenësh, ku ndodhej edhe një ndërtesë me konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla, mbi themelet e së cilës, pas viteve '90, ka ndërtuar një ndërtesë tjetër që është në proces legalizimi. Gjithsesi, dokumenti për regjistrimin hipotekar në fjalë është administruar si provë në gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe ai flet për pronësinë e dy vëllezërve Meli (shtetasve T. dhe B.) për një shtëpi në lagjen "Varosh", në vendin e quajtur "Kume", me kufij: veri - kanali; lindje - i zoti; jugu - udha; perëndimi - prona e shtetasit T.K. Kjo provë nuk përmendet dhe analizohet në mënyrë specifike në aktin e ekspertimit topografik, megjithatë nuk konstatohet që kërkuesi të ketë ngritur pretendime në këtë drejtim dhe as të ketë debatuar për të dhënat që ajo provë sillte në raport me të drejtën e pronësisë për pronën objekt kërkimi në padinë e tij. Ai i është referuar kësaj prove vetëm në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit, ndërsa kishte përfunduar hetimi gjyqësor edhe në atë shkallë gjykimi. Gjithsesi duket se edhe kjo provë i është nënshtruar vlerësimit nga gjykatat e faktit, të cilat duke pranuar se e vetmja provë dokumentare e kërkuesit që sjell të dhëna për të drejtën e tij të pronësisë është dokumenti arkivor i vitit 1946, kanë vlerësuar se çdo provë tjetër dokumentare e tij nuk sjell të dhëna të tilla për pronën objekt kërkimi në padinë e tij. Në këtë kuptim, argumenti në fjalë i kërkuesit, në thelb, duket se ka të bëjë me mënyrën e vlerësimit nga gjykatat e zakonshme të kësaj prove. Për rrjedhojë, për sa kohë që prova në fjalë është administruar në gjykim, vetëm fakti se gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar se të dhënat që ajo sjell nuk provojnë të drejtën e pronësisë së kërkuesit për pronën objekt kërkimi në padinë e tij, nuk mund të mbështesë pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve.

48. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe argumenti i kërkuesit se gjykata ka ngatërruar rolin e saj me atë të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm për atë çka eksperti ka konstatuar, nuk mund të shërbejë për të vënë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve, për më tepër që edhe në thelb ky argument është i pabazuar. Ekspertimi është provë në procesin civil dhe është gjykata që e vlerëson atë të lidhur dhe në harmoni edhe me provat e tjera. Ndaj vetëm fakti që gjykatat e zakonshme kanë pranuar konstatimet e aspektit teknik të ekspertit, pra pamundësinë teknike për përcaktimin e vendndodhjes së pronës së kërkuesit për ato prova të paraqitura prej tij, nuk nënkupton se ato kanë ngatërruar rolin e tyre me atë të ekspertit, por se gjykatat e faktit nuk kanë pasur ndonjë arsye të qenësishme për të mbajtur një qëndrim të kundërt me të.

49. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkuesit i janë krijuar mundësi të barabarta për të paraqitur prova dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar. [3]

[3] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e këtij pretendimi, me arsyetimin se kërkuesit nuk iu krijuan mundësitë e barabarta për të paraqitur prova në drejtim të aktit të ekspertimit. Kjo gjë e ka vendosur atë në pozita jo të

B.2. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

50. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i vendimeve nga gjykatat e faktit është i mangët, përveçse alogjik dhe ato nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij. Gjykatat, shprehet ai, i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, i cili, nga njëra anë, nuk ka arritur të përcaktojë vendndodhjen e pronës së tij, në një kohë kur eksperti, nga ana tjetër, ka arritur të përcaktojë me saktësi vendndodhjen e pronës së ndërhyrësit kryesor, megjithëse prona e këtij të fundit, sipas dokumenteve të vjetra, ka kufij tokësorë dhe kufitarë të përcaktuar, por jo moçal dhe kënetë, sikurse kufizohej pjesërisht prona e tij sipas dokumenteve të vjetra. Po sipas kërkuesit, gjykatat, nga njëra anë, janë shprehur se dokumenti arkivor nuk përbën provë për legjitimimin e tij në ngritjen e padisë, ndërkohë që, nga ana tjetër, kanë konsideruar se dokumenti arkivor i ndërhyrësit kryesor përbën provë për legjitimimin e tij. Gjykatat, vijon kërkuesi, kanë anashkaluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se i padituri Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimit objekt padie që lidhet me kthimin e pronës. Gjithashtu, sipas kërkuesit, ndonëse gjykatat kanë konstatuar pavlefshmërinë e kontratave të shitblerjes dhe kanë anuluar aktet administrative objekt gjykimi, ato nuk kanë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë, pra mosmarrëveshjen në gjykim, duke krijuar kështu një konflikt të ri, ndërsa mbi truallin objekt gjykimi ka dy pallate shumëkatëshe. Pavarësisht shkeljeve të lejuara gjatë procesit gjyqësor, shprehet kërkuesi, Gjykata e Lartë i ka legjitimuar ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

51. Subjekti i interesuar, Barjam Meminaj, ka prapësuar se gjykatat e faktit i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuesit. Gjykatat kanë arsyetuar edhe në lidhje me provën e ekspertimit. Edhe për faktin e dënimit penal të të padituritNikolin Kodhima, gjykatat kanë hetuar dhe kanë arsyetuar për paligjshmërinë e vendimit të komisionit të pronave në favor të ish-pronarëve Kodhima dhe të veprimeve juridike të kryera më pas, gjë për të cilën, për më tepër, kërkuesi nuk ka ngritur pretendime as në ankimin përpara gjykatës së apelit, as në rekursin në Gjykatën e Lartë. Po sipas këtij subjekti, është i pabazuar edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe anulimin e akteve administrative, ndërsa gjykatat i kanë zgjidhur ato në përputhje me ligjin, për më tepër që kërkimet në këtë drejtim kanë qenë edhe të tijat (subjektit të interesuar) dhe për sa kërkuesi pretendon ato nuk lidhen me cenimin atij të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

52. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve *(shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre *(shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 45, datë 3.7.2017; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të

barabarta me palët ndërgjyqëse lidhur me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe ka bërë të mundur që vendimet gjyqësore të lënë në thelb paqartësinë dhe pamundësinë e paraqitjes së një akti ekspertimi nga ana e tij, gjë që do të bënte të mundur zgjidhjen e një rasti të pazgjidhshëm, ndryshe nga sa duhet të garantojë një gjykim i drejtë në respektim të parimit të barazisë së armëve.

vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë *(shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

54. Mbi bazën e standardeve të mësipërme dhe nisur nga pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse vendimet e gjykatave të zakonshme plotësojnë standardet kushtetuese të arsyetimit në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes dhe zbatimit të ligjit dhe nëse ky përcaktim nga ato i fakteve dhe zbatimit të ligjit në vijim është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë.

55. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit për njohjen pronar dhe kërkimet e tjera të ndërvarura, me arsyetimin se ai nuk arriti të provojë legjitimimin aktiv, interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë, për sa kohë nuk provoi që vendndodhja e pronës së tij ishte pikërisht në vendin e pronës objekt kërkimi në padi. Sipas gjykatës, prova e vetme e paraqitur nga ai për të provuar të drejtën e pronës ishte dokumenti arkivor i vitit 1946, që bënte fjalë për një pronë prej 7 vretenësh, në vendin e quajtur "Çole", i cili specifikonte kufijtë e saj dhe konkretisht: veriu - rrugë këmbësorësh; lindje - baçe e shtetasit Sh.S.; jugu - moçal dhe kënetë; perëndimi - kënetë, nga e cila 1 vreten i ishte lënë të zotit, por ky dokument nuk shoqërohej me hartë (skicë). Po sipas gjykatës, për të përcaktuar vendndodhjen e pronës së kërkuesit në gjykim u thirr edhe një ekspert, por ai nuk arriti ta përcaktonte atë në mungesë të hartës (skicës) së pronës për të cilën bënte fjalë dokumenti arkivor dhe në mungesë të ndonjë dokumenti grafik të pronës së kufitarit (shtetasit Sh.S.), ndërkohë që për kufijtë moçal dhe kënetë të pronës, eksperti sqaroi se zona e Çoles ka qenë e gjitha e tillë (moçal dhe kënetë) sipas hartës së vitit 1937 dhe në këtë hartë nuk përcaktohej qartë kufiri midis moçalit dhe tokës. Po sipas ekspertit, edhe sipërfaqja prej 1 vretenësh e lënë pronarit nuk ishte e përcaktuar, për ta vlerësuar në raport me pjesën tjetër të pronës.

56. Nga ana tjetër, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ndërhyrësi kryesor, subjekti i interesuar Barjam Meminaj, arriti të provojë legjitimimin aktiv, interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë. Sipas gjykatës, për të provuar të drejtën e pronës ai paraqiti një dokument arkivor të vitit 1948 që bënte fjalë për një pronë prej 4 vretenësh, në lagjen "Çole", në vendin e quajtur "Kume", i cili specifikonte kufijtë e saj dhe konkretisht: veriu - çairet e shtetasve M.Gj. dhe H.K.; lindja - udhë; jugu - prona e shtetasit Sh.V. dhe çaire belik; perëndimi - çairet e shtetasit S.I. dhe moçal. Ky dokument, sipas gjykatës, nuk shoqërohej me hartë (skicë) të pronës, por ndërhyrësi kryesor paraqiti si prova shkresore dokumente të kufitarëve të pronës, bazuar në të cilat eksperti arriti në përfundimin se prona e tij ndodhej pikërisht në vendin ku familjeve Kodhima dhe Binaj u ishte kthyer prona me vendimet përkatëse të komisioneve të pronave, pronë kjo që pas transaksioneve të kryera zotërohej nga të paditurit, subjektet e interesuara Bukurije Agaj dhe Gramoz Haxhiraj dhe ku aktualisht shoqëritë e paditura po kryenin punime për ndërtimin e pallateve 8 dhe 10 kate. Mbi këtë bazë, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se ndërhyrësi kryesor ka provuar të drejtën e pronësisë për pronën objekt gjykimi. Nisur nga kjo, por edhe se vendimi i KKKP-së së Bashkisë Vlorë për njohjen dhe kthimin e pronës në favor të familjes Kodhima është nxjerrë mbi kërkesë të personave inekzistentë dhe, në veçanti, duke u mbështetur në dokumente të falsifikuara, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm dhe për këtë arsye janë absolutisht të pavlefshme edhe transaksionet për shitjen e pronës më pas, por edhe aktet administrative për dhënien e lejes së sheshit dhe asaj të ndërtimit. Po sipas gjykatës, edhe vendimi i KKKP-së së Këshillit të Rrethit Vlorë, përveç faktit që mund të mos jetë lëshuar nga ai komision, pasi nuk gjendet në arkivin e tij, është nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin, sipas të cilit procesi i kompensimit fizik do të kryhej vetëm pas përfundimit të procesit të kthimit në natyrë të pronës për të gjithë ish-pronarët.

57. Çështja në vijim është shqyrtuar nga gjykata e apelit edhe mbi ankimin e kërkuesit, ndërsa ajo ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Për përfundimin e mungesës së legjitimimit aktiv të kërkuesit, gjykata e apelit ka arsyetuar se gjatë procedimit administrativ nga Zyra Rajonale e AKKP-së në lidhje me kërkesën e tij, ka rezultuar se sipërfaqja e pretenduar mbivendosej plotësisht me pronën e njohur me vendimin nr. 4, datë 23.3.2007

të Zyrës Rajonale Vlorë, dhënë në favor të subjektit të shpronësuar M.Sh. dhe se kërkuesi, në një proces gjyqësor paralel, ka kërkuar vërtetimin gjyqësor të faktit të vendndodhjes së pronës, por ajo çështje është pushuar me vendimin nr. 2684, datë 5.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

58. Po ashtu, çështja i është nënshtruar kontrollit edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekurset e paraqitura edhe nga kërkuesi nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij. Në veçanti, ai kolegj ka vlerësuar të drejtë konkluzionin e arritur nga gjykata e faktit se kërkuesi nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv në ngritjen e padisë në situatën kur nuk ka paraqitur prova të tjera sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të bërë të mundur përcaktimin e vendndodhjes së pronës së tij.

59. Nga sa më sipër, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk duket të kenë mangësi, mungesë ose pamjaftueshmëri arsyetimi apo alogjizëm. Po ashtu, ndërsa gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pretendim, nga përmbajtja e vendimeve të tyre del qartë se ato kanë trajtuar çështjet thelbësore të faktit dhe të ligjit të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së parashtruar përpara tyre. Kështu, gjykatat kanë arsyetuar në veçanti në lidhje me pretendimin kryesor në padinë e kërkuesit, atë për të drejtën e pronësisë, duke arritur në përfundimin se ai nuk e provon këtë të drejtë për pronën objekt kërkimi në padi. Mbi këtë bazë, gjykatat kanë gjetur të pabazuara edhe pretendimet e tjera të tij, për sa kohë ato ndërvareshin pikërisht nga bazueshmëria e pretendimit kryesor për të drejtën e pronësisë. Për përfundimin se kërkuesi nuk ka provuar të drejtën e pronësisë për pronën objekt kërkimi në padinë e tij, gjykatat e faktit kanë analizuar dhe tërhequr konkluzione nga provat e paraqitura nga ai, përfshirë edhe konstatimet teknike të ekspertit. Në vendimet e tyre ato kanë dalluar provat e kërkuesit në raport me ato të ndërhyrësit kryesor, ku në analizë të provave të këtij të fundit, përfshirë edhe konkluzionet e ekspertit, kanë arritur në përfundimin se ai ka arritur të provojë të drejtën e pronësisë mbi pronën objekt gjykimi. Fakti që si kërkuesi, ashtu edhe ndërhyrësi kryesor pretendimin për të drejtën e pronësisë e kanë mbështetur në dokumente të të njëjtit lloj (dokumente arkivore) dhe që ofronin të dhëna të së njëjtës natyrë (sipërfaqen dhe kufijtë e pronës), nuk i bën kontradiktore arsyetimet e gjykatave të faktit, për sa kohë që për arritjen e përfundimeve në lidhje me pretendimet e ndërhyrësit kryesor ato kanë evidentuar se janë mbështetur edhe në prova të tjera.

60. Nga ana tjetër, në lidhje me sa kërkuesi pretendon për mungesë arsyetimi nga gjykatat e zakonshme për sa i përket faktit të dënimit penal të të paditurit Nikolin Kodhima për falsifikimin e vendimit objekt padie të KKKP-së së Bashkisë Vlorë ose për moszgjidhjen nga ato të pasojave të pavlefshmërisë së kontratave të shitblerjes dhe të akteve administrative objekt gjykimi, Gjykata vëren se këto aspekte të çështjes janë bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor në kuadër të padisë së ndërhyrësit kryesor dhe, në këtë kuptim, kërkuesi nuk argumenton se përse përmbushja ose jo e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në këtë drejtim ka ndonjë pasojë ose ndikim në të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor.

61. Nën dritën e rrethanave të mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsyetim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim nga ato i fakteve dhe i zbatimit të ligjit në vijim nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.[4]

62. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet rrëzuar.

[4] Gjyqtarja Fiona Papajorgji mbajti qëndrimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga ana e Gjykatës së Lartë është i bazuar. Kjo e fundit, bazuar në parimin e subsidiaritetit, pavarësisht se ka si funksion kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor, në rastin në shqyrtim duket se ka bërë një vlerësim formal të vendimmarrjes së gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë edhe pse e ka shqyrtuar çështjen e kërkuesit në seancë gjyqësore, duket se nuk u ka dhënë përgjigje në substancë pretendimeve të tij për vendndodhjen e pronës objekt mosmarrëveshjeje, e për rrjedhojë në lidhje me legjitimimin aktiv të tij në ngritjen e kërkesëpadisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese vetëm për sa është disponuar në lidhje me pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.
3. Rrëzimin e ankimit kushtetues individual të kërkuesit për pretendimet e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 22.9.2025.
Shpallur më 5.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Ilir Toska,
Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Marjana Semini

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga kërkuesi Astrit Meli, pas shqyrtimit të çështjes së tij nga GJEDNJ-ja, jemi pjesërisht kundër vendimit të shumicës, pasi vlerësojmë se ankimi kushtetues individual i tij për pretendimet e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, ndaj, si i tillë duhej pranuar në tërësi. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet tona.

2. Sikurse ka rezultuar nga rrethanat e çështjes, trashëgimlënësi (i ati) i kërkuesit ka ngritur pretendime pronësie për një pasuri të shpronësuar në vitin 1948, për të cilën KKKP-ja, në vitet 1996 dhe 1997, ka disponuar njohjen, kthimin dhe kompensimin e saj fizik personave të tjerë, të cilët kanë kryer transaksione me të. Kërkesat për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e pasurisë janë refuzuar administrativisht nga organet e ngarkuara me ligj, ndaj në këtë situatë ai ka paraqitur padi në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur, ndër të tjera, rrëzimin e padisë të trashëgimlënësit të kërkuesit si të pabazuar në prova, me arsyetimin se ai nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv, pra cenimin e ndonjë interesi të ligjshëm që të mund të zgjidhej ndonjë konflikt nga gjykata, ndaj në këtë situatë ajo (gjykata) nuk i ka hyrë shqyrtimit në themel të padisë së tij. Vendimi në fjalë është lënë i pacenuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, duke e vlerësuar atë të bazuar në ligj dhe në prova.

3. Në këto rrethana, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, fillimisht në datën 13.10.2017, me pretendimin se gjykatat e zakonshme i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekte të aksesit, mbrojtjes dhe kontradiktoritetit, barazisë së armëve, gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e caktuar me ligj, paanshmërisë, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Pas shqyrtimit në seancë plenare, Gjykata, me vendimin nr. 12/2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi kërkuesi lidhur me pretendimet: për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit (me argumentin e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë) nuk legjitimohet; për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit (për argumentin se gjykata e apelit ka shtyrë shpalljen e vendimit) nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues; për cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim (për argumentet e tjera), si dhe të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, i ka të pabazuara, ndërsa për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nuk u arrit shumica e nevojshme e votave të gjyqtarëve, ndaj ato u konsideruan të rrëzuara, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar GJEDNJ-së, e cila, me vendimin e datës 16.7.2024, ka gjetur shkelje të nenit 6, paragrafit 1, të

KEDNJ-së për të drejtën për vendim të arsyetuar sa i takon dy pretendimeve të rrëzuara.

4. Pas kësaj, në datën 16.12.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues sipas objektit. Pas rihapjes së gjykimit kushtetues dhe shfuqizimit të vendimit nr. 12/2021 vetëm për atë pjesë të tij, për të cilën GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje, pra lidhur me arsyetimin për sa i takon rrëzimit të dy pretendimeve – parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, shumica në përfundim ka disponuar me rrëzimin e kësaj pjese të kërkesës, duke i vlerësuar ato të pabazuara.

5. Ndonëse jemi dakord me shumicën për sa i takon rihapjes së procesit kushtetues dhe rigjykimit të çështjes së kërkuesit vetëm për sa i takon arsyetimit për dy pretendimet për të cilat GJEDNJ-ja ka vlerësuar se cenohej neni 6 i KEDNJ-së, nuk ndajmë të njëjtin vlerësim lidhur me faktin se ato dy pretendime janë të pabazuara në themel, pasi për shkak të rrethanave dhe fakteve të trajtuara si nga gjykatat e zakonshme, ashtu edhe gjatë gjykimit kushtetues, çështja e kërkuesit kishte nevojë të rishqyrtohej sërish, në kushtet kur arsyetimi i gjykatave përmbante gabime të dukshme faktike që lidheshin edhe me parimin e barazisë së armëve në gjykim.

6. Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti dhe se ai është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që, nëpërmjet gjykatës, të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë në fjalë. Gjykatat, shprehet kërkuesi, i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër, aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekar të vitit 1942. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato, duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

7. Shumica, duke i trajtuar veçmas këto pretendime i ka vlerësuar ato të pabazuara, pasi ka çmuar se kërkuesit i janë krijuar mundësi të barabarta për të paraqitur prova dhe për të parashtruar deklarimet e tij për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen (*shih paragrafin 49 të vendimit*) dhe se vendimet e gjykatave të zakonshme përmbajnë mjaftueshëm arsyetim në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes dhe zbatimin e ligjit dhe ky përcaktim nga ato nuk duket se është dukshëm i gabuar, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë (*shih paragrafin 61 të vendimit*).

8. Nuk jemi dakord me këtë konkluzion të shumicës, pasi nga argumentet që ka përdorur gjykata e shkallës së parë për të rrëzuar padinë e kërkuesit, ka referuar se ai ka paraqitur si provë për të provuar pronësinë e tij një dokument arkivor të dalë nga Arkivi i Shtetit, në të cilin jepen specifikime konkrete, por ky dokument nuk është i shoqëruar me skicë. Për të përcaktuar faktin se ku ndodhet prona e kërkuesit dhe nëse midis saj dhe pronës së palëve të tjera ndërgjyqëse ka ose jo mbivendosje, gjykata ka proceduar me thirrjen e një eksperti. Nga eksperti u arrit në përfundimin se për kufitarët e kësaj prone nuk ka asnjë dokument grafik dhe për faktin se dokumenti nuk ka hartë (skicë) ose nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, ai nuk mund të përcaktojë se ku ndodhet kjo pronë, pra nuk mund të përcaktohet nëse ndodhet pikërisht aty ku palët ndërgjyqëse kanë pronën e tyre ose në ndonjë vend tjetër. Nga kërkuesi, shprehet gjykata, nuk u sollën prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër për të bërë të mundur të përcaktohej se ku pikërisht është vendosur prona e tij. Pra, kërkuesi, ka konkluduar gjykata e shkallës së parë nuk arriti të provojë legjitimitetin aktiv në padinë e tij, sepse nuk arriti të provojë cenimin e ndonjë interesi të tij të ligjshëm që të vinte në lëvizje gjykatën në zgjidhjen e ndonjë konflikti me palët ndërgjyqëse, ndaj për mungesë të legjitimitetit aktiv, gjykata, pa i hyrë themelit të padisë së kërkuesit, e ka rrëzuar atë si të pabazuar në prova. Ndonëse çështja u shqyrtua nga gjykata e apelit, ajo e ka lënë në fuqi vendimin e ankimuar me të njëjtën linjë arsyetimi, duke u shprehur edhe se i ati i kërkuesit, në një proces gjyqësor paralel, ka kërkuar vërtetimin gjyqësor të

faktit të vendndodhjes së pronës, por ajo çështje është pushuar me vendim gjyqësor në vitin 2009. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë e respektimit të ligjit material dhe procedural, ndërsa në rekursin e kërkuesit nuk ngrihen shkaqe për cenimin e tij. Sipas saj, gjykatat e faktit kanë konkluduar drejt se kërkuesi nuk ka arritur të provojë legjitimitetin aktiv në ngritjen e padisë në situatën kur nuk ka paraqitur prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të përcaktuar vendndodhjen e pronës së tij.

9. Në kuadër të analizës së argumenteve të mësipërme të gjykatave të zakonshme, paraprakisht sjellim në vëmendje standardet kushtetuese sipas të cilave e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre dhe se gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet 13, datë 21.3.2023; nr. 41, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

10. Mbi bazën e këtyre standardeve, gjykatat e faktit kishin detyrimin që në situatën e paqartësisë dhe mungesës së një përgjigjeje konkrete nga eksperti i thirrur për të përcaktuar saktësisht pronën objekt mosmarrëveshjeje, të mund të thërrisnin një grup ekspertësh të specializuar për të zgjidhur çështjen e vendndodhjes së pasurisë në fjalë. Përkundër kësaj, ato janë mjaftuar me faktin se kërkuesi nuk ka sjellë prova të tjera, sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij ose ndonjë dokument tjetër, për të përcaktuar se ku pikërisht ishte vendosur prona e tij, duke i ngarkuar atij në mënyrë të shpërpjesëtuar një barrë, e cila mund të adresohej nga vetë gjykata. Ndërkohë që gjykata ka pranuar provat e palëve të tjera ndërgjyqëse pa dhënë një argumentim të plotë se përse ato zgjidhnin qartësisht dhe plotësisht një situatë që në vlerësimin e një eksperti kompetent nuk ishte e tillë. Kjo situatë nuk u rregulla as nga gjykata e apelit, megjithëse gjendej përpara një raporti të një eksperti, i cili nuk ishte në gjendje të përcaktonte saktësisht pronësinë dhe kufijtë e saj, që në thelb ishin dhe objekti i mosmarrëveshjes që duhet të zgjidhej prej gjykatave. Nga ana tjetër, edhe Gjykata e Lartë, e cila bazuar në parimin e subsidiaritetit, ka funksion kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*) ka bërë një vlerësim formalist të vendimmarrjes së gjykatës së apelit, duke e lënë, në thelb, të pazgjidhshëm paqartësinë dhe pamundësinë e një eksperti për të konkluduar mbi rastin.

11. Nga sa më lart, çmojmë se gjykatat e zakonshme e kanë vendosur kërkuesin në pozita të pabarabarta me palët ndërgjyqëse lidhur me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, duke bërë që vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi të shfaqin gabime të dukshme faktike në atë masë sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e ankimit kushtetues individual të kërkuesit, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë asaj gjykate, duke marrë në konsideratë arsyetimin e mësipërm.

Anëtarë: Marjana Semini, Marsida Xhaferllari

VENDIM
Nr. 61, datë 21.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (H) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Hismet Drazhi

SUBJEKT I INTERESUAR:

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit Hismet Drazhi (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) (sot ASHK) dhe Drejtorisë Vendore të saj, t'i legalizojë objektin "banesë" dhe ta pajisë me leje legalizimi.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2129 (80-2018-2169), datë 4.6.2018, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur që të vazhdojë procesin e legalizimit të objektit "shtëpi banimi njëkatëshe", të ngritur mbi pasurinë e paluajtshme nr. 7/275, zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, si dhe ta pajisë kërkuesin me leje legalizimi për këtë objekt. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur në gjykim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.7.2018 me nr. 31121-03020-86-2018, nr. akti 14591.

3. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së në datën 12.7.2024. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por për shkak të ngarkesës së madhe dhe akumulimit ndër vite të dosjeve. Sipas asaj gjykate, gjyqtarja relatore ka marrë të gjitha masat e nevojshme, por ajo ka deklaruar se ndodhet në gjykimin e çështjeve të regjistruara në vitin 2017, ka në ngarkim 2450 dosje dhe çështja i ka kaluar me shortin e datës 8.5.2024.

4. Në datën 6.2.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, dhe Kolegji i

Gjykatës, me vendimin e datës 1.4.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

5. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi çështja e kërkuesit ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk janë marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes. Ky vendim është i padrejtë dhe antikushtetues dhe cenon *standardin e arsyetimit të vendimit*.

6. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja***, nuk ka paraqitur argumente në lidhje me pretendimet e kërkuesit por ka vënë në dispozicion praktikën e ndjekur për legalizimin e pasurisë së tij.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, për të cilin ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 8.10.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 6.2.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

11. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

12. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e tij ka 6 vjet e 6 muaj në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit, ndonëse sipas parashikimeve të KPC-së ajo duhej të ishte gjykuar brenda 1 viti. Po sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë interesat kushtetues të kërkuesit, rrethanat e faktit, si dhe nuk ka marrë në analizë aspekte të pasojave të tejzgjatjes së gjykimit të çështjes. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Lartë është i padrejtë dhe antikushtetues.

13. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i

reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi me objekt detyrimin e ALUIZNI-t t'i legalizojë objektin "banesë" dhe ta pajisë me leje legalizimi. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga pala e paditur. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 16.7.2018, pra deri në momentin e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual kanë kaluar 7 vjet e 3 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për themelin e saj.

15. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja "a", i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

16. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: i. sjellja e kërkuesit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi.

17. Gjykata thekson se, për sa u përket kritereve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuesit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të saj për vlerësimin e tyre *(shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese),* nuk konstatohet ndonjë shkak ose rrethanë e re, ose e ndryshme për të arritur ajo në një qëndrim të ndryshëm për sa i përket respektimit të tyre. Për rrjedhojë, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata vlerëson të ndalet në vijim vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon kërkuesi* në rastin konkret për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tillë si ata që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata i referohet edhe qëndrimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilit një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet si një kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile që nuk kërkojnë ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtë, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm dhe ato nuk janë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Sipas asaj gjykate, një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet e arsyeshme kur argumenti i vetëm për vonesën është reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve e krijuar për këtë shkak dhe faktorë të tillë të një natyre të përgjithshme mund të merren parasysh në një masë të përshtatshme në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të procedurave në një çështje të veçantë, por nuk janë të afta, në vetvete, të justifikojnë vonesa të një mase të tillë *(shih ARB sh.p.k. e të tjerë kundër Shqipërisë, datë 27.5.2025, §§ 111, 118, 122).*

19. Në analizë të kritereve si më sipër, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim thelbi i çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi ka të bëjë me pamundësinë e përfundimit të procesit të legalizimit të banesës së tij dhe pajisjen me leje legalizimi. Kjo çështje, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa *vetjakë* dhe *jetësorë*, bazuar në shkaqet objektive, të parashtruara nga kërkuesi, pra duke pasur parasysh se banesa është e vetmja pasuri që ai disponon, si dhe moshën e tij në pension pleqërie, duket se ata janë specifikë dhe të mjaftueshëm për të provuar se çështja është e një natyre të tillë që interesi i tij rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e procedurave gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata, në kontekst të

rrethanave të çështjes konkrete, si dhe në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga vonesa në gjykim, çmon se është argumentuar dhe provuar rreziku për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve justifikojnë trajtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

20. Në përfundim, Gjykata, duke pasur parasysh periudhën prej 7 vjetësh e 3 muajsh gjatë së cilës çështja është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për rrjedhojë vendimi nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024, i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë veçoritë e çështjes së kërkuesit, si dhe mundësitë aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata çmon që, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, të urdhërojë detyrimin e asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3841, datë 8.10.2024, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të shqyrtojë çështjen me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.10.2025.
Shpallur më 7.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 61, datë 5.11.2025

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA ME SUBJEKTIN FINANCIAR JOBANKË NOA SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "k", të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; dhe të pikës 7, të shtojcës nr. 1, të rregullores, "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) me subjektin financiar jobankë NOA sh.a. (shoqëria e përthithur).
2. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) duhet të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje.
3. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) do të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat është licencuar sipas aneksit të licencës së saj.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË
Nr. 936/8, datë 6.11.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-së nr. 20, datë 17.1.2024, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar', Vlorë"', të ndryshuar, sipas tekstit dhe tabelës paraprake, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

- Vlerësimi i pasurisë së llojit "truall", është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ndërsa vlerësimi i pasurisë së llojit "apartament", është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 3,570,054.50 (tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 20, DATË 17.1.2024, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR', VLORË"', TË NDRYSHUAR

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	truall m²	Ndërtesë m²	Adresa	Sipërfaqe trualli për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	Arben	Ramadan	Mamanaj	8604	32/134+1-13	Apartament	74	39		18	Vlorë			-	18	52,296.00	941,328.00	941,328.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pasuria e llojit apartament. Kartela është e vlefshme vetem për shpronësim.
	Emiljana	Ramadan	Xhaferaj																
	Marinela	Ramadan	Mamanaj																
	Gentjan	Ramadan	Mamanaj																
2	Fatmir	Remzi	Idrizi	8604	32/33+1-7	Apartament	74	48	47.5	44	Vlorë	47.50	6,899.00	327,702.50	44	52,296.00	2,301,024.00	2,628,726.50	Konfirmuar nga ASHK-ja. Tek seksioni E- për këtë apartament është privatizuar edhe sipërfaqja e truallit prej 47.5 m². Lëshohet për efekt shpronësimi.
	Vjollca	Brahim	Idrizi																
	Lumturi		Dine																
	Sheme	Remzi	Berati																
	Dylbere	Remzi	Sako																
	Suzana	Remzi	Idrizi																
	Feta	Remzi	Idrizi																
	Armida	Sezai	Sinani																
	Luçjana	Sezai	Rubino																
	Gentjan	Sezai	Sinani																
	Shpendi	Sezai	Sinani																
	Lira	Remzi	Idrizi																
	Astrit	Ali	Avdulla																
	SHUMA PARAPRAKE																	**3,570,054.50**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/11/12 15:54:36 +02'00'
ede3242dc4ce44df8f0ac96fc8cf3f9420251112155
42853031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)